



KONTROLI I LARTË I SHTETIT
RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË
SHOQËRINË “UJËSJELLËS KANALIZIME ELBASAN” SHA

RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI I PËRPUTHSHMËRISË
DHE RREGULLSHMËRISË

NË

SHOQËRINË “UJËSJELLËS KANALIZIME ELBASAN ” SHA

Qershor 2022

I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

I.1. Përshkrimi i shkurtër i projektit

Organizmi dhe funksionimi i Shoqërisë është në zbatim të Ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008 òPër tregtarët dhe shoqëritë tregtareò, i ndryshuar, VKM nr. 63, 27.01.2016 òPër riorganizimin e operatorëve që ofrojnë shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm, grumbullimin largimin dhe trajnimin e ujërave të ndoturaò, me objekt shërbimi në zbatim të Ligjit nr. 115/2014 òPër ndarjen administrative-territoriale të njësive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisëò, VKM nr. 510, datë 10.05.2015 òPër miratimin e procedurave për transferimin e të drejtave dhe detyrimeve, personelit, aktiveve të trupëzuara, të arkivave dhe çdo dokumentacioni tjetër zyrtar në njësitë e qeverisjes vendore, të prekura nga riorganizimi administrativo-territorialò.

I.2 Gjetjet kryesore të konstatuara

Gjetja	Përmbledhje e gjetjes	Referenca në raport	Rëndësia	Rekomandimi
1	<p>Nga auditimi i zbatimit të kontratës nga Shoqëria òA.S. groupò shpk, me objekt òMaterialet hidraulike, në vlerën 40,771,612 lekë, viti 2021, u konstatua se dokumentacioni teknik dhe ligjor i blerjes së materialeve, nuk është i plotë dhe i saktë. Konkretisht pajisjet nuk janë të shoqëruara me test raport fabrike, si dhe Operatori ka paraqitur çertifikatën ISO 9001:2015 të lëshuar nga kompania Q, për Shoqërinë òA.S. groupò shpk, e përkthyer dhe noterizuar në gjuhën shqipe, çertifikuar më date 01.07.2018 dhe datë skadence 30.06.2021.</p> <p>Nga verifikimi, referuar Rekomandimit të APP nr. 3330 prot., datë 20.03.2018 dhe DPA nr. 145 prot., datë 16.03.2018, u konstatua se kompania Q. në Angli është e akredituar ndërkombëtarisht, por kjo çertifikatë me numër seri QEC 30675457/72/Q Rev:001, nuk është publikuar në faqen e kësaj kompanie, për pasojë është dokument i pabesueshëm për tu marrë në konsiderate referuar rekomandimit të sipërpërmendur.</p> <p>Për pasojë grupi i auditimit nuk mund të shprehet për saktësinë dhe vërtetësinë e materialet hidraulike. Pra nuk mund të bëhet verifikimi i specifikimeve teknike (që janë pjesë e kontratës) dhe të dhënat e test raportit të fabrikës, që të konfirmohet që këto pajisje janë të njëjta me ato të prokuruar (specifikimeve teknike), dhe për të cilën Shoqëria òA.S.ò shpk ka fituar tenderin dhe është likuiduar.</p>	Pika 2.7, fq 72-111	E lartë	<p>- Nga Administratori i Shoqërisë të merren masa të menjëhershme për ngritjen e një grupi teknik me specialistë të fushës (përfshijë ata që kanë qenë pjesë e procesit të kolaudimit dhe të marrjes në dorëzim), i cili të kryejë ekzaminimet teknike dhe të përcaktojë autenticitetin e materialeve hidraulike.</p> <p>Në rast se nga procesi i verifikimit rezulton se pajisjet e furnizuara nga Shoqëria òA.S.ò Sh.p.k, nuk garantojnë zbatimin e kontratës në cilësi dhe brenda standardeve të kërkuara dhe të konfirmohet që këto pajisje janë të njëjta me ato të prokuruar, konsiderohet dëm ekonomik dhe të kërkohet në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative, si dhe të gjitha shkallët e gjykimit arkëtimi i vlerës 40,771,612 lekë nga Shoqëria òA.S.ò Sh.p.k.</p>

	<p>Në këto kushte grupi i auditimit nuk mund të japë opinionin e tij, për zbatimin e kontratës në cilësi dhe brenda standardeve të kërkuara dhe të konfirmojë që këto pajisje janë njëjta me ato të prokuruar.</p>			
2	<p>Anëtarët e Këshillit të Administrimit të Shoqërisë ëUjësjetllës Kanalizimeë Sh.A, Elbasan, nuk kanë lidhur kontratë me shoqërinë, kontratë e cila duhej të lidhej që në momentin e emërimit të tyre, ku të jetë parashikuar, ndër të tjera, kritere të qarta performance që pritej t'ë arrinin në terma vjetorë. Objektivat për performancën (indikatorët) e vendosur në kontratë, duhet të miratoheshin edhe nga ministria e linjës dhe duhet të jenë të matshme në përputhje me biznes planet e shoqërisë. Veprim në kundërshtim me nenin 12 pika 3 e Statutit të Ujësjetllës Kanalizime Elbasan SHA, të miratuar me Vendim të Asamblesë së Përgjithshme nr. 516, datë 31.03.2016, VKM nr. 63 i datës 20.01.2016 ëPër riorganizimin e operatorëve që ofrojnë shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm, grumbullimin, largimin dhe trajtumin e ujërave të ndoturaë</p>	<p>Pika 2.2, fq 14-23</p>	<p>E lartë</p>	<p>Nga kryetari i Bashkisë Elbasan në cilësinë e përfaqësuesit të Asamblesë së Përgjithshme të lidhen kontratat me anëtarët e Këshillit të Administrimit, në të cilat të parashikohen kritere të qarta performance/objektiva që priten të arrihen në terma vjetorë. Objektivat për performancën (indikatorët) e vendosur në kontratë duhet të miratohen edhe nga ministria e linjës dhe duhet të jenë të matshme në përputhje me biznes planet e Shoqërisë.</p>

3	<p>Për periudhën objekt auditimi, me Administratorin e Shoqërisë nuk është lidhur kontratë, pavarësisht se emërohet për një periudhë kohe prej tre vitesh, dhe qëndrimi i tij në detyrë gjatë periudhës tre vjeçare bëhet në bazë kontratash të rinovueshme vjetore ndërmjet tij dhe Asamblesë së Përgjithshme, bazuar në vlerësimet pozitive të performancës së punës së tij.</p>	Pika 2.2 fq 14-23	E lartë	<p>Në zbatim të vendimit nr. 11, datë 02.02.2021 të Asamblesë së Përgjithshme, të lidhet kontratë me Administratorin, në të cilën të parashikohen kritere të qarta performance/objektiva që priten të arrihen në terma vjetorë, si dhe të bëhen vlerësime vjetore të performancës së punës, bazuar në objektivat/kriteret e performancës të parashikuar në kontratë</p>
4	<p>Programet ekonomiko-financiar (buxhetet vjetor) janë hartuar dhe realizuar në pamjaftueshmëri financiare, pasi aktiviteti i shoqërisë nuk është i mbuluar plotësisht me buxhet. Konkretisht është programuar dhe realizuar me humbje për vitin 2020 dhe 2021. Në mënyrë të detajuar për vitin 2020, humbja është planifikuar në vlerën -42,749,527 lekë. Të ardhurat janë realizuar në vlerën 340,145,524 lekë, ndërsa shpenzimet janë realizuar në vlerën 385,924,232 lekë, me një humbje në vlerën 45,778,708 lekë.</p> <p>Për vitin 2021 humbja është planifikuar në vlerën -8,500,000 lekë. Të ardhurat janë realizuar në vlerën 384,633,550 lekë, ndërsa shpenzimet janë realizuar në vlerën 469,435,236 lekë, me një humbje në vlerën 84,801,686 lekë.</p>	Pika 2.3, fq 28-33	E mesme	<p>Organet drejtuese të shoqërisë duhet analizojnë dhe të vlerësojnë arsyet e produktivitetit të ulët të veprimtarisë ekonomiko-financiare, efektin e çdo risku të identifikuar, përfshirë një analizë të detajuar të detyrimeve ndaj të tretëve dhe në veçanti kreditë afatshkurtra e afatgjata, si dhe të merren masat e nevojshme për daljen nga kjo situatë që të çon drejt falimentimit.</p>
5	<p>Për periudhën e auditimit, përqindjet e arkëtimit vjetor total krahasuar me faturimin vjetor, janë në rritje nga viti në vit. Megjithatë arkëtimi korent është ai që tregon arkëtimin e faturimit të viteve përkatëse, dhe në fakt pavarësisht rritjes progresive është nën normat e konsideruara të pranueshme nga ERRU etj. Përsa i përket arkëtimit të debive të vjetra shoqëria ka akoma një vlerë të konsiderueshme të debisë për të mbledhur, pavarësisht përpjekjeve të saj për lidhjen e aktmarrëveshjeve me debitorët apo dërgim në përmbarim. Konkretisht në vitin 2019, arkëtimet totale janë në vlerën 323,162,000 lekë, ku arkëtimet korente janë në vlerën 211,683,000 lekë ose 65.5 % dhe arkëtimet e prapambetura janë në vlerën 111,509,000 lekë ose 34.51 %. Në vitin 2020, arkëtimet totale janë në</p>	Pika 2.3, fq 28-33	E mesme	<p>Organet Drejtuese të Shoqërisë të marrin masa për rritjen e arkëtimeve duke reduktuar humbjet menaxheriale të shoqërisë</p>

	<p>vlerën 322,594,000 lekë, ku arkëtime korente janë në vlerën 138,070,230 lekë ose 57.2 %, ndërsa arkëtimet e prapambetura në vlerën 138,070,230 lekë ose 42.8 % Në vitin 2021, arkëtimet totale janë në vlerën 368,813,000 lekë, ku arkëtime korente janë në vlerën 252,715,000 lekë ose 68.52 %, ndërsa arkëtimet e prapambetura janë në vlerën 116,098,000 lekë ose 31.48 %. Shoqëria duhet të ketë në konsideratë se norma e arkëtimit është një nga treguesit më të rëndësishëm të shoqërisë, e cila lidhet me qëndrueshmërinë financiare të Shoqërisë dhe me aftësinë e saj paguese.</p>			
6	<p>Për periudhën objekt auditimi u konstatua se mungojnë parashikimet specifike në drejtim të zhvillimit dhe administrimit të procesit të rekrutimeve të reja, si dhe të rregullave të parashikuara në Statut ose Rregullore të procedurave/kritereve/garancive lidhur me transferimet dhe ngritjet në detyrë. Në të gjithë deklaratimet për vende të lira pune për periudhën objekt auditimi nuk deklarohet afati brenda të cilit individët mund të paraqesin aplikimet e tyre. Për më tepër, në shumë raste evidentohet kohë shumë e shkurtër nga momenti i deklaratimit të pozicionit të lirë të punës deri në momentin e emërimit në punë të fituesit. Në disa raste mungesa e deklaratimeve për vende të lira pune në Zyrën e Punësimit Elbasan, kriteret e nevojshme për përzgjedhjen/rekrutimin në pozicionet e lira, si dhe për të njëjtin pozicion pune nuk janë të njëjësuarat kriteret e nevojshme për punësim.</p>	<p>Pika 2.4, fq 38-43</p>	<p>E mesme</p>	<p>Nga organet drejtuese të bëhen parashikime të detajuara statutore dhe rregullatore lidhur me zhvillimin dhe administrimin e procesit të rekrutimeve të reja, si dhe të procedurave/kritereve/garancive lidhur me transferimet dhe ngritjet në detyrë Nga organet drejtuese të bëhet adresim korrekt në rregullore i përgjegjësive të punonjësve bazuar në lidhjen shkakësore të veprimeve të tyre me pasojat e kundërta ligjshme që mund të shkaktohen. Nga Administratori i Shoqërisë të përcaktohet në deklaratimet për pozicione të lira pune, edhe afati brenda të cilit të interesuarit për pozicionin e punës duhet të shprehin interesin dhe paraqesin dokumentacionin e nevojshëm provues</p>
7	<p>Në 7 raste për vlerën 9,307 mijë lekë me TVSH janë kryer shpenzime për blerje Hipoklorit Natriumi pa dokumentacion të plotë vërtetues. Konkretisht certifikatat e origjinës janë me logo nga Shoqëria òAò shpk, shoqëri e pa akredituar nga organet e vlerësimit të konformitetit në Republikën e Shqipërisë. Faturat nuk shoqërohen me certifikatën e analizës nga Instituti i Shëndetit Publik, ose</p>	<p>Pika 2.5, fq 43-65</p>	<p>E lartë</p>	<p>Administratori i Shoqërisë të sigurojë marrjen e veprimeve korrigjuese në mënyrë që të gjitha shpenzimet për blerjen e Hipoklorit të Natriumi të bëhen në përputhje me Standardet Teknike të parashikuara në specifikimet teknike.</p>

	dëshmi të lëshuara nga autoritete/institucione/ente të autorizuar për lëshimin e tyre, për analizë toksikologjike për NaOCl (hipoklorit natriumi) të marrë brenda tre muajve të fundit nga data e zhvillimit të tenderit, referuar kërkesave për kualifikim pikës 2.3.3 të kapacitetit teknik (shtojcë datë 06.02.2020), për pasojë nuk mund të verifikohet zbatimi/ose jo i specifikimeve.			
8	Në 8 raste për vlerën 5187 mijë lekë me TVSH janë kryer shpenzime për blerje karburant (dizel dhe benzinë) pa dokumentacion të plotë vërtetues. Konkretisht faturat nuk shoqërohen me raport analizë para zhdoganimit, të lëshuar nga Laboratori i Kontrollit të Naftës dhe Gazit, (Drejtoria e Labororit Qendror të Kontrollit; Inspektorati Shtetëror Teknik dhe Industrial), për pasojë nuk mund të verifikohet zbatimi/ose jo i specifikimeve teknike	Pika 2.5, fq 43-65	E lartë	Administratori i Shoqërisë të sigurojë marrjen e veprimeve korrigjuese në mënyrë që të gjitha shpenzimet për blerjen e karburant (dizel dhe benzinë) të bëhen në përputhje me Standardet Teknike të parashikuara në specifikimet teknike
9	Në 13 raste për vlerën 69,210 mijë lekë me TVSH janë kryer shpenzime për blerje materiale hidraulike. Proces verbalet e marrjes në dorëzim janë të firmosura grupet e marrjes në dorëzim, duke mos cilësuar zbatimin ose jo të specifikimeve teknike (shtojca 9 e dokumenteve të tenderit) Shtojca 6 ÷Deklaratë mbi përmbushjen e specifikimeve teknike nga operatori ekonomik dhe nenin 9/1 i kontratës ÷Mallrat e furnizuara sipas kontratës duhet të jenë konform kodeve dhe Standardeve Teknike të parashikuara në specifikimet teknike.	Pika 2.5, fq 43-65	E lartë	Titullari i Autoritetit Kontraktor duhet të nxjerri urdhër/urdhra me qëllim ndjekjen me përpikmëri të zbatimit të kontratave, duke përfshirë dhe marrjen në dorëzim të aktiveve të furnizuara, për sasinë, cilësinë, llojin si dhe dokumentacionin shoqërues të tyre.
10	Në 7 raste në vlerën 348,655 mijë lekë kriteret e veçanta për kualifikimit nuk janë vendosur plotësisht konformë akteve ligjore dhe rregullatorë për prokurimet publike. Veprim në kundërshtim me Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2009, ÷Për Prokurimin Publikë, i ndryshuar, neni 46, VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publikë, i ndryshuar, neni 26, pika 5, Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 42, datë 16.01.2008, ÷Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit	Pika 2.7, fq 71-111	E lartë	Autoriteti Kontraktor, në vijimësi duhet të hartojë kërkesat e veçanta për kualifikim/specifikimet teknike, që të sigurojë transparencë, trajtim të barabartë të gjithë operatorëve ekonomikë të interesuar në kontratat publike, mos diskriminim dhe konkurrencë.

	të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi, kreu III, pika 1/a, Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 108, datë 09.02.2011, për aftësitë që duhet të plotësojnë punëmarrësit, personat dhe shërbimet e specializuara, që merren me çështjet e sigurisë dhe të shëndetit në punë, i ndryshuar, shkresën e Agjencisë së Prokurimit Publik (Drejtoria juridike dhe e Monitorimit), nr. 3341/1 prot., datë 20.03.2018			
11	Në 5 procedura prokurimi për vlerën 244,882 mijë lekë, kualifikimi, shpallja fitues e operatorëve ekonomik nga KVO, si dhe lidhja e kontratave, është kryer në mënyrë të padrejtë. Veprim në kundërshtim me Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 për prokurimin publik, i ndryshuar, neni 46, neni 53 pika 3, VKM nr. 914, datë 29.12.2014 rregullat e Prokurimit, i ndryshuar, neni 66 pika 3, Ligjin nr. 44/2015 Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë nën 108-118	Pika 2.7, fq 72-111	E lartë	Nga Shoqëria t'i kushtohet vëmendje e duhur institucionale procesit të shqyrtimit dhe vlerësimit nga komisionet e vlerësimit të ofertave, i dokumentacionit ligjor dhe administrativ të operatorëve ekonomik dhe ofertave të ofertuesve, pasi rëndësia e procesit të shqyrtimit, kualifikimit dhe shpallja fitues të operatorëve është me rëndësi kapitale
12	Në procedurën e prokurimit me objekt instalimi i teknologjive të reja në stacionet e pompimit në sistemin Mengël-Samurr-Godolesh, (për zëvendësimin e pompave dhe pajisjeve viti 2019, në vlerën 56,418 mijë lekë dhe procedurën e prokurimit rikonstruksion i rrjetit të brendshëm ekzistues të linjave në Rrugët 11 Nëntori, Rruga Ali Çaushi, Rruga Faik Neziri, Rruga Veli Stafa, një pjesë të Lagjes Çlirim dhe 11 Nëntori të Bashkisë Elbasan, viti 2019 në vlerën 23,002 mijë lekë, nuk është siguruar kontrata për humbje ose dëmtim të punimeve, pajisjeve, materialeve, humbje ose dëmtim të kantierit ose pronave të tjera në kantier dhe dëmtimet personale ose vdekjet e palëve të treta, si dhe deri në datën e hartimit të këtij konstatimi Autoriteti Kontraktor, nuk ka zgjatur periudhën e paraqitjes të policës së sigurimit ose nuk ka bërë vet siguracionin dhe të zbritjes së kostos së tij nga pagesa që i jep kontraktorit. Veprim në kundërshtim me neni 25 të kontratës së lidhur, pika 1 dhe 2.	Pika 2.7, fq 72-111	E lartë	Nga Administratori i Shoqërisë të merren masa për të korrigjuar këtë praktikë në sigurimin e kontratave, me qëllim jo vetëm lidhja tyre të shoqërohet me policë e sigurimi, por edhe për të parandaluar për të ardhmen përsëritjen e rasteve të tilla.

1.3. Konkluzioni dhe Opinioni i Auditimit

Ne kemi përfunduar auditimin e përputhshmërisë dhe të rregullshmërisë të Shoqërisë ÷Ujësjetllës Kanalizime Elbasanë SHA, për periudhën e veprimtarisë nga data 01.01.2019 deri me datë 31.12.2021. Nga auditimi i ushtruar u konstatua se aktiviteti i Shoqërisë në përgjithësi përputhet me kërkesat dhe kriteret e kuadrit ligjor në fuqi. Pavarësisht sa u citua si më sipër, për periudhën objekt auditimi u konstatuan edhe shkelje të kuadrit nënligjor dhe rregullator të cilat konsistojnë në: Organizimin dhe funksionimin të organeve drejtuese, zbatimin e kontratave për punë publike (pajisjet), transaksioneve financiare për shpenzimet, hartimin dhe miratimin e pasqyrave financiare, hartimin dhe zbatimin e programit ekonomik, pagave dhe shpërblimeve, etj.

OPINIONI I AUDITIMIT

Opinion mbi përputhshmërinë dhe rregullshmërinë (i kualifikuar)

Në vlerësimin tonë, rezultati i auditimit për çështjet e përputhshmërisë dhe të rregullshmërisë së veprimtarisë ekonomike dhe financiare të Shoqërisë ÷Ujësjetllës Kanalizime Elbasanë SHA, për periudhën nga 01.01.2019 deri me datë 31.12.2021, nuk është në përputhje në të gjitha aspektet materiale me kriteret e përcaktuara në këtë auditim, që kanë të bëjnë me kuadrin ligjor, nënligjor dhe rregullator të aktivitetit të kësaj Shoqërie. Krahas parregullsive materiale sasiore të konstatuara, grupi i auditimit në dhënien e opinionit ka marrë në konsideratë dhe gabime/parregullsi të caktuara të natyrës cilësore, pavarësisht vlerës së tyre.

Në opinionin tonë, bazuar në evidencat e auditimit dhe dokumentacionin e vënë në dispozicion kemi konstatuar se në veprimtarinë e Shoqërisë “Ujësjetllës Kanalizime Elbasanë” SHA, janë evidentuar devijime nga kuadri ligjor dhe rregullator në fuqi, të përshkruara në paragrafin e “Bazës për Opinionin”, të cilat nën gjykimin profesional të audituesit të pavarur janë materiale por jo të përhapura dhe justifikojnë dhënien e një opinioni të modifikuar/kualifikuar të përputhshmërisë dhe rregullshmërisë.

Baza për opinionin e modifikuar/kualifikuar të përputhshmërisë dhe rregullshmërisë.

Ne jemi përpjekur të sigurohemi që konkluzionet dhe opinionet e tona të kenë një siguri të arsyeshme, si rrjedhojë e punës sonë audituese, si dhe për shkak të kufizimeve të vetvetishme të një auditimi, pasi normalisht nuk mund të jepet një siguri në shkallën maksimale.

Konkluzionet dhe opinionin ynë janë të bazuara në kompetencën për vlerësim objektiv dhe profesional të evidencës së auditimit të kërkuar dhe të vënë në dispozicion nga Shoqëria ÷Ujësjetllës Kanalizime Elbasanë SHA, e cila konsiderohet nga ana e jonë përfaqësuese, e mjaftueshme, e përshtatshme dhe e besueshme.

Ne kemi përdorur gjykimin objektiv dhe kemi zbatuar skepticizmin profesional në vlerësimin e sasisë dhe cilësisë së evidencave dhe në këtë mënyrë kemi kontribuar në garantimin e mjaftueshmërisë dhe përshtatshmërisë së tyre me qëllimin e dhënies së një opinioni me siguri të arsyeshme.

Auditimi është kryer sipas standardeve të cilat bazohen në Parimet Themelore të Auditimit niveli 3 (ISSAI 100 - 999) të Standardeve Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit.

Procedurat e auditimit të bazuara në Standardet Ndërkombëtare të Auditimit: ISSAI 400 ÷Standardet e Auditimit të Përputhshmërisë, ISSAI 1500 (ISA 500) dhe ISSAI 1530 (ISA 530); Manuali i Auditimit të Përputhshmërisë, si dhe dokumentimi i auditimit në përputhje me kërkesat e Rregullores së Procedurave të Auditimit, kanë shërbyer si bazë për arritjen e

konkluzioneve dhe dhënien e opinionit në këtë auditim përputhshmërie.

Ne kemi mbledhur dhe vlerësuar evidencën e auditimit, si dhe kemi konkluduar me gjetje dhe rekomandime në lidhje me fushën/objektin e auditimit, qasjen, kohën dhe burimet, me qëllim për të kryer një punë audituese që redukton në një nivel të ulët të pranueshëm, riskun e një konkluzioni ose opinionit të gabuar rreth objektivit të auditimit.

Bazuar në punën e kryer të auditimit, nga gjetjet që kanë shërbyer si bazë për dhënien e opinionit të mësipërm, veçojmë:

-Nga auditimi i zbatimit të kontratës nga Shoqëria òAö shpk, me objekt òMaterialet hidraulike, në vlerën 40,771,612 lekë, viti 2021, u konstatua se dokumentacioni teknik dhe ligjor i blerjes së materialeve, nuk është i plotë dhe i saktë.

-Anëtarët e Këshillit të Administrimit të Shoqërisë òUjësjetllës Kanalizimeö Sh.A, Elbasan, nuk kanë lidhur kontratë me shoqërinë, kontratë e cila duhej të lidhej që në momentin e emërimit të tyre, ku të jetë parashikuar, ndër të tjera, kritere të qarta performance që pritej t'arrinin në terma vjetorë. Objektivat për performancën (indikatorët) e vendosur në kontratë, duhet të miratoheshin edhe nga ministria e linjës dhe duhet të ishin të matshme në përputhje me biznes planet e shoqërisë.

-Me Administratorin e Shoqërisë nuk është lidhur kontratë, pavarësisht se emërohet për një periudhë kohe prej tre vitesh, dhe qëndrimi i tij në detyrë gjatë periudhës tre vjeçare bëhet në bazë kontratash të rinovueshme vjetore mes tij dhe Asamblesë së Përgjithshme, bazuar në vlerësimet pozitive të performacës së punës së tij.

-Nuk është publikuar në faqen e internetit të Shoqërisë òUjësjetllës Kanalizimeö Sh.A, Elbasan dokumentacioni i detyrueshëm për t'u publikuar, sipas parashikimeve të këtyre akteve, ndër të tjera lidhur me procesverbalet e mbledhjeve të Asamblesë së Përgjithshme të cilat duhet të ishin të publikuara në faqen zyrtare të internetit të UK Elbasan jo më vonë se 15 ditë nga data e mbledhjes për të cilën janë mbajtur.

-Në 7 raste për vlerën 9,307 mijë lekë me TVSH janë kryer shpenzime për blerje Hipoklorit Natriumi pa dokumentacion të plotë vërtetues. Konkretisht certifikatat e origjinës janë me logo nga Shoqëria òAö òCö shpk, shoqëri e pa akredituar nga organet e vlerësimit të konformitetit në Republikën e Shqipërisë. Faturat nuk shoqërohen me certifikatën e analizës nga Instituti i Shëndetit Publik, ose dëshmi të lëshuara nga autoritete/institucione/ente të autorizuar për lëshimin e tyre, për analizë toksikologjike për NaOCl (hipoklorit natriumi) të marrë brenda tre muajve të fundit nga data e zhvillimit të tenderit, referuar kërkesave për kualifikim pikës 2.3.3 të kapacitetit teknik (shtojcë datë 06.02.2020), për pasojë nuk mund të verifikohet zbatimi/ose jo i specifikimeve.

-Në 8 raste për vlerën 5187 mijë lekë me TVSH janë kryer shpenzime për blerje karburant (dizel dhe benzinë) pa dokumentacion të plotë vërtetues. Konkretisht faturat nuk shoqërohen me raport analizë para zhdoganimit, të lëshuar nga Laboratori i Kontrollit të Naftës dhe Gazit, (Drejtoria e Laboratorit Qendror të Kontrollit; Inspektorati Shtetëror Teknik dhe Industrial), për pasojë nuk mund të verifikohet zbatimi/ose jo i specifikimeve teknike.

-Në 13 raste për vlerën 69,210 mijë lekë me TVSH janë kryer shpenzime për blerje materiale hidraulike. Proces verbalet e marrjes në dorëzim janë të firmosura grupet e marrjes në dorëzim, duke mos cilësuar zbatimin ose jo të specifikimeve teknike.

-Në 8 raste për vlerën 6,000 mijë lekë me TVSH janë kryer shpenzime, me dokument justifikues (faturë) të firmosur dhe vulosur vetëm nga furnitorët. Faturat nuk janë firmosur nga blerësi dhe transportuesit.

-Në 7 raste në vlerën 348,655 mijë lekë, kriteret e veçanta për kualifikimit nuk janë vendosur plotësisht konformë akteve ligjore dhe rregullatorë për prokurimet publike.

-Në procedurën e prokurimit me objekt òHipoklorit natriumi, viti 2020-2021, në vlerën

14,248 mijë lekë, ÷Blerje materiale hidraulike, viti 2021 në vlerën 35,000 mijë lekë, ÷Blerje matësia uji individuale ½, ¾ dhe 1, viti 2019, në vlerën 10,668 mijë lekë, përlllogaritja e vlerës së kontratës është bërë duke u mbështetur në çmimet e tregut, por nuk është dhënë asnjë argumentim përse nuk është i është referuar edhe alternativave të tjera, si çmimet e kontratave të mëparshme të realizuara nga autoritete të tjera kontraktore, ose/dhe çmime të tjera zyrtare, të njohura nga institucionet përkatëse (si për shembull, nga organet tatimore a doganore, dhomat e tregtisë, etj).

-Në 5 procedura prokurimi për vlerën 244,882 mijë lekë, kualifikimi, shpallja fitues e operatorëve ekonomik nga KVO, si dhe lidhja e kontratave, është kryer në mënyrë të padrejtë.

-Në procedurën e prokurimit me objekt ÷Instalimi i teknologjive të reja në stacionet e pompimit në sistemin Mengël-Samurr-Godolesh, (për zëvendësimin e pompave dhe pajisjeve viti 2019, në vlerën 56,418 mijë lekë dhe procedurën e prokurimit “Rikonstruksion i rrjetit të brendshëm ekzistues të linjave në Rrugët ÷11 Nëntori, Rruga ÷Ali Çausi, Rruga ÷Faik Neziri, Rruga ÷Veli Stafa, një pjesë të Lagjes ÷Çlirimi dhe ÷11 Nëntori të Bashkisë Elbasan, viti 2019 në vlerën 23,002 mijë lekë, nuk është siguruar kontrata për humbje ose dëmtim të punimeve, pajisjeve, materialeve, humbje ose dëmtim të kantierit ose pronave të tjera në kantier dhe dëmtimet personale ose vdekjet e palëve të treta, si dhe deri në datën e hartimit të këtij konstatimi Autoriteti Kontraktor, nuk ka zgjatur periudhën e paraqitjes të policës së sigurimit ose nuk ka bërë vet siguracionin dhe të zbresi koston e tij nga pagesa që i jep kontraktorit.

-Programet ekonomik-financiar (buxhetet vjetor) janë hartuar dhe realizuar në pamjaftueshmëri financiare, pasi aktiviteti i shoqërisë nuk është i mbuluar në fakt plotësisht me buxhet, konkretisht është programuar dhe realizuar me humbje për vitin 2020 dhe 2021.

- Përqindjet e arkëtimit vjetor total krahasuar me faturimin vjetor, janë në rritje nga viti në vit, megjithatë arkëtimi korent është nën normat e konsideruara të pranueshme nga ERU etj.

-Mungojnë parashikimet specifike në drejtim të zhvillimit dhe administrimit të procesit të rekrutimeve të reja, si dhe të rregullave të parashikuara në Statut ose Rregullore të procedurave/kritereve/garancive lidhur me transferimet dhe ngritjet në detyrë.

-Nuk është kryer inventari fizik i aktiveve, por vetëm inventari i imët, pajisje zyre dhe ai ekonomik, si dhe nuk është mbajtur regjistri i aktiveve

- Asetet nuk janë regjistruar në Drejtorinë Vendore të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Elbasan.

Përgjegjësitë e strukturave drejtuese të Shoqërisë “Ujësjetës Kanalizime Elbasan” SHA.

Strukturat ekzekutive dhe drejtuese të Shoqërisë ÷Ujësjetës Kanalizime Elbasan SHA, janë përgjegjëse për përdorimin e fondeve publike (burimeve financiare) në përputhje me politikën, ligjet dhe rregulloret e aplikuara (kriteret e vlerësimit), kryesisht dhe veçanërisht ato për zbatimin e gjithë kuadrit ligjor, nënligjor dhe rregullator për emergjencat civile.

Gjithashtu, është përgjegjësi e drejtuesve të njësisë publike të përgjigjen dhe të jenë transparente për veprimtarinë e tyre, si edhe të sigurojnë se i administrojnë këto fonde dhe procedura prokurimi në pajtim me kriteret ligjore, nënligjore e rregullatore.

Përgjegjësitë e Audituesve të KLSH mbi Auditimin e Përputhshmërisë dhe Rregullshmërisë:

Objektivi i audituesit të jashtëm publik lidhet me garantimin e sigurisë së arsyeshme, nëse veprimtaria e subjektit të audituar është zhvilluar në përputhje me kriteret e paracaktuara, si dhe për të konkluduar me një raport auditimi që përfshin arritjen e konkluzioneve dhe dhënien e një opinioni të arsyeshëm. Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë sigurie, por

nuk garanton që auditimi i kryer në përputhje me standardet mundëson identifikimin e çdo gabimi apo anomalie që mund të ekzistojë. Përveç standardeve ISSAI, audituesi i KLSH, gjithashtu aplikon edhe gjykimin dhe skepticismin e tij profesional në punën audituese. Auditimi ka identifikuar çështjet më të rëndësishme lidhur me zbatueshmërinë e kriterëve të vlerësimit, kuadrin ligjor dhe rregullator nga ana e subjektit, me përjashtim të rasteve kur kuadri ligjor nuk lejon vënien në dispozicion të tyre për publikun ose në raste të rralla kur vetë ne vendosim që këto çështje nuk duhet të përfshihen në raport për shkak të pasojave negative që publikimi i tyre mund të sjellë në publikun e gjerë. Audituesit e KLSH kanë respektuar në vijimësi kërkesat Kodit të Etikës të KLSH, në lidhje organike më të gjithë kërkesat e kuadrit ligjor rregullator të veprimtarisë menaxheriale audituese institucionale. Audituesit e KLSH janë përgjegjës për të siguruar cilësinë e auditimit, duke zbatuar procedurat e kontrollit të cilësisë gjatë gjithë procesit të auditimit, me synim marrjen e sigurisë, se auditimi është në përputhje me standardet e aplikueshme dhe se raporti i auditimit, konkluzionet dhe opinioni i auditimit janë të përshtatshme. Ky auditim përputhshmërie dhe rregullshmërie promovon përgjegjshmërinë ndaj devijimeve të raportimit dhe ndaj shkeljeve të kuadrit ligjor, nënligjor dhe rregullator, në mënyrë që të mund të merren veprime korigjuese dhe personat përgjegjës të përgjigjen për veprimet e tyre.

II. HYRJA

Mbështetur në Ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 për organizimin dhe funksionimin e KLSH, në zbatim të projektit dhe programit të auditimit të miratuar nga Kryetari i KLSH nr. 247/1 prot., datë 11.03.2022, i ndryshuar, nga data 15.03.2022 deri 11.05.2022, në Shoqërinë ÷Ujësjellës Kanalizime Elbasanë SHA, për periudhën nga data 01.01.2019 deri me datë 31.12.2021, u krye auditimi ÷Përputhshmërisë me përbërje:

1. F. I., Përgjegjës grupi,
2. K. Sh., Audituese,
3. B. Sh., Auditues,

OBJEKTIVAT, FUSHËVEPRIMI DHE METODOLOGJIA

a. Objekti i auditimit: Objektivi kryesor i grupit të auditimit të KLSH, është dhënia e opinionit për përdorimin ligjor të fondeve dhe rregullshmëria financiare e paraqitjes së dokumentacionit që Shoqëria ÷Ujësjellës Kanalizime Elbasanë SHA ka bërë me fondet në dispozicion, në bazë të akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi, duke audituar rregullaritetin, ligjshmërinë e transaksioneve, si dhe argumentimin e shpenzimeve të kryera në funksion të aktivitetit të Shoqërisë.

b. Qëllimi i auditimit:

Auditimi ka për qëllim të vlerësojë dhe evidentojë shkeljet e parimeve të ligjshmërisë dhe menaxhimit të shëndoshë financiar, si edhe shfrytëzimin me efikasitet, efektivitet dhe ekonomikitet të pasurisë shtetërore dhe fondeve publike. Ky sistem bën të mundur ndërmarrjen e veprimeve korigjuese sipas rastit, rritjen e përgjegjshmërisë, llogaridhënies, rikuperimin e dëmeve të shkaktuara si dhe parandalimin e shkeljeve, me synim rritjen e vlerës së parasë publike në mbrojtje të interesave të taksapaguesve.

c. Identifikimi i çështjes:

Shoqëria ÷Ujësjetllës Kanalizime Elbasanë SHA, duhet të ketë organizimin e duhur, duhet të funksionojë duke respektuar aktet ligjore e nënligjore në fuqi për përgjegjësitë e saj funksionale, duke patur në konsideratë shpenzimin e fondeve me ekonomicitet, eficiencë dhe efektivitet.

d. Përgjegjësitë e strukturave drejtuese të subjektit të audituar lidhur me çështjen nën auditim:

Menaxhmenti është përgjegjës për përdorimin e fondeve publike (burimeve financiare) në përputhje me politikat, ligjet dhe rregulloret e aplikuara (kriteret e vlerësimit), kryesisht dhe veçanërisht ato për zbatimin e gjithë kuadrit ligjor, nënligjor dhe rregullator në shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm dhe grumbullimit dhe largimit të ujërave të ndotura. Gjithashtu, është përgjegjësi e drejtuesve të njësisë publike të përgjigjen dhe të jenë transparentë për veprimtarinë e tyre, si edhe të sigurojnë se i administrojnë këto fonde dhe procedura prokurimi në pajtim me kriteret ligjore, nënligjore e rregullatorë.

e. Përgjegjësitë e audituesve:

Audituesit janë përgjegjës për shprehjen e konkluzioneve dhe dhënien e opinionit për auditimin. Auditimi është bërë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit INTOSAI. Janë respektuar kërkesat etike, është planifikuar dhe kryer auditimi, sipas të cilit është arritur niveli i sigurisë së kërkuar.

f. Kriteret e vlerësimit: Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (ISA)IFAC; (ISSAI) të INTOSAI-t; Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë dhe Baza Ligjore:

Ligji nr. 154/2014, datë 27.11.2014 ÷Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit; Ligji nr. 9901, datë 14.04.2008 ÷Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare, i ndryshuar; Ligji nr. 8102, datë 28.3.1996 ÷Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura, i ndryshuar; Ligji nr. 8975, datë 21.11.2002 ÷Për trajtimin e faturave të ujit të pijshëm dhe largimit të ujërave të ndotura si titull ekzekutiv, i ndryshuar; Ligji nr. 8901, datë 23.05.20012 ÷Për falimentin, i ndryshuar; Ligji nr. 9115, datë 24.07.2003 ÷Për trajtimin mjedisor të ujërave të ndotura i ndryshuar; Ligji nr. 25/2018, ÷Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare; Ligji nr. 10405, datë 24.3.2011 ÷Për kompetencat për caktimin e pagave dhe të shpërblyeve; Ligji nr. 8487, datë 13.5.1999 ÷Për kompetencat për caktimin e pagave të punës, i ndryshuar; Ligji nr. 9643, datë 20.11.2006 ÷Për prokurimin publik, i ndryshuar; Ligji nr. 162, datë 23.12.2020, ÷Për prokurimin publik; Ligji nr. 9920, datë 19.5.2008 ÷Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë, i ndryshuar; Ligji nr. 8402, datë 10.09.1998 ÷Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit, i ndryshuar, Ligji nr. 7892, datë 21.12.1994 ÷Për Sponsorizimet, i ndryshuar; Ligji nr. 10296, datë 8.7.2010 ÷Për menaxhimin financiar dhe kontrollin i ndryshuar; Ligji nr. 9154, datë 26.11.2003 ÷Për arkivat, Ligji nr. 7961, datë 12.07.1995 ÷Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë, i ndryshuar; Ligji nr. 9720, datë 23.04.2007 ÷Për auditimin e brendshëm në sektorin publik, i ndryshuar; Ligji nr. 8510, datë 15.07.1999 ÷Për përgjegjësinë jashtë kontraktore të organeve të administratës shtetërore, i ndryshuar, Ligji nr. 44/2015 datë 30.04.2015 ÷Kodi i procedurave administrative të Republikës së Shqipërisë; Ligji 107/2014 ÷Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit i ndryshuar; Ligji nr. 8116, date 29.03.1996 ÷Kodi i procedurës civile i Republikës e Shqipërisë, i ndryshuar. VKM nr. 1304, datë 11.12.2009 ÷Për miratimin e rregullores për furnizimin me ujë të pijshëm dhe për kanalizimet në zonën e shërbimit të UKë; VKM nr. 236, datë 10.5.1993 ÷Për administrimin dhe furnizimin me ujë tek përdoruesit familjar dhe jo familjar, i ndryshuar; VKM nr. 63, 27.01.2016

oPër riorganizimin e operatorëve që ofrojnë shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm, grumbullimin largimin dhe trajnimin e ujërave të ndotura, me objekt shërbimi në zbatim të Ligjit nr. 115/2014 oPër ndarjen administrative-territoriale të njësive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë, VKM nr. 510, datë 10.05.2015 oPër miratimin e procedurave për transferimin e të drejtave dhe detyrimeve, personelit, aktiveve të trupëzuara, të arkivave dhe çdo dokumentacioni tjetër zyrtar në njësitë e qeverisjes vendore, të prekura nga riorganizimi administrativo-territorial; VKM nr. 914 date 29.12.2014 oRregullat e Prokurimit" i ndryshuar; Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.5.2021, oPër miratimin e rregullave të prokurimit publik; VKM nr. 870, datë 14.12.2011, oPër trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë vendit; VKM nr. 997, datë 10.12.2010, oPër trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë qendrës së punës, brenda vendit, me ndryshimet vijuese të tij.

g. Standardet e auditimit:

- ISSAI 100- *(Parimet themelore të auditimit të sektorit publik);*
- ISSAI 4000- *(Standardi i Auditimit të Përputhshmërisë);*
- ISSAI 400 - *(Parimet themelore të Auditimit të Përputhshmërisë);*
- SNA) të IFAC - *(Standardet Ndërkombëtare të Auditimit);*
- Manual i IDI-t -*(Implementimi i Standardeve Ndërkombëtare te Auditimit ISSAI për auditimet e përputhshmërisë);*
- *Manuali i Auditimit të Përputhshmërisë;*
- Rregullore e Procedurave të Auditimit në KLSH-së;*
- Kodi etik i KLSH.*

h. Metoda e auditimit:

Auditim i njëpasnjëshëm me zgjedhje dhe ose i plotë sipas gjykimit të audituesit.

i. Dokumentimi i auditimit:

Dokumentimi i rezultateve të auditimit u mbështetet në kërkesat e Manualit të Auditimit të Përputhshmërisë, miratuar me Vendimin e Kryetarit të KLSH-së nr. 196, datë 29.12.2015, si edhe në Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit ISSAI 1230 oDokumentimi i Auditimit.

Nga audituesit u përgatit dokumentacioni i auditimit i mjaftueshëm për të mundur dhe kuptuar natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit të kryera në përputhje me standardet përkatëse dhe kërkesat e zbatueshme ligjore dhe rregullatore, rezultatet e këtyre procedurave dhe evidencat e marra të auditimit, si dhe çështje të rëndësishme, që dolën gjatë auditimit, përfundimet e arritura në drejtim të tyre dhe gjykimet e rëndësishme profesionale të bëra në arritjen e këtyre konkluzioneve.

III. PËRSHKRIMI I AUDITIMIT

1. Informacion i përgjithshëm mbi subjektin nën auditim

Organizmi dhe funksionimi i Shoqërisë është në zbatim të Ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008 oPër tregtarët dhe shoqëritë tregtare, i ndryshuar, VKM nr. 63, 27.01.2016 oPër riorganizimin e operatorëve që ofrojnë shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm, grumbullimin largimin dhe trajnimin e ujërave të ndotura, me objekt shërbimi në zbatim të Ligjit nr. 115/2014 oPër ndarjen administrative-territoriale të njësive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë, VKM nr.

510, datë 10.05.2015 òPër miratimin e procedurave për transferimin e të drejtave dhe detyrimeve, personelit, aktiveve të trupëzuara, të arkivave dhe çdo dokumentacioni tjetër zyrtar në njësitë e qeverisjes vendore, të prekura nga riorganizimi administrativo-territorialò.

- Objekti i shoqërisë brenda territorit të bashkisë së krijuar sipas Ligjit nr. 115/2014, òPër ndarjen administrative-territoriale të njësive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë, është:

-Shërbimi i furnizimit me ujë të pijshëm i konsumatorëve dhe shitja e tij;

-Mirëmbajtja e sistemit/sistemeve të furnizimit me ujë të pijshëm;

-Prodhimi dhe/ose blerja e ujit për plotësimin e kërkesës së konsumatorëve;

-Shërbimi i grumbullimit, largimit dhe trajtimit të ujërave të ndotura;

-Mirëmbajtja e sistemeve të ujërave të ndotura, si dhe të impianteve të pastrimit të tyre;

-Shoqëria duhet të realizojë çdolloj operacioni financiar apo tregtar që lidhet direkt apo indirekt me objektin e saj, brenda kufijve të parashikuar nga legjislacioni në fuqi;

-Shoqëria ushtron veprimtarinë e saj në përputhje me lejet, autorizimet, liçensat sipas legjislacionit në fuqi.

2. Përshkrimi i auditimit, sipas drejttimeve të auditimit.

2.1. Mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna nga auditimi i mëparshëm i KLSH-së.

Shoqëria òUjësjetllës Kanalizime Elbasanò SHA e ka fituar statusin juridik në datën 31.03.2016. Nga data 31.03.2016 deri në datën 31.12.2018, Kontrolli i Lartë i Shtetit nuk ka ushtruar auditim në këtë Shoqëri, për rrjedhojë auditimi i kësaj pike të programit quhet e ezauruar. Theksojmë se periodha e auditimit është 01.01.2019-31.12.2021.

2.2. Mbi zbatimin e ligjshmërisë për emërimet dhe funksionimin e strukturave drejtuese, (Këshilli Drejtues dhe Administratori) vendimet e marra dhe zbatimi i tyre.

Referuar Statutit të Shoqërisë të miratuar me vendim të Asamblesë së Përgjithshme nr. 516, datë 31.03.2016, organet drejtuese të Shoqërisë janë Asambleja e Përgjithshme dhe Këshilli i Administrimit.

Me Vendim të Asamblesë së Përgjithshme nr. 373/1, datë 01.04.2019 janë emëruar anëtarë të Këshillit të Administrimit z.Q. T., z. S. P. dhe z.L. D.

Me Vendim të Asamblesë së Përgjithshme, nr. 16 i datës 14 Tetor 2020 është emëruar anëtar i Këshillit të Administrimit z. S. N. pas lirimit nga detyra të z.Q. T.

Me Vendim të Asamblesë së Përgjithshme, nr. 9 i datës 1 shkurt 2021 është anëtar i Këshillit të Administrimit z. L. K. pas lirimit nga detyra të z. L. D. Po ashtu është emëruar edhe znj.A. B. në vend të z. S. N.

Anëtarët e Këshillit të Administrimit, nuk kanë lidhur kontratë me UKE sha, që prej datës së emërimit të tyre për gjithë periudhën e objekt auditimit.

Veprim në kundërshtim me nenin 12 pika 3 e Statutit të Ujësjetllës Kanalizime Elbasan SHA, VKM nr. 63 i datës 20.01.2016 òPër riorganizimin e operatorëve që ofrojnë shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm, grumbullimin, largimin dhe trajtimin e ujërave të ndoturaò ku është shprehur në mënyrë eksplicite òAnëtarët e Këshillit të Administrimit në momentin e emërimit lidhin me shoqërinë një kontratë pune, në të cilën janë parashikuar, ndër të tjera, kritere të qarta performance që pritet të arrijë anëtari i Këshillit të Administrimit në terma vjetorë. Objektivat për performancën (indikarët) e vendosur në këtë kontratë duhet të miratohen edhe nga ministria e linjës dhe duhet të jenë të matshëm dhe në përputhje me biznes planet e shoqërisë.

Për periudhën objekt auditimi Këshilli Administrativ ka marr 28 vendime, në vitin 2019 (7 vendime), në vitin 2020 (10 vendime) dhe në vitin 2021 (11 vendime) në mënyrë të detajuar si më poshtë vijon:

PËR VITIN 2019

71/1	20 gusht 2019	Vendim, miratim për për transferimin e fondeve (shërbime avalzhimi i motorëve të pompave me voltazh të ndryshëm) shuma 1.318.000 lekë pa TVSH
532/1	15.shkurt.2019	Vendim, krijimi i degës së auditimit të brendshëm
683	04 mars 2019	Vendim, miratimin e disa ndryshimeve në strukturën organizative dhe nivelin e pagave të disa pozicioneve të shoqërisë
841	18 mars 2019	Kërkesë, autorizim për përdorimin e fondit rezervë për blerje emergjente (pompë dhe motor 90 kë dhe panel i kompletuar montimi për stacionin e pompimit Mengel)
841/1	19 mars 2019	Vendim, miratim për përdorimin e fondit rezervë për blerje emergjente (pompë dhe motor 90 kë dhe panel i kompletuar montimi për stacionin e pompimit Mengel)
931	28 mars 2019	Kërkesë, propozimin për emërimin e ekspertëve kontabël të autorizuar për miratimin e bilancit të vitit 2018

1990	04 shtator 2019	Kërkesë, zgjedhja e Kryetarit të Këshillit të Administrimit UKE sha.
1990/1	06 shtator 2019	Vendim, zgjedhja e Kryetarit të Këshillit të Administrimit UKE sha. Kryetar z.A. Q. Zv/Kryetar z.Q. T.
2406	03 tetor 2019	Kërkesë, lista e dokumenteve për kontratat e pallateve pa hipotekë
2406/1	04 tetor 2019	Vendim, miratimin e dokumenteve që kërkohen për kontratat e pallateve pa hipotekë.

PËR VITIN 2020

931/1	29 mars 2019	Vendim, propozimin për emërimin e ekspertëve kontabël të autorizuar për miratimin e bilancit të vitit 2018 A. Q. dhe N. Ç.
1871	19 gusht 2019	Kërkesë, autorizim për transferimin e fondeve (shërbime avalzhimi i motorëve të pompave me voltazh të ndryshëm) shuma 1.318.000 lekë pa TVSH

Nr.prot	Data	Lënda
176	07 shkurt 2020	Kërkesë, për zëvendësimin e sekretares së Këshillit të Administrimit.
1	13 shkurt 2020	Vendim, për lirim nga detyra të sekretares së Këshillit të Administrimit znj. A. I. Emërimin në këtë pozicion të znj. M. P.
283	25 shkurt 2020	Kërkesë, propozimin për emërtimin e ekspertëve kontabël të autorizuar për miratimin e bilancit të vitit 2019
2	26 shkurt 2020	Vendim, propozimin për emërtimin e ekspertëve kontabël të autorizuar për miratimin e bilancit të vitit 2019, A. Q. dhe T. F.
385	12 mars 2020	Kërkesë, autorizimi për përdorimin e fondit rezervë për blerje emergjente (dezinfektim i ambienteve dhe automjeteve të Sha UKE në kuadër të masave parandaluese të virusit Covid -19
4	12 mars 2020	Vendim, miratimin për përdorimin e fondit rezervë për blerje emergjente (dezinfektim i ambienteve dhe automjeteve të Sha UKE në kuadër të masave parandaluese të virusit Covid -19
495	15 prill 2020	Kërkesë, autorizimi për heqjen e kamatë vonesave të faturave të ujit të pijshëm për muajin mars-prill 2020.
6	21 prill 2020	Vendim, miratim për heqjen e kamatë vonesave të faturës së ujit të pijshëm për muajin mars-prill 2020.
557	08 maj 2020	Kërkesë për përdorimin e fondit rezervë në vlerën 2.154.800,18 lek pa tvsh për riparimin e sipërfaqeve të asfalteve të dëmtuara gjatë riparimit.
558	08 maj 2020	Kërkesë për riparimin e sipërfaqeve të asfalteve të dëmtuara gjatë riparimit të defekteve në linjat e ujit dhe ujërat e zeza.
568	11 maj 2020	Kërkesë për autorizimin e përdorimit të fondit rezervë për riparimin e asfaltit të dëmtuar në rrugët e qytetit për vlerën 2.154.800,18 lek pa tvsh. Propozim për shtime pozicioni në strukturën organizative të shoqërisë.
7	14 maj 2020	Vendim, miratimin e përdorimit të fondit rezervë për riparimin e asfaltit të dëmtuar në rrugët e qytetit për vlerën 2.154.800,18 lek pa tvsh. Miratim i shtimit të pozicioneve të Zv/Administratorit dhe ndihmës laborante ne strukturën organizative të shoqërisë.
759	18 qershor 2020	Kërkesë, për konfirmim dhe miratim të tarifave të furnizimit me ujë dhe kanalizimeve për vitin 2021.
11	23 qershor 2020	Vendim, konfirmim dhe miratim i tarifave të furnizimit me ujë dhe kanalizimeve për vitin 2021.
1001	03 korrik 2020	Kërkesë për autorizimin për transferimin e fondeve për miratimin e marrjes në administrim të rrjetit ujësjellës të fshatit Tudan.
12	07 korrik 2020	Vendim, për marrjen në administrim të rrjetit ujësjellës të fshatit Tudan.
2287	28 shtator 2020	Kërkesë, për autorizimin për transferimin e fondeve për (blerje tubash HDPE corrogato për sektorin KUZ shuma 2.163.500 lek pa tvsh
12	29 shtator 2020	Vendim, për miratimin e transferimit të fondit të parashikuar në programin ekonomik 2020 për blerjen e tubave tubash HDPE corrogato për sektorin KUZ shuma 2.163.500 lek pa tvsh
2531	01 dhjetor 2020	Kërkesë, për mbylljen kontratave për : Objektet e prishura nga INUK Objekte që faturohen pa marrë shërbim

		Klientë që nuk gjenden në zonën e shërbimit
2531/1	09 dhjetor 2020	Vendim, miratim për mbylljen kontratave për : Objektet e prishura nga INUK Objekte që faturohen pa marrë shërbim Klientë që nuk gjenden në zonën e shërbimit
2722	24 dhjetor 2020	Kërkesë, miratimi i programit ekonomik për vitin 2021 Miratimin e strukturës organizative dhe nivelin e pagave për punonjësit UKE sha
2722/1	28 dhjetor 2020	Vendim, miratim i programit ekonomik për vitin 2021 Miratimin e strukturës organizative dhe nivelin e pagave të punonjësve UKE sha.

PËR VITIN 2021

Nr.prot	Data	Lënda
91	01 shkurt 2021	Kërkesë, lirim nga detyra e Administratorit të UKE sha, z. L. D. Emërimin e Administratorit të ri.
91/1	01 shkurt 2021	Vendim, Lirimi nga detyra i Administratorit të UKE z. L. D. Emërimi i Administratorit të ri z. L. K.
299	09 mars 2021	Kërkesë, miratimin e marrjes në dorëzim dhe përdorimin nga ASHP Elbasan të materialeve, të magazinuara në UKE sha, të nevojshme për shtrimin e linjës KUZ.
300	12 mars 2021	Vendim, miratimin e marrjes në dorëzim dhe përdorimin nga ASHP Elbasan të materialeve, të magazinuara në UKE sha, të nevojshme për shtrimin e linjës KUZ.
671	05 prill 2021	Kërkesë, miratimin e ndryshimit në strukturën organizative të UKE sha: Miratimin e ndryshimit në nivelin e pagave të UKE sha. Miratimin e ndryshimit në programin ekonomik të UKE sha.
687	12 prill 2021	Vendim, miratimin e ndryshimit në strukturën organizative të UKE sha. Miratimin e ndryshimit në nivelin e pagave të UKE sha. Miratimin e ndryshimit në programin ekonomik të UKE sha.
1326	01 qershor 2021	Kërkesë për miratimin e emërimit të Drejtorit të Auditit të Brendshëm për UKE sha.
1362	07 qershor 2021	Vendim, Emërimi në detyrë si Drejtor Auditit të Brendshëm Zj, E. B.
1575	18 qershor 2021	Kërkesë, rishikimin e buxhetit dhe strukturës organizative të UKE sha.
1616	21 qershor 2021	Kërkesë, miratimin e disa ndryshimeve emergjente në strukturën organizative të UKE sha.
1657	25 qershor 2021	Vendim, miratimin e disa ndryshimeve emergjente në strukturën organizative të UKE sha.
2801	17 shtator 2021	Kërkesë, miratimin e përdorimit të fondit nga GIZ për ò Rikonstrukcion i ambienteve të tualeteve të shkollave Jeronim De Rada dhe Vasil Kamami.
2913	24 shtator 2021	Vendim, miratimin e përdorimit të fondit nga GIZ për ò Rikonstrukcion i ambienteve të tualeteve të shkollave Jeronim De Rada dhe Vasil Kamami.
3056	11 tetor 2021	Kërkesë, miratimin e planit vjetor strategjik 2022-2024 i drejtorisë së Auditit të Brendshëm
3153	15 tetor 2021	Vendim, miratimin e planit vjetor strategjik 2022-2024 i drejtorisë së Auditit të Brendshëm
4031	17 dhjetor 2021	Kërkesë, miratimin e programit ekonomik 2022, strukturës

		organizative, nivelin e pagave të punonjësve të UKE sha për vitin 2022.
4083	24 dhjetor 2021	Vendim, miratimi i programit ekonomik të vitit 2022 të UKE sha
4084	24 dhjetor 2021	Vendim, miratimin e strukturës organizative dhe nivelin e pagave të punonjësve të UKE sha për vitin 2022.

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion u konstatua se organizimi, funksionimi i Këshillit Administrativ, si dhe përputhshmëria ligjore e vendimeve të marra prej tij, përgjithësisht është bërë në zbatim të Ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008 òPër tregtarët dhe shoqëritë tregtareò, me ndryshimet vijuese të tij, VKM nr.63, datë 27.01.2016 òPër riorganizimin e operatorëve që ofrojnë shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm, grumbullimin, largimin dhe trajtimin e ujërave të ndoturaösi dhe statutit të UKE sha.

Pavarësisht nga sa u deklarua më sipër, u konstatuan shkelje të dispozitave dhe ligjore dhe mangësi të cilat mënyrë të detajuar paraqiten si më poshtë vijon:

Këshilli i Administrimit nuk është mbledhur përherë çdo muaj të vitit kalendarik. Konkretisht për vitin 2019 nuk është mbledhur në muajt Janar, Prill, Maj, Qershor, Korrik, Nëntor, Dhjetor. Për vitin 2020 nuk është mbledhur në muajt Janar, Gusht, Nëntor dhe për vitin 2021 nuk është mbledhur në muajin Janar.

Veprim në kundërshtim me nenin 14 pika 1 e Statutit, të miratuar me vendim të Asamblesë së Përgjithshme nr. 516, datë 31.03.2016, ku është shprehur në mënyrë eksplicite òKëshilli i Administrimit mbledhet jo më pak se një herë në muaj, dhe sa herë e kërkon interesi i shoqërisë aksionare, me thirrjen e kryetaritò, si dhe VKM nr. 63 i datës 20.01.2016 òPër riorganizimin e operatorëve që ofrojnë shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm, grumbullimin, largimin dhe trajtimin e ujërave të ndoturaö .

Në opinionin e grupit të auditimit, Këshilli i Administrimit duhet të mbledhet jo më pak se një herë në muaj, me qëllim analizimin e vijueshëm të performancës së shoqërisë dhe marrjen e vendimeve koherente në bazë të problematikave që rezultojnë nga aktiviteti i përditshëm i shoqërisë, në zbatim të statutit të shoqërisë.

Në 5 raste Këshilli i Administrimit është mbledhur më vonë nga afati i përcaktuar në njoftimin për mbledhje, përkatësisht në rastet si më poshtë:

Njoftimi Nr. 176 prot., datë 07.02.2020 ó vendimi Nr. 1 prot., datë 13.02.2020.

Njoftimi Nr. 2531 prot., datë 01.12.2020 ó vendimi Nr. 2531/1 prot., datë 09.12.2020.

Njoftimi Nr. 671 prot., datë 05.04.2021 ó vendimi Nr. 687 prot., datë 12.04.2021.

Njoftimi Nr. 1326 prot., datë 01.06.2021 - vendimi Nr. 1362 prot., datë 07.06.2021.

Njoftimi Nr. 2801 prot., datë 17.09.2021 - vendimi Nr. 2913 prot., datë 24.09.2021.

Veprim në kundërshtim me nenin 14 pika 4 e Statutit, VKM nr. 63 i datës 20.01.2016 òPër riorganizimin e operatorëve që ofrojnë shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm, grumbullimin, largimin dhe trajtimin e ujërave të ndoturaö ku është shprehur në mënyrë eksplicite òNjoftimi për thirrjen e mbledhjes bëhet me shkrim jo më vonë se 3 (tre) ditë përpara mbledhjes dhe dërgohet me postë ose në rrugë elektronikeò.

Mos lidhja e kontratës së anëtarëve sjell dhe mungesën e kriterëve dhe objektivave për matjen e performancës vjetore të punës së tyre ku si pasojë kemi drejtim jo eficient nga anëtarët e Këshillit të Administrimit.

VENDIMET E ASAMBLESE SË PËRGJITHSHME

Asambleja e Përgjithshme e UKE Sha, është organi kryesor i shoqërisë, përfaqësuar nga Kryetari i Bashkisë Elbasan.

Për periudhën objekt auditimi janë marrë 28 vendime nga ku në vitin 2019 (12 vendime), në vitin 2020 (9 vendime), në vitin 2021 (7 vendime).

PËR VITIN 2019

Nr. Prot.	Data	Lënda
122	07 janar 2019	Vendim, miratimi i strukturës administrative dhe nivelin e pagave të punonjësve të UKE sha për vitin 2019.
123	07 janar 2019	Vendim, miratimi i programit ekonomik të UKE sha për vitin 2019.
916	31 janar 2019	Vendim, autorizimin e administratorit të UKE sha. Për aplikimin për të nisur procedurat e licensimit të shoqërisë.
1595	18 shkurt 2019	Vendim, miratimin e disa ndryshimeve ne strukturën organizative të UKE sha. Krijimi i degës së auditit të brendshëm.
1964	01 mars 2019	Vendim, pezullimin e efekteve të vendimit Nr.1073 datë 24.12.2018 deri ne miratimin e unifikimit të çmimeve nga ERRU.
2016	05 mars 2019	Vendim, miratimin e disa ndryshimeve në strukturën organizative dhe nivelin e pagave të punonjësve të UKE sha.
2432	21 mars 2019	Vendim, miratimin e përdorimit të fondit rezervë të UKE sha. për: Blerje urgjente të elektromotorit 90 kë dhe panelit të montimit për stacionin e pompimit Mengel me vlerë 1.800.000 lek
2606	01 prill 2019	Vendim, emërimin e ekspertëve kontabël të autorizuar të UKE sha për miratimin e bilancit të vitit 2018. z. A. Q. znj. N. Ç.
943	01 prill 2019	Vendim, emërimin në detyrë të anëtarëve të Këshillit të Administrimit të UKE sha. z. Q. T. z. S. P. z. L. D.
1739	24 korrik 2019	Vendim, miratimin e pasqyrave financiare të vitit 2018.
8635	21 gusht 2019	Vendim, transferimin e fondeve nga të ardhurat përkatësisht: Shërbime avalzhimi i motorëve të pompave me voltazh të ndryshëm në shumën 1.318.000 lek pa tvsh.
8772	29 gusht 2019	Vendim, Lirimin nga detyra të anëtarit të Këshillit të Administrimit të UKE sha z. S. P. Emërimin e z. A. Q.

PËR VITIN 2020

Nr. Prot	Data	Lënda
3	02 mars 2020	Vendim, emërimin e ekspertëve kontabël të UKE sha për pasqyrat financiare 2019 z. A. Q. znj. T. F.
5	17 mars 2020	Vendim, miratimin e përdorimit të fondit rezervë me vlerën 586.000 lekësh për òDezinfektimin e ambienteve dhe automjeteve të UKE sha. në kuadër të masave parandaluese të virusit COVID-19
8	21 maj 2020	Vendim, miratimin e shtimit të pozicioneve të zv./Administratorit dhe ndihmës laborante ne strukturën organizative të UKE sha.

9	21 maj 2020	Vendim, përdorimi i fondit rezervë prej 2.154.800,18 lek pa tvsh për: òRiparim asfalti të dëmtuar në rrugët e qytetit për punime të UKE shaò
10	17 qershor 2020	Vendim, miratimin e pasqyrave financiare të vitit 2019.
13	16 korrik 2020	Vendim, miratimin e marrjes në administrim të rrjetit ujësjiellës të fshatit Tudan.
15	01 tetor 2020	Vendim, transferimin e fondeve nga të ardhurat në shumën 2.163.500 lek pa tvsh.
16	14 tetor 2020	Vendim, lirohet nga detyra anëtari i Këshillit të Administrimit të UKE sha z. Q. Tusha. Emërohet z. S. N.
2727/1	30 dhjetor 2020	Vendim, miratimi i planit ekonomik për 2021 të UKE sha dhe strukturën organizative sipas nivelit të pagave të punonjësve.

PËR VITIN 2021

Nr.Prot	Data	Lënda
90/1	01 shkurt 2021	Vendim, zëvendësimin në detyrë të anëtarëve të Këshillit të Administrimit. z. L. D. zëvendësohet me z. L. K. z. S. N. zëvendësohet me znj. A. B.
93/1	02 shkurt 2021	Vendim, miratimin e lirimit dhe emërimit të Administratorit të UKE sha. Lirohet nga detyra z. L. D. Emërohet z. L. K.
1781/1	20 prill 2021	Vendim, miratimin e strukturës organizative dhe nivelin e pagave të punonjësve të UKE sha për vitin 2021.
1781/2	20 prill 2021	Vendim, miratimin e ndryshimit në programin ekonomik për vitin 2021.
1207	21 maj 2021	Vendim, miratimin e strukturës organizative dhe nivelit të pagave të punonjësve të UKE sha, për periudhën deri në fund të vitit 2021.
6424/1	31 dhjetor 2021	Vendim, miratimin e strukturës organizative dhe nivelin e pagave të punonjësve të UKE sha për vitin 2022.
6437	31 dhjetor 2021	Vendim, miratimin e ndryshimit në programin ekonomik për vitin 2022.

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion u konstatua se organizimi, funksionimi i Asamblesë së Përgjithshme, si dhe përputhshmëria ligjore e vendimeve të marra prej saj, përgjithësisht është bërë në zbatim të Ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008 òPër tregtarët dhe shoqëritë tregtareò, me ndryshimet vijuese të tij, VKM nr.63, datë 27.01.2016 òPër riorganizimin e operatorëve që ofrojnë shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm, grumbullimin, largimin dhe trajtimin e ujërave të ndoturaòsi dhe statutit të UKE sha.

Pavarësisht nga sa u deklarua më sipër, u konstatuan shkelje të dispozitave dhe ligjore dhe mangësi të cilat në mënyrë të detajuar paraqiten si më poshtë vijon:

Nuk janë publikuar në faqen e internetit të UKE sha. dokumentacioni i detyrueshëm për t'u publikuar lidhur me procesverbalet e mbledhjeve të Asamblesë së Përgjithshme të cilat duhet të ishin të publikuara në faqen zyrtare të internetit të UKE sha, jo më vonë se 15 ditë nga data e mbledhjes për të cilën janë mbajtur.

Veprim në kundërshtim me Ligjin nr. 119/2014 òPër të drejtën e informimitò si dhe me Ligjin nr. 9901, datë 14.04.2008 òPër tregtarët dhe shoqëritë tregtareò, i ndryshuar, neni 90, pika 5,

ku është shprehur në mënyrë eksplicite se *“N.q.s shoqëria ka të publikuar një faqe në internet. Administratorët, jo më vonë se 15 ditë nga data e mbledhjes janë të detyruar të publikojnë kopje të procesverbalit të mbledhjes së Asamblesë së Përgjithshme në këtë faqe”*

Mungesa e publikimit të këtyre vendimeve në faqen zyrtare të UKE sha, sjell mungesë transparence dhe mos informim ndaj konsumatorit si dhe publikut.

Për periudhën objekt auditimi, me Administratorin e Shoqërisë nuk është lidhur kontratë, pavarësisht se emërohet për një periudhë kohe prej tre vitesh, dhe qëndrimi i tij në detyrë gjatë periudhës tre vjeçare bëhet në bazë kontratash të rinovueshme vjetore mes tij dhe Asamblesë së Përgjithshme, bazuar në vlerësimet pozitive të performancës së punës së tij.

Veprim në kundërshtim me nenin 18, pika 5 e VKM nr. 63, datë 27.01.2016 *“Për riorganizimin e operatorëve që ofrojnë shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm, grumbullimin, largimin dhe trajtimin e ujërave të ndotura, si dhe pika 5 e nenit 18 të Statutit ku shprehet në mënyrë eksplicite që *“Administratori emërohet për një periudhë kohe prej 3 (tre) vjetësh, por në bazë kontratash të rinovueshme vjetore. Rinovimi i kontratave midis Asamblesë dhe administratorit do të jetë vjetor në bazë vlerësimesh pozitive të performancës së punës. Numri i mandateve është i pakufizuar”**

Mungesa e lidhjes së kontratës vjetore ndërmjet Administratorit dhe Shoqërisë, sjell mungesën e kritereve dhe objektivave për matjen e performancës vjetore të punës së tij.

1.Titulli i gjetjes:	Anëtarët e Këshillit të Administrimit të Shoqërisë <i>“Ujës</i> jellës Kanalizimeo Sh.A, Elbasan, nuk kanë lidhur kontratë me shoqërinë.
Situata:	Anëtarët e Këshillit të Administrimit të Shoqërisë nuk kanë lidhur kontratë me shoqërinë, kontratë e cila duhej të lidhej që në momentin e emërimit të tyre, ku të jetë parashikuar, ndër të tjera, kritere të qarta performance që pritej të arrihen në terma vjetorë. Objektivat për performancën (indikatorët) e vendosur në kontratë, duhet të miratohen edhe nga ministria e linjës dhe duhet të ishin të matshme në përputhje me biznes planet e shoqërisë.
Kriteri:	Neni 12 pika 3 e Statutit, të miratuar me vendim të Asamblesë së Përgjithshme nr. 516, datë 31.03.2016, VKM nr. 63 i datës 20.01.2016 <i>“Për riorganizimin e operatorëve që ofrojnë shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm, grumbullimin, largimin dhe trajtimin e ujërave të ndotura”</i>
Ndikimi:	Mos lidhja e kontratës së anëtarëve sjell dhe mungesën e kritereve dhe objektivave për matjen e performancës vjetore të punës së tyre ku si pasojë kemi drejtim jo eficient nga anëtarët e Këshillit të Administrimit.
Rëndësia:	E lartë
Rekomandimi:	Nga kryetari i Bashkisë Elbasan në cilësinë e përfaqësuesit të Asamblesë së Përgjithshme të lidhen kontratat me anëtarët e Këshillit të Administrimit, në të cilat të parashikohen kritere të qarta performance/objektiva që priten të arrihen në terma vjetorë. Objektivat për performancën (indikatorët) e vendosur në kontratë duhet të miratohen edhe nga ministria e linjës dhe duhet jenë të matshme në përputhje me biznes planet e Shoqërisë.

2.Titulli i gjetjes:	Administratori i Shoqërisë <i>“Ujës</i> jellës Kanalizimeo Sh.A, Elbasan, nuk ka lidhur kontratë me shoqërinë.
Situata:	Për periudhën objekt auditimi, me Administratorin e Shoqërisë nuk është lidhur kontratë, pavarësisht se emërohet për një periudhë kohe prej tre vitesh, dhe qëndrimi i tij në detyrë gjatë periudhës tre vjeçare bëhet në bazë

	kontratash të rinovueshme vjetore mes tij dhe Asamblesë së Përgjithshme, bazuar në vlerësimet pozitive të performancës së punës së tij.
Kriteri:	Neni 18, pika 5 e VKM nr. 63, datë 27.01.2016 ÷Për riorganizimin e operatorëve që ofrojnë shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm, grumbullimin, largimin dhe trajtimin e ujërave të ndotura, si dhe pika 5 e nenit 18 të Statutit të UK Elbasan SHA
Ndikimi:	Mungesa e lidhjes së kontratës vjetore ndërmjet Administratorit dhe subjektit Ujës-jellës kanalizime Elbasan, sjell dhe mungesën e kritereve dhe objektivave për matjen e performancës vjetore të punës së tij ku si pasojë kemi drejtim jo eficient të shoqërisë.
Rëndësia:	E lartë
Rekomandimi:	Në zbatim të Vendimit të Asamblesë së Përgjithshme nr. 11, datë 02.02.2021 , të lidhet kontratë me Administratorin, në të cilën të parashikohen kritere të qarta performance/objektiva që priten të arrihen në terma vjetorë, si dhe të bëhen vlerësime vjetore të performancës së punës së Administratorit, bazuar në objektivat/kriteret e performancës të parashikuar në kontratë

3.Titulli i gjetjes:	i Nuk janë publikuar në faqen e internetit të Shoqërisë ÷Ujës-jellës Kanalizime Sh.A, Elbasan dokumentacioni i detyrueshëm për t'u publikuar.
Situata:	Nuk është publikuar në faqen e internetit të Shoqërisë, dokumentacioni i detyrueshëm për t'u publikuar, lidhur me procesverbalet e mbledhjeve të Asamblesë së Përgjithshme të cilat duhet të jenë të publikuara në faqen zyrtare të internetit jo më vonë se 15 ditë nga data e mbledhjes për të cilën janë mbajtur.
Kriteri:	Ligji nr. 119/2014 ÷Për të drejtën e informimit, Ligji nr. 9901, datë 14.04.2008 ÷Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare, i ndryshuar, neni 90, pika 5.
Ndikimi:	Mungesa e publikimit të këtyre vendimeve në faqen zyrtare të UKE sha, sjell një mungesë transparence dhe mos informim ndaj konsumatorit si dhe publikut.
Rëndësia:	E mesme
Rekomandimi:	Nga Asambleja së Përgjithshme dhe Administratori i Shoqërisë të merren masa për publikimin në faqen zyrtare të internetit të shoqërisë të dhënat/dokumentet e detyrueshme për tu publikuar.

4.Titulli i gjetjes:	i Për periudhën objekt auditimi u konstatua se Këshilli i Administrimit nuk është mbledhur aq shpesh sa e ka detyrim ligjor.
Situata:	Këshilli i Administrimit nuk është mbledhur përherë çdo muaj të vitit kalendarik. Konkretisht për vitin 2019 nuk është mbledhur në muajt Janar, Prill, Maj, Qershor, Korrik, Nëntor, Dhjetor. Për vitin 2020 nuk është mbledhur në muajt Janar, Gusht, Nëntor dhe për vitin 2021 nuk është mbledhur në muajin Janar.
Kriteri:	Neni 14 pika 1 e Statutit, VKM nr. 63 i datës 20.01.2016 ÷Për riorganizimin e operatorëve që ofrojnë shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm,

	grumbullimin, largimin dhe trajtimin e ujërave të ndotura
Ndikimi:	Mos koherencë në analizën e performancës së shoqërisë dhe marrjen e vendimeve për problematikat që rezultojnë nga aktiviteti i përditshëm i shoqërisë.
Rëndësia:	E lartë
Rekomandimi:	Nga organet drejtuese, të merren masa për thirrjen e mbledhjeve të Këshillit të Administrimit jo më pak se një herë në muaj, me qëllim analizimin e vijueshëm të performancës së shoqërisë dhe marrjen e vendimeve koherente në bazë të problematikave që rezultojnë nga aktiviteti i përditshëm i shoqërisë.

5. Titulli i gjetjes:	Për periudhën objekt auditimi në 5 raste Këshilli i Administrimit është mbledhur më vonë nga afati pasi vjen njoftimi në formë të shkruar.
Situata:	Në 5 raste Këshilli i Administrimit është mbledhur më vonë nga afati i përcaktuar në njoftimi për mbledhje, përkatësisht në rastet si më poshtë: Njoftimi nr. 176 prot., datë 07.02.2020 ó vendimi nr. 1 prot., datë 13.02.2020. Njoftimi nr. 2531 prot., datë 01.12.2020 ó vendimi nr. 2531/1 prot., datë 09.12.2020. Njoftimi nr. 671 prot., datë 05.04.2021 ó vendimi nr. 687 prot., datë 12.04.2021. Njoftimi nr. 1326 prot., datë 01.06.2021 - vendimi nr. 1362 prot., datë 07.06.2021. Njoftimi nr. 2801 prot., datë 17.09.2021 - vendimi nr. 2913 prot., datë 24.09.2021.
Kriteri:	Veprim në kundërshtim me nenin 14 pika 4 e Statutit të Ujësjetës Kanalizime Elbasan SHA, VKM nr. 63 i datës 20.01.2016 óPër riorganizimin e operatorëve që ofrojnë shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm, grumbullimin, largimin dhe trajtimin e ujërave të ndotura
Ndikimi:	Vonesa në vendimmarrje
Rëndësia:	E ulët
Rekomandimi:	Këshilli i Administrimit të sigurojë marrjen e veprimeve korrigjuese në mënyrë që mbledhjet e tij të bëhen duke respektuar njoftimet e bëra.

2.3. Mbi hartimin, miratimin dhe realizimin e programit ekonomik-financiar të shoqërisë.

Në hartimin dhe zbatimin e programit ekonomik, përgjithësisht janë zbatuar kërkesat e Udhëzimit të Ministrisë së Ekonomisë nr. 15, datë 02.05.2018 óMbi programet e zhvillimit ekonomik të shoqërive tregtare me kapital shtetëror dhe Ligjit nr. 9901 datë 14.04.2008, óPër Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare, me ndryshimet vijuese të tij dhe statuti i shoqërisë.

Projekt programet ekonomike janë përgatitur nga Drejtoria Tregtare duke u bazuar në kërkesat e çdo drejtorie, si dhe janë dërguar për miratim Këshillit të Administrimit dhe Asamblesë së Përgjithshme.

Konkretisht:

- Për vitin 2019 programi ekonomik është miratuar me Vendim nr. 22, datë 31.12.2018 të Këshillit të Administrimit dhe protokolluar në UKE me nr. 4336 prot., datë 31.12.2018, ndërsa miratimi përfundimtar i programit ekonomik është realizuar me Vendim nr. 8, datë 07.01.2019 të

Asamblesë së Përgjithshme të Shoqërisë (Aksionari i vetëm: Bashkia Elbasan) dhe protokolluar në UKE me nr. 123 prot., datë 10.01.2019.

- Për vitin 2020 programi ekonomik është miratuar me Vendim nr.177, datë 30.12.2019 të Këshillit të Administrimit dhe protokolluar në UKE me nr. 2995 prot., datë 30.12.2019, ndërsa miratimi përfundimtar i programit ekonomik është realizuar me Vendim nr. 178, datë 30.12.2019 të Asamblesë së Përgjithshme të Shoqërisë (Aksionari i vetëm: Bashkia Elbasan) dhe është protokolluar në UKE me nr. 2996 prot., datë 30.12.2019.

- Për vitin 2021 programi ekonomik është miratuar me Vendim nr.182, datë 28.12.2020 të Këshillit të Administrimit dhe protokolluar në UKE me nr. 2722/1 prot., datë 28.12.2020, ndërsa miratimi përfundimtar i programit ekonomik është realizuar me Vendim nr. 183, datë 30.12.2020 të Asamblesë së Përgjithshme të Shoqërisë (Aksionari i vetëm: Bashkia Elbasan) dhe është protokolluar në UKE me nr. 2727/1 prot., datë 30.12.2020.

Pra:

- Për vitin 2019 nuk janë respektuar afatet kohore për dërgimin e projekt programit ekonomik pranë Këshillit të Administrimit, veprim në kundërshtim me Udhëzimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 15, datë 02.05.2018 *Mbi programet e zhvillimit ekonomik të shoqërive tregtare me kapital shtetërorë, kapitulli III, pika 2, ku është shprehur në mënyrë eksplicite se, *“Drejtoritë e shoqërive, ku shteti ka mbi 50% të aksioneve, hartojnë projekt programet dhe dërgojnë kopje të tyre, me relacionet shpjeguese pranë Këshillit Mbikëqyrës, brenda datës 1 nëntor të çdo viti.**

- Për vitin 2020 nuk janë respektuar afatet kohore për dërgimin e projekt programit ekonomik pranë Këshillit të Administrimit, veprim në kundërshtim me Udhëzimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 15, datë 02.05.2018 *Mbi programet e zhvillimit ekonomik të shoqërive tregtare me kapital shtetërorë, kapitulli III, pika 2.*

- Për vitin 2021 nuk janë respektuar afatet kohore për dërgimin e projekt programit ekonomik pranë Këshillit të Administrimit, veprim në kundërshtim me Udhëzimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 15, datë 02.05.2018 *Mbi programet e zhvillimit ekonomik të shoqërive tregtare me kapital shtetërorë, kapitulli III, pika 2.*

- Për vitin 2019, të ardhurat janë planifikuar në shumën 498,918,087 lekë dhe realizuar në shumën 357,368,486 ose në masën 72%.

Shpenzime janë planifikuar në shumën 445,414,087 lekë dhe realizuar në shumën 375,542,486 lekë ose në masën 84%.

- Për vitin 2020, të ardhurat janë planifikuar në shumën 396,736,299 lekë dhe realizuar në shumën 340,145,524 lekë ose në masën 86%.

Shpenzimet janë planifikuar në shumën 439,485,826 lekë dhe realizuar në shumën 385,924,232 lekë ose në masën 88%.

- Për vitin 2021, të ardhurat janë planifikuar në shumën 423,416,440 lekë dhe realizuar në shumën 384,633,550 lekë ose në masën 91%.

Shpenzimet janë planifikuar në shumën 431,916,440 lekë dhe realizuar në shumën 469,435,236 lekë ose në masën 109%.

Programet ekonomiko-financiar (buxhetet vjetor) janë hartuar në pamjaftueshmëri financiare, pasi aktiviteti i shoqërisë nuk është i mbuluar me buxhet, konkretisht është me humbje për çdo vit, respektivisht:

- Për vitin 2019, Shoqëria ka pasur humbje në shumën 124,558,064 lekë.

- Për vitin 2020, Shoqëria ka pasur humbje në shumën 123,143,715 lekë.

- Për vitin 2021, Shoqëria ka pasur humbje në shumën 128,972.992 lekë.

-Analiza e treguesve për programet ekonomike për periudhën objekt auditimi, në mënyrë të përmbledhur trajtuar si më poshtë:

Programet ekonomike të miratuara nga Asambleja e Përgjithshme për periudhën objekt auditimi, viti 2019-2021.

Në lekë

Nr.	Emërtimi	Njësia e matjes	Programi	Programi	Programi
			2019	2020	2021
1	Të ardhura gjithsej	000/lekë	498,918,087	396,736,299	423,416,440
2	Shpenzime gjithsej	000/lekë	445,414,087	439,485,826	431,916,440
3	Investime gjithsej	000/lekë	51,004,000	73,624,000	30,500,000

Burimi i të dhënave: UK Elbasan

Për vitin 2019, shpenzimet e shoqërisë në mënyrë të detajuar paraqiten si më poshtë vijon .

Në lekë

Nr	Emëtimi	Njësia e matjes	Planifikimi	Realizimi	Diferenca
1	Paga vjetore bazë	Lekë	135,489,000	126,506,000	-8,983,000
2	Mbikoha	Lekë	0	3,674,896	3,674,896
3	Pagesë shtesë personeli- fund viti	Lekë	282,000	0	-282,000
4	Trajtim personeli (ushqim)	Lekë	25,860,600	24,379,017	-1,481,583
5	Bonuse Performance	Lekë	0	0	0
6	Shpërblim për Këshillin Mbikëqyrës	Lekë	1,109,424	1,155,600	46,176
7	Sigurime shoqërore dhe shëndetësore	Lekë	26,688,270	25,563,373	-1,124,897
8	Trajnime	Lekë	282,000	0	-282,000
9	Mirëmbajtje dhe material	Lekë	12,369,800	8,187,938	-4,181,862
10	Kimikate	Lekë	2,000,000	3,203,138	1,203,138
11	Energji-Ujësjiellës	Lekë	125,900,000	135,760,363	9,860,363
12	Energji-Ujësjiellës shlyerje detyrime të prapambetura	Lekë	64,000,000	0	-64,000,000
13	Shërbim Sigurie (Roje)	Lekë	23,000,000	19,514,570	-3,485,430
14	Shërbime të tjera të Kontraktuara	Lekë	4,906,700	1,350,000	-3,556,700
15	Transport (Karburant, polica sigurimi)	Lekë	12,680,050	6,225,305	-6,454,745
16	Blerje uji	Lekë	918,908	919,290	382
17	Shpenzime administrative (bojëra, letër, kancelari)	Lekë	0	4,016,445	4,016,445
18	Gjoha dhe dëmshpërblime	Lekë	3,748,339	5,630,880	1,882,541
19	Shpenzime qiraje	Lekë	1,173,996	1,173,996	0
20	Shpenzime postare dhe telekomunikacioni	Lekë	637,200	1,603,970	966,770
21	Marrëdhënie me publikun	Lekë	0	37,100	37,100
22	Taksa (Licenca, leje etj)	Lekë	135,000	5,849,747	5,714,747
23	Shpenzime të tjera	Lekë	972,800	790,858	-181,942
24	Fondi reserve	Lekë	3,260,000	0	-3,260,000
Totali		Lekë	445,414,087	375,542,486	-69,871,601

Burimi i të dhënave: UK Elbasan

Për vitin 2020, shpenzimet e shoqërisë në mënyrë të detajuar paraqiten si më poshtë vijon .

Në lekë

Nr	Emëtimi	Njësia e	Planifikimi	Realizimi	Diferenca
----	---------	----------	-------------	-----------	-----------

		matjes			
1	Paga vjetore bazë	Lekë	132,378,000	135,187,248	2,809,248
2	Mbikoha	Lekë	3,680,000	0	-3,680,000
3	Pagesë shtesë personeli- fund viti	Lekë	595,000	603,000	8,000
4	Trajtim personeli (ushqim)	Lekë	27,978,600	25,848,240	-2,130,360
5	Bonuse Performance	Lekë	0	0	0
6	Shpërblim për Këshillin Mbikëqyrës	Lekë	1,362,528	918,418	-444,110
7	Sigurime shoqërore dhe shëndetësore	Lekë	27,394,112	26,269,254	-1,124,858
8	Trajnime	Lekë	200,000	0	-200,000
9	Mirëmbajtje dhe materiale	Lekë	47,564,925	31,902,818	-15,662,107
10	Kimikate	Lekë	5,808,000	4,625,498	-1,182,502
11	Energji-Ujësjiellës	Lekë	134,867,120	119,796,256	-15,070,864
12	Energji-Ujësjiellës shlyerje detyrime të prapambetura	Lekë	0	0	0
13	Shërbim Sigurie (Roje)	Lekë	27,523,766	19,890,773	-7,632,993
14	Shërbime të tjera të Kontraktuara	Lekë	1,350,000	1,436,000	86,000
15	Transport (Karburant, polica sigurimi)	Lekë	12,581,975	8,483,057	-4,098,918
16	Blerje uji	Lekë	930,000	850,440	-79,560
17	Shpenzime administrative (bojëra, letër, kancelari)	Lekë	3,530,000	2,115,265	-1,414,735
18	Gjoha dhe dëmshpërblime	Lekë	2,619,000	589,413	-2,029,587
19	Shpenzime qiraje	Lekë	1,173,996	339,999	-833,997
20	Shpenzime postare dhe telekomunikacioni	Lekë	1,404,000	1,493,196	89,196
21	Marrëdhënie me publikun	Lekë	30,000	12,500	-17,500
22	Taksa (Licenca, leje etj)	Lekë	100,000	5,444,609	5,344,609
23	Shpenzime të tjera	Lekë	1,414,804	118,248	-1,296,556
24	Fondi rezervë	Lekë	5,000,000	0	-5,000,000
Totali		Lekë	439,485,826	385,924,232	-53,561,594

Burimi i të dhënave: UK Elbasan

Për vitin 2021, shpenzimet e shoqërisë në mënyrë të detajuar paraqiten si më poshtë vijon.

Në lekë

Nr	Emëtimi	Njësia e matjes	Planifikimi	Realizimi	Diferenca
1	Paga vjetore bazë	Lekë	144,861,000	155,308,057	10,447,057
2	Mbikoha	Lekë	3,628,000	4,492,773	864,773
3	Pagesë shtesë personeli- fund viti	Lekë	372,000	0	-372,000
4	Trajtim personeli (ushqim)	Lekë	29,302,800	26,424,732	-2,878,068
5	Bonuse Performance	Lekë	0	0	0
6	Shpërblim për Këshillin Mbikëqyrës	Lekë	1,148,352	2,146,532	998,180
7	Sigurime shoqërore dhe shëndetësore	Lekë	29,691,231	30,697,082	1,005,851
8	Trajnime	Lekë	10,000	0	-10,000
9	Mirëmbajtje dhe materiale	Lekë	37,925,086	39,761,994	1,836,908
10	Kimikate	Lekë	5,117,500	5,117,500	0
11	Energji-Ujësjiellës	Lekë	120,000,000	114,320,558	-5,679,442
12	Energji-Ujësjiellës shlyerje detyrime të prapambetura	Lekë	0	21,172,261	21,172,261
13	Shërbim Sigurie (Roje)	Lekë	27,613,860	31,423,884	3,810,024
14	Shërbime të tjera të Kontraktuara	Lekë	1,436,000	19,907,500	18,471,500
15	Transport (Karburant, polica sigurimi)	Lekë	11,966,000	5,798,980	-6,167,020
16	Blerje uji	Lekë	850,440	860,550	10,110
17	Shpenzime administrative (bojëra, letër,	Lekë	3,630,000	940,238	-2,689,762

	kancelari)				
18	Gjoha dhe dëshmipërblime	Lekë	1,700,000	15,000	-1,685,000
19	Shpenzime qiraje	Lekë	400,000	299,997	-100,003
20	Shpenzime postare dhe telekomunikacioni	Lekë	1,736,000	1,608,486	-127,514
21	Marrëdhënie me publikun	Lekë	0	120,000	120,000
22	Taksa (Licenca, leje etj)	Lekë	5,500,000	8,615,929	3,115,929
23	Shpenzime të tjera	Lekë	800,000	403,183	-396,817
24	Fondi rezervë	Lekë	4,228,171	0	-4,228,171
Totali		Lekë	431,916,440	469,435,236	37,518,796

Burimi i të dhënave: UK Elbasan

Investimet Kapitale për vitet 2019, 2020, 2021 në mënyrë të detajuar paraqiten si më poshtë vijon.

Në lekë

Nr	Emërtimi	Njësia e matjes	Programi	Realizimi	Programi	Realizimi	Programi	Realizimi
			2019	2019	2020	2020	2021	2021
I	Investime kapitale korente	lekë	0	0	0	0	0	0
II	Investime kapitale nga fondet e kompanisë	lekë	51,004,000	3,726,000	2,540,000	3,600,000	500,000	500,000
A	Kolaudim martesash	lekë	1,500,000	0	550,000	0	0	0
B	Blerje vegla dhe pajisje pune	lekë	200,000	0	190,000	0	500,000	500,000
C	Rikonstruksione i Godinave të Stacioneve	lekë	1,500,000	0	0	0	0	0
D	Rehabilitim i Rrjetit shpërdarës të Ujësllësit	lekë	32,704,000	0	0	0	0	0
E	Përditësim i Programit të Faturimit	lekë	4,500,000	0	0	0	0	0
F	Mjete vetshkarkuese	lekë	5,000,000	0	0	0	0	0
G	Ndërtim i Sistemeve të reja/Lidhje të reja KUZ në yonën e shërbimit	lekë	3,000,000	0	0	2,300,000	0	0
H	Diyenjim dhe supervizim Projektsh	lekë	800,000	0	0	0	0	0
I	Blerje kompjutera dhe printera	lekë	1,800,000	0	1,800,000	1,300,000	0	0
J	Blerje Server Storage	lekë	0	3,665,000	0	0	0	0
K	Blerje autoklavë	lekë	0	61,000	0	0	0	0
III	Investime Kapitale nga financues të tjerë	lekë	0	26,648,000	71,084,000	61,222,000	30,000,000	30,000,000
A	Projekt Ujësllës në rrugët e qytetit	lekë	0	26,648,000	71,084,000	0	0	0
B	Blerje makineri pajisje	lekë	0	0	0	0	30,000,000	30,000,000
C	Rikonstruksion i rrjetit të Ujësllësit në rrugët e qytetit	lekë	0	0	0	17,989,000	0	0

D	Instalimi i teknologjive të reja	lekë	0	0	0	40,233,000	0	0
E	Studim fizibiliteti për marrje uji me vetërrjedhje	lekë	0	0	0	3,000,000	0	0
Totali		lekë	51,004,000	30,374,000	73,624,000	64,822,000	30,500,000	30,500,000

Burimi i të dhënave: UK Elbasan

Shoqëria ÷Ujësjetllës Kanalizime Elbasanë Sh.a, nuk ka hartuar programe afatmesme dhe afatgjata. Veprim në kundërshtim me Udhëzimin e Ministrisë së Ekonomisë nr. 15, datë 02.05.2018 ÷Mbi programet e zhvillimit ekonomik të shoqërive tregtare me kapital shtetërorë pika I/2.

- Në zbatim të Statutit, neni 7 ÷Kompetencat e Asamblesë së Përgjithshme, pika 1.a ÷Asambleja e Përgjithshme përcakton politikat tregtare të shoqërisë, si dhe miraton planin e biznesit të hartuar nga Këshilli i Administrimit, i cili duhet të përputhet me kontratën për menaxhimin e shërbimit të furnizimit me ujë e kanalizimeve dhe treguesit të punës, për të cilët është rënë dakord midis palëve kontraktore”.

Kjo ka sjellë mungesë të programeve dhe të objektivave afatmesme dhe afatgjatë të shoqërisë, mungesë të vizionit, qëllimeve strategjike, analizave për menaxhimin e kërkesës për ujë, programit për përmirësimin e performancës, si dhe për investimet kapitale, duke vazhduar të punojë me humbje të theksuara nga viti në vit. Kjo situatë ka ndodhur si pasojë e mos implementimit të Udhëzuesit për Reformën Kombëtare në Sektorin Ujësjetllës ÷Kanalizime.

Tabelë: Planifikimi dhe realizimi i programit ekonomik për vitet 2019-2021.

Nr	Emërtim	Njësia e matjes	Plan	Fakt	Plan	Fakt	Plan	Fakt
			2019	2019	2020	2020	2021	2021
1	Të ardhurat	000/Lekë	498,918,087	357,368,486	396,736,299	340,145,524	423,416,440	384,633,550
2	Shpenzimet	000/Lekë	445,414,087	375,542,486	439,485,826	385,924,232	431,916,440	469,435,236
3	Fitimi/Humbja	000/Lekë	53,504,000	-124,558,064	-42,749,527	-123,143,715	-8,500,000	-128,972,992

Burimi: Përpunim i grupit të auditimit.

Referuar të dhënave si më sipër UKE sha ka dalë me humbje përgjatë periudhës së auditimit. Në vitin 2019, humbjet kanë qenë në vlerën 124,558,064 lekë. Në vitin 2020, humbjet kanë qenë në vlerën 123,143,715 lekë, ndërsa në vitin 2021, humbjet kanë qenë më të larta duke arritur në vlerën e 128,972,992 lekë.

Treguesit e performancës në total për tre vite.


Nr	Treguesit e performances	2019	2020	2021	Tregues i pranueshem ERRU %
1	Uji pa te ardhura %	76.79	74.00	74.50	30-50
2	Mbulimi i Kostove O&M (%)	93.62	92.16	78.53	100
3	Mbulimi i kostove totale (%)	67.75	66.30	59.90	80
4	Norma e arketimit e pergjithshme (%)	94.91	94.52	104.12	82
5	Norma e arketimit Korente (%)	65.5	57.2	68.52	82
6	Niveli i matjes (%)	72.21	74.08	75.65	85
7	Efienca e stafit (staf/1000 lidhje UK)	4.7	4.6	5.30	4-6
8	Kohezgjatja e furnizimit me uje (%)	12	12	13.57	18
9	Mbulimi me kanalizime KUN (%)	59.26	58.46	57.04	75
10	Mbulimi me furnizim me uje (%)	72.66	72.92	71.05	

Burimi i të dhënave: UK Elbasan

Prodhim/faturim = uji pa të ardhura

000 m3	Viti 2019		2020		2021	
	Plan	Fakt	Plan	Fakt	Plan	Fakt
Prodhim	15185	18094	18424	16641	18455	17523
Faturim	4469	4199	5379	4326	5287	4469
% uji pa te ardhura	70.57	76.79	70.80	74.00	71.35	74.50

Burimi i të dhënave: UK Elbasan



Në lidhje me prodhimin e ujit së pari, theksojmë se sasia e prodhuar bëhet me llogaritje teknike, pasi nuk janë vendosur matësa qëndrore të prodhimit të ujit.

Përsa i përket shifrave, ka një trend në ulje të ujit pa të ardhura, pavarësisht se është larg normës së pranueshme për humbjet e ujit. Norma kaq e lartë i referohet kryesisht rrjetit të amortizuar pra humbjeve teknike, por një zë të rëndësishëm në humbje zënë lidhjet e paligjshme sidomos në zonat informale ku rrjeti nuk është i kontrollueshëm.

Uji pa të ardhura, pavarësisht trendit në përmirësim të lehtë, mbetet problem serioz, pasi 74.5% është një normë shumë e lartë krahasuar me normën prej 50% e konsideruar si normë e pranueshme. Dhe përveç kësaj fakti që sasia e prodhuar llogaritet me vlerësim, apo që një pjesë e faturimit tek të gjithë kategoritë e klientëve bëhet me përlllogaritje (faturimi afrofe për klientë familjarë, biznese apo institucione), do të thotë se norma prej 74.5% nuk mund të konsiderohet si e saktë dhe plotësisht e besueshme. Shoqëria duhet të marrë masa të menjëhershme për instalimin e matësve të ujit në prodhim, tek konsumatorët në mënyrë që bilancet e ujit të jenë të saktë dhe të mund të përdoren si bazë e planeve të veprimit për reduktimin e humbjeve.

Zërat e kostove Operim dhe mirëmbajtje O&M dhe kostove Totale (000 lekë)

Nr	Kostot	2019 (000leke)	2020 (000leke)	2021	Diferenca 2019- 2020	Diferenca 2020- 2021
				(000leke)		
1	Kosto e punes	179,381	184,669	196,366	-5,288	-11,697
2	Kosto e energjise	140,974	119,502	130,092	21,472	-10,590
3	Kosto lende te para (materiale te para, lende djegese, klor)	13,605	21,464	31,015	-7,859	-9,551
4	Kosto sherbime te kontraktuara roje	19,515	20,267	36,273	-752	-16,006
5	Kosto te tjera	14,201	29,827	54,820	-15,626	-24,993

	Total Kosto O&M	367,676	375,729	448,566	-8,053	-72,837
7	Kostot e amortizimit	97,171	146,506	134,554	-49,335	11,952
8	Kostot financiare, taksa tatime	43,183		4,960	43,183	-4,960
	Kosto kapitale	140,354	146,506	139,514	-6,152	6,992
	Kosto totale	508,030	522,235	588,080	-14,205	-65,845

Burimi i të dhënave: UK Elbasan

Treguesit e mbulimit të kostove të O&M dhe ato totale kanë një përkeqësim të ndjeshëm nga viti në vit. Kostot e operim & mirëmbajtjes janë rritur me 8 milion lekë në vitin 2020 krahasuar me atë 2019, dhe me 72.8 milion lekë në vitin 2021 krahasuar me vitin 2020. Me rritje janë të gjithë zërat e kostove të operim & mirëmbajtje.

Kosto e punës ka pasur rritje +5.3 milion lekë në vitin 2020, dhe 11.7 milion lekë në vitin 2021. Shoqëria UK Elbasan ka rritur ndjeshëm numrin e stafit me 50 punonjës në vitin 2021, krahasuar me dy vitet e mëparshme. Pavarësisht se brenda normës së pranueshme për numrin e stafit për 1000 lidhje, shoqëria duhet të analizojë hollësisht numrin e punonjësve dhe pozicionet në organi gramë, përshkrimet e punës dhe ngarkesa reale për çdo pozicion pune. Në total rritja e numrit të stafit, por edhe rishikimi i nivelit të pagave ka sjellë rritjen e përmendur më sipër të kostove të punës. Menaxhimi i burimeve njerëzore duhet të jetë prioritet për stafin menaxhues të Shoqërisë, pasi kostot e punës zënë respektivisht 49% të kostos O&M për vitet 2019, 2020 dhe 45% për vitin 2021. Numri i stafit duhet të jetë në përputhje me nevojat reale që kërkon zhvillimi i aktivitetit normal të shoqërisë.

Kosto e energjisë ka pasur ulje në vitin 2020 me 21.5 milion lekë, ndërkohë që ka një përkeqësim në vitin 2021 me një rritje prej 10.6 milion lekë. Kostot e energjisë zënë përkatësisht 38% në vitin 2019, 32% në vitin 2020 dhe 29% në vitin 2021 të kostove O&M. Problem për Shoqërinë vazhdojnë të mbeten detyrimet e prapambetura ndaj OSHEE-se.

Rritje progresive ka pasur dhe zëri kosto lëndë të para ku përfshihen kimikate, lëndë djegëse etj. Përkatësisht ka një rritje të kësaj kostoje me 7.9 milion në vitin 2020, dhe 9.6 milion në vitin 2021.


Edhe zëri shërbime të kontraktuara me të tretë, ka një rritje të ndjeshme prej 16 milion lekë në vitin 2021. Shoqëria duhet të parashikojë edhe zgjidhje alternative si teknike dhe logjistike, në mënyrë që të ulët kostoja e këtij shërbimi. Gjithmonë duke u bazuar në legjislacionin në fuqi për ruajtjen e objekteve me rëndësi strategjike.

Zëri kosto të tjera, ku përfshihen kostot e riparim mirëmbajtjes, kostot e përmbarimit, kostot e tjera që nuk u përmendën më lart, ka rritjen më të konsiderueshme ndër zërat e O&M, me një rritje me 15.6 milion në 2020 dhe 25 milion në vitin 2021. Rritje kanë kostot e riparimeve, për shkak të rritjes së numrit të defekteve në rrjetin e transmetimit dhe shpërndarjes, apo nevojës për riparime të pompave dhe motorëve të prodhimit të ujit të pijshëm.

Në përgjithësi mbulimi i kostove të O&M me të ardhurat vjetore të gjëndëruar ka pësuar përkeqësim nga viti në vit duke arritur në 59.9% në vitin 2021, pavarësisht një norme të pranueshme për vitet 2019 dhe 2020 me përkatësisht 93.6% dhe 92.2%.

Kostot kapitale përfshijnë, kostot e amortizimit dhe kostot e tjera financiare, si tatime dhe taksa. Kostot e amortizimit në vitin 2021 kanë një ulje prej 11.9 milion kryesisht për shkak të investimeve të kryera dhe të paraqitura në aktivet e bilancit të shoqërisë, për të cilat është llogaritur amortizimi i vitit. Kostot financiare kanë rritje në vitin 2020 me 6.2 milion dhe ulje në vitin 2021 me 6.9 milion.

Kostot totale të shoqërisë kanë pësuar një rritje nga viti në vit me përkatësisht me 14.2 milion në vitin 2020 dhe 65.8 milion në vitin 2021. Mbulimi i kostove totale të shoqërisë UK Elbasan sha ka ardhur duke u përkeqësuar, nga 67.8% në vitin 2019 në 59.9% në vitin 2021.




Në 000/lekë

Nr	Kostot	2019 (000 leke) parashikim	2019 (000leke) fakt	% ndaj totalit te O&M	% ndaj Kostos Totale	diferenca fakt plan
1	Kosto e punes	192.951	179.381	48.79	35.31	-13570
2	Kosto e energjise	125.900	140.974	38.34	27.75	15074
3	Kosto lende te para (materiale te para, lende djegese, klor)	14.680	13.605	3.70	2.68	-1075
4	Kosto sherbime te kontraktuara roje	23.000	19.515	5.31	3.84	-3485
5	Kosto te tjera	88.863	14.201	3.86	2.80	-74662
	Total Kosto O&M	445394	367676	100.00		
7	Kostot e amortizimit		97171		19.13	
8	Kostot financiare, taksa tatime		43183		8.50	
	Kosto kapitale		140354			
	Kosto totale		508030		100	

Burimi i të dhënave: UK Elbasan


Nisur nga parashikimi ka një tejkalim vetëm të kostos së energjisë, duke u nisur dhe nga fakti që prodhimi ka një rritje të konsiderueshme nga parashikimi, dhe kjo përkthehet në kosto të energjisë së shtuar. Zëri ÷Kosto të tjera÷ është parashikuar i lartë për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura të OSHEE dhe kreditorëve të tjerë.



Në 000/lekë

Nr	Kostot	2020 (000 leke) parashikim	2020 (000leke) fakt	% ndaj totalit te O&M	% ndaj Kostos Totale	diferenca fakt plan
1	Kosto e punes	193588	184669	49.15	35.36	-8919
2	Kosto e energjise	134867	119502	31.81	22.88	-15365
3	Kosto lende te para (materiale te para, lende djegese, klor)	25052	21464	5.71	4.11	-3588
4	Kosto sherbime te kontraktuara roje	27524	20267	5.39	3.88	-7257
5	Kosto te tjera	58454	29827	7.94	5.71	-28627
6				0.00	0.00	
	Total Kosto O&M	439485	375,729.00	100.00		
7	Kostot e amortizimit		146506		28.05	
8	Kostot financiare, taksa tatime				0.00	
	Kosto kapitale		146506			
	Kosto totale		522235		100	


Burimi i të dhënave: UK Elbasan



Në 000/lekë

Nr	Kostot	2021 (000 leke) parashikim	2021 (000leke) fakt	% ndaj totalit te O&M	% ndaj Kostos Totale
1	Kosto e punës		196366	43.78	33.39
2	Kosto e energjisë		130092	29.00	22.12
3	Kosto lende te para (materiale te para, lende djegëse, klor)		31015	6.91	5.27
4	Kosto shërbime te kontraktuara roje		36273	8.09	6.17
5	Kosto te tjera		54820	12.22	9.32
6				0.00	0.00
	Total Kosto O&M	0	448,566.00	100.00	
7	Kostot e amortizimit		134554		22.88
8	Kostot financiare, taksa tatime		4960		0.84
	Kosto kapitale		139514		
	Kosto totale		588080		100

Burimi i të dhënave: UK Elbasan




Në 000/lekë

Arkëtim

Arkëtim (U+K+T+ KAMATE) PA TVSH	2019		%	2020		%	2021		%
	Parashikim	Fakt		Parashikim	Fakt		Parashikim	Fakt	
Total	472,958.00	323,162.00	94.91	378,736.00	322,594.00	94.52	405,416.00	368,813.00	104.12
Korent		211,683.00			184,523.77			252,715.00	
I prapambetur		111,509.00			138,070.23			116,098.00	
% arkëtim korent		65.50			57.20			68.52	
% arkëtim i prapambetur		34.51			42.80			31.48	

Burimi: UK Elbasan




Përqindjet e arkëtimit vjetor total krahasuar me faturimin vjetor, janë në rritje nga viti në vit. Megjithatë arkëtimi korrent është ai që tregon arkëtimin e faturimit të viteve përkatëse, dhe në fakt pavarësisht rritjes progresive është nën normat e konsideruara të pranueshme nga ERRU etj. Përsa i përket arkëtimit të debive të vjetra shoqëria ka akoma një vlerë të konsiderueshme të debisë për të mbledhur, pavarësisht përpjekjeve të saj për lidhjen e aktmarrëveshjeve me debitorët apo dërgim në përmbarim. Shoqëria duhet të ketë në konsideratë se norma e arkëtimit është një nga treguesit më të rëndësishëm të shoqërisë e cila lidhet me qëndrueshmërinë financiare të Shoqërisë dhe me aftësinë e saj paguese.

Niveli i matjes së klientëve (faturim me matesa)

	2019			2020			2021		
	total	matje	%	total	matje	%	total	matje	%
Familjare	35,876	25178	70.18	36007	25982	72.16	36152	26677	73.79
Biznese	3625	3298	90.98	3615	3326	92.01	3648	3385	92.79
Institucione	253	231	91.30	256	235	91.80	263	247	93.92
	39,754	28,707	72.21	39878	29543	74.08	40063	30309	75.65

Burimi i të dhënave: UK Elbasan



Niveli i matjes është në përmirësim, por akoma shumë larg normës së pranueshme. Konsumatorët familjarë të cilët nuk kanë matës, faturohen afro me 150 litra/ditë/banorë, mund të konsumojnë nën këtë normë të vlerësuar ose mund të abuzojnë me të, sidomos në zonat rurale, apo në zonat periferike të qytetit. Pajisja me ujëmatës i të gjithë konsumatorëve duhet të jetë prioritet i Stafit Menaxhues të shoqërisë.

Efienca e stafit (staf/1000 lidhje UK)

	2019	2020	2021
Numri i Stafit te Shoqerise me kohe te plote	335	334	384
Eficienca e Stafit (staf/1000 lidhje UK ose U)	4.7	4.6	5.30

Burimi i të dhënave: UK Elbasan

Eficienca e stafit është në normën e pranuar nga ERRU, pavarësisht një rritjeje të lehtë të këtij parametri.

Ky tregues lidhet direkt me kostot e punës, të cilat zënë një peshë të rëndësishme ndaj totalit të kostove, prandaj dhe ky tregues ka një rëndësi të veçantë. Numri total i punonjësve është rritur konsiderueshëm në vitin 2021 me 50 punonjës. Shoqëria duhet të marrë masa për mos përkeqësimin e këtij treguesi, duke bërë një analizë të thelluar të tij.

Mbulimi me shërbim KUN dhe Ujësjetllës

Mbulimi me shërbim	2019	%	2020	%	2021	%
Popullsia ne zonen e shërbimit	212,628.00		212,628.00		218,780.00	
Popullsia e shërbyer Ujësjetllës	154,487.00	72.66	155,046.00	72.92	155,454.00	71.05
Popullsia e shërbyer kanalizime	126,011.00	59.26	124,309.00	58.46	124,790.00	57.04

Burimi i të dhënave: UK Elbasan sha.

Popullsia në zonën e shërbimit është marrë sipas regjistrit të gjendjes civile në qytetin Elbasan dhe fshatrat që shërbehen nga ana e Ujësjetllës Kanalizime Elbasan sha.

Megjithatë sipas llogaritjes bazuar në numrin e kontratave familjare popullsia e shërbyer del më pak. Një arsye e këtij numri të ulët është edhe fakti se në gjendjen civile ekzistojnë familje të regjistruara në Elbasan, por në fakt nuk jetojnë në territorin e Bashkisë Elbasan, pra nuk kanë ose shkëpusin kontratën me Shoqërinë Ujësjetllës Kanalizime Elbasan sha.

Përsa i përket popullsisë së shërbyer për ujërat e ndotura, Shoqëria shërben vetëm për zonën e qytetit të Elbasanit me një rrjet të mirëfilltë kanalizimesh.

Rritja numrit të popullsisë së shërbyer, kërkon investim në zgjerimin e rrjetit në zonën e shërbimit.

Nr	Emërtim	Njësia e matjes	Plan	Fakt	Plan	Fakt	Plan	Fakt
			2019	2019	2020	2020	2021	2021
1	Të ardhurat	000/Lekë	498,918,087	357,368,486	396,736,299	340,145,524	423,416,440	384,633,550
2	Shpenzimet	000/Lekë	445,414,087	375,542,486	439,485,826	385,924,232	431,916,440	469,435,236
3	Fitimi/Humbja	000/Lekë	53,504,000	-124,558,064	-42,749,527	-123,143,715	-8,500,000	-128,972,992

Burimi i të dhënave: UK Elbasan sha.

1. Titulli i gjetjes:	Programet ekonomik-financiar (buxhetet vjetor) janë hartuar dhe realizuar në pamjaftueshmëri financiare, pasi aktiviteti i shoqërisë nuk është i mbuluar në fakt plotësisht me buxhet.
Situata:	Programet ekonomik-financiar (buxhetet vjetor) janë hartuar dhe realizuar në pamjaftueshmëri financiare, pasi aktiviteti i shoqërisë nuk është i mbuluar plotësisht me buxhet. Konkretisht është programuar dhe realizuar me humbje për vitin 2020 dhe 2021. Në mënyrë të detajuar për vitin 2020, humbja është planifikuar në vlerën -42,749,527 lekë. Të ardhurat janë realizuar në vlerën 340,145,524 lekë, ndërsa shpenzimet janë realizuar në vlerën 385,924,232 lekë, me një humbje në vlerën 45,778,708 lekë. Për vitin 2021 humbja është planifikuar në vlerën -8,500,000 lekë. Të ardhurat janë realizuar në vlerën 384,633,550 lekë, ndërsa shpenzimet janë realizuar në vlerën 469,435,236 lekë, me një humbje në vlerën 84,801,686 lekë.
Kriteri:	Ligji nr. 9901 datë 14.04.2008, òPër Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtareò, me ndryshimet vijuese të tij, neni 37 dhe 82.
Ndikimi/Efekti:	Mos efikasitet në arritjen e objektivave dhe politikave të miratuara për Shoqërinë òUjësjetllës Kanalizime Elbasanò Sh.a Tiranë.
Shkaku:	Kjo situatë ka ndodhur si pasojë e mos vlerësimit sa dhe si duhet nga organet drejtuese.
Rëndësia:	E mesme.
Rekomandimi 1.1:	Organet drejtuese të shoqërisë duhet analizojnë dhe të vlerësojnë arsyet e produktivitetit të ulët të veprimtarisë ekonomik-financiare, efektin e çdo risku të identifikuar, përfshirë një analizë të detajuar të detyrimeve ndaj të tretëve dhe në veçanti kreditë afatshkurtra e afatgjata, si dhe të merren masat e nevojshme për daljen nga kjo situatë që të çon drejt falimentimit.

2. Titulli i gjetjes:	Nuk janë respektuar afatet për dërgimin dhe miratimin e programit ekonomik nga Bashkia Elbasan në cilësinë e Asamblesë së Përgjithshme.
Situata:	Për vitin 2019, 2020 dhe 2021 nuk janë respektuar afatet kohore për dërgimin e projekt programit ekonomik në Këshillin e Administrimit

	dhe në Asamblenë e Përgjithshme. Konkretisht për vitin 2019 programi ekonomik është miratuar me Vendim të Këshillit të Administrimit nr. 22, datë 31.12.2018, ndërsa miratimi përfundimtar i programit ekonomik është realizuar me Vendim të Asamblesë së Përgjithshme nr. 8, datë 07.01.2019 të dhe protokolluar në UKE me nr. 123 prot., datë 10.01.2019. Për vitin 2020 programi ekonomik është miratuar me Vendim të Këshillit të Administrimit nr.177, datë 30.12.2019,. ndërsa miratimi përfundimtar i programit ekonomik është realizuar me Vendim të Asamblesë së Përgjithshme të Shoqërisë nr. 178, datë 30.12.2019. Për vitin 2021 programi ekonomik është miratuar me Vendim të Këshillit të Administrimit nr.182, datë 28.12.2020, ndërsa miratimi përfundimtar i programit ekonomik është realizuar me Vendim të Asamblesë së Përgjithshme të Shoqërisë nr. 183, datë 30.12.2020.
Kriteri:	Udhëzimi i Ministrisë së Ekonomisë nr. 15, datë 02.05.2018 òMbi programet e zhvillimit ekonomik të shoqërive tregtare me kapital shtetërorò ÈÈÈ
Ndikimi/Efekti:	Kjo ka sjellë mungesë të programeve dhe të objektivave afatmesme dhe afatgjatë të shoqërisë.
Shkaku:	Mos vlerësim sa dhe si duhet të afateve të hartimit dhe miratimit të buxheteve.
Rëndësia:	E Lartë
Rekomandimi 2.1:	Organet Drejtuese Shoqërisë të miratoj në kohë programin ekonomik-financiar (buxhetin vjetor) dhe ndryshimet e tij gjatë vitit, si dhe të marrin masa për zbatimin rigoroz të zërave të buxhetit, si për të ardhurat dhe shpenzimet, duke bërë analiza periodike dhe nxjerrë përgjegjësitë përkatëse për devijimet nga programi i miratuar.

3. Titulli i gjetjes:	Nuk janë hartuar programe afatmesme dhe afatgjata.
Situata:	Shoqëria òUjësjetllës Kanalizimeò Elbasan SHA, nuk ka hartuar programe afatmesme dhe afatgjata.
Kriteri:	- Statuti i UKE, Neni 7 òKompetencat e Asamblesë së Përgjithshmeò, Pika 1.a . - Udhëzimi i Ministrisë së Ekonomisë nr. 15, datë 02.05.2018 òMbi programet e zhvillimit ekonomik të shoqërive tregtare me kapital shtetërorò, pika I/2.
Ndikimi/Efekti:	Kjo ka sjellë mungesë të programeve dhe të objektivave afatmesme dhe afatgjatë të shoqërisë, mungesë të vizionit, qëllimeve strategjike, analizave për menaxhimin ekërkesës për ujë, programit për përmirësimin e performancës, si dhe për investimet kapitale, duke vazhduar të punojë me humbje të theksuara nga viti në vit.
Shkaku:	Kjo situatë ka ndodhur si pasojë e mosimplementimit të Udhëzuesit për Reformën Kombëtare në Sektorin UjësjetllësóKanalizime.
Rëndësia:	E lartë.
Rekomandimi 2.1:	Organet Drejtuese të Shoqërisë të marrin masa për hartimin dhe

	miratimin e programe afatmesme dhe afatgjata për përmirësimin e performancës, në kuadër të Reformës Kombëtare të Sektorit Ujësjellës-Kanalizime.
--	--

4. Titulli i gjetjes:	Faturimi korrent është nën normat e konsideruara të pranueshme nga ERRU.
Situata:	<p>Për periudhën e auditimit, përqindjet e arkëtimit vjetor total krahasuar me faturimin vjetor, janë në rritje nga viti në vit. Megjithatë arkëtimi korrent është ai që tregon arkëtimin e faturimit të viteve përkatëse, dhe në fakt pavarësisht rritjes progresive është nën normat e konsideruara të pranueshme nga ERRU etj. Përsa i përket arkëtimit të debive të vjetra shoqëria ka akoma një vlerë të konsiderueshme të debisë për të mbledhur, pavarësisht përpjekjeve të saj për lidhjen e aktmarrëveshjeve me debitorët apo dërgim në përmbarim.</p> <p>Konkretisht në vitin 2019, arkëtimet totale janë në vlerën 323,162,000 lekë, ku arkëtimet korrente janë në vlerën 211,683,000 lekë ose 65.5 % dhe arkëtimet e prapambetura janë në vlerën 111,509,000 lekë ose 34.51 %. Në vitin 2020, arkëtimet totale janë në vlerën 322,594,000 lekë, ku arkëtime korrente janë në vlerën 138,070,230 lekë ose 57.2 %, ndërsa arkëtimet e prapambetura në vlerën 138,070,230 lekë ose 42.8 % Në vitin 2021, arkëtimet totale janë në vlerën 368,813,000 lekë, ku arkëtime korrente janë në vlerën 252,715,000 lekë ose 68.52 %, ndërsa arkëtimet e prapambetura janë në vlerën 116,098,000 lekë ose 31.48 %.</p>
Kriteri:	VKM nr. 1304, datë 11.12.2009 òPër miratimin e rregullores për furnizimin me ujë të pijshëm dhe për kanalizimet në zonën e shërbimit të UKö, pjesa II pika 4, VKM nr. 236, datë 10.5.1993 òPër administrimin dhe furnizimin me ujë tek përdoruesit familjar dhe jo familjarö, i ndryshuar, neni 1; Udhëzimin nr. 3, datë 28.7.2004 òPër administrimin e ujit të pijshëmö, i ndryshuar, pika 6 dhe kontratën e shërbimit të miratuar me vendim të ERRU nr. 8, datë 4.02.2011 òPër miratimin e modelit të kontratës tipö, neni 9, pika 1.
Ndikimi/Efekti:	Risk për vështirësi financiare
Shkaku:	Keq interpretim i dispozitave ligjore që lidhen me shitjen e ujit të pijshëm.
Rëndësia:	I Lartë
Rekomandimi 1.1:	Organet Drejtuese të Shoqërisë të marrin masa për rritjen e arkëtimeve duke reduktuar humbjet menaxheriale të shoqërisë.

2.4. Zbatimi i strukturës organizative, dhënien e pagave dhe shpërblimeve në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi. Zbatimi i ligjshmërisë gjatë procesit të rekrutimit dhe largimit të punonjësve nga puna.

Marrëdhëniet e punës të Shoqërisë ÷Ujësjetllës Kanalizimeo Elbasan SHA janë të rregulluara me Ligjin nr. 7961, datë 12.07.1995 ÷Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë, me ndryshimet vijuese të tij, Rregulloren e Brendshme të miratuar nga Këshilli i Administrimit me Vendimin nr.2, datë 28.02.2022, kontratën kolektive nr. 472 prot., datë 06.02.2019, nënshkruar në datë 05.02.2019, dhe kontratat individuale.

Struktura Organizative

Struktura organizative, është korniza me anë të së cilës planifikohen, zbatohen, kontrollohen dhe raportohen aktivitetet e njësive. Strukturat duhet të jenë në harmoni me përmasat dhe me natyrën specifike të njësive dhe misionin e saj, duhet të vlerësohen kohë pas kohe dhe të modifikohet në rastet se gjykohet e nevojshme. Me vendimet respektive të Këshillit Mbikëqyrës janë miratuar strukturat organizative për çdo vit.

Konkretisht për vitin 2019:

- Asambleja e Përgjithshme e Shoqërisë me Vendim nr.7, datë 07.01.2019 ka miratuar strukturën organizative dhe nivelin e pagave të punonjësve për vitin 2019. Efektet financiare të këtij vendimi pasqyrohen nga data 07.01.2019.

- Këshilli i Administrimit me Vendim nr.1, datë 15.02.2019 dhe Asambleja e Përgjithshme e Shoqërisë me Vendim nr.279, datë 18.02.2019, ka ndryshuar strukturën organizative të miratuar me vendimin si më sipër duke shtuar në organikë Degën e Auditimit të Brendshëm të përbërë nga tre punonjës, konkretisht: një përgjegjës i degës së auditimit dhe dy specialistë të auditimit. Efektet financiare të këtij vendimi pasqyrohen nga data 06.03.2019.

- Këshilli i Administrimit me Vendim nr.683, datë 04.03.2019 dhe Asambleja e Përgjithshme e Shoqërisë me Vendim nr.321, datë 05.03.2019 është vendosur:

-Të reduktohen pozicionet: zv/drejtor dhe përgjegjës investimi, dhe të shtohen pozicionet: Përgjegjës faturimi në zonat rurale me pagë bazë 47,000 lekë, përgjegjës auditimi me pagë bazë 60,000 lekë, specialist auditimi me pagë bazë 44,000 lekë, specialist koordinimi dhe statistike me pagë bazë 54,000 lekë dhe koordinator takse pasurie me pagë bazë 59,750 lekë.

-Ndryshime në nivelin e pagave të disa pozicioneve të shoqërisë Ujësjetllës Kanalizime Elbasan sha deri në miratimin e strukturës përfundimtare, si më poshtë: Operatore me pagë bazë 35,000 lekë, koordinator me pagë bazë 65,000 lekë, inxhinier investimi me pagë bazë 50,000 lekë dhe specialist magazine me pagë bazë 41,000 lekë. Efektet financiare të këtij vendimi pasqyrohen nga data 05.03.2019.

Për vitin 2020:

- Asambleja e Përgjithshme e Shoqërisë me Vendim nr.8, datë 21.05.2020, ka miratuar shtimin e pozicioneve të Zv/Administratorit dhe Ndihmës laborante në strukturën organizative të shoqërisë UKE sha me paga përkatësisht në vlerat 96,500 lekë dhe 26,000 lekë. Efektet financiare të këtij vendimi pasqyrohen nga data 21.05.2020.

- Asambleja e Përgjithshme e Shoqërisë me Vendim nr.183, datë 30.12.2020 ka miratuar planin ekonomik të vitit 2021, strukturën organizative dhe nivelin e pagave të punonjësve. Efektet financiare të këtij vendimi pasqyrohen nga data 30.12.2020.

Për vitin 2021:

- Këshilli i Administrimit me Vendim nr.54, datë 12.04.2021 dhe Asambleja e Përgjithshme e Shoqërisë me Vendim nr.54/1, datë 21.04.2021 ka miratuar strukturën organizative dhe nivelin e pagave të punonjësve të shoqërisë Ujësjetllës Kanalizime Elbasan sha.

- Asambleja e Përgjithshme e Shoqërisë me Vendim nr.126, datë 21.05.2021 ka miratuar strukturën organizative dhe nivelin e pagave të punonjësve të shoqërisë për vitin 2021.

- Këshilli i Administrimit me Vendim nr.192, datë 05.06.2021, ka miratuar ndryshimet emergjente në strukturën organizative të punonjësve të shoqërisë ku janë shtuar pozicionet: Një punonjës përgjegjës operatorësh me pagë bazë 50,000 lekë, pesë punonjës operatorë faturash me pagë bazë 35,000 lekë, një punonjës përgjegjës arshive me pagë bazë 50,000 lekë, dy punonjës leturist me pagë bazë 30,000 lekë, gjashtë punonjës hidraulik me pagë bazë 32,000 lekë, një punonjës përgjegjës faturimi zonat rurale me pagë bazë 50,000 lekë dhe janë shkurtuar pozicionet: njëmbëdhjetë punonjës inspektor, një punonjës kryeinspektor, një punonjës përgjegjës sektori, si dhe shtimin e fondit të pagave në shumën 1,729,494 lekë për shkak të ndryshimeve të sipërcituara dhe miratimin e strukturës së re të shoqërisë, nivelit të ri të pagave dhe numrit të përgjithshëm të punonjësve.

- Asambleja e Përgjithshme e Shoqërisë me Vendim nr.1298, datë 31.12.2021, ka miratuar strukturën organizative të re dhe nivelin e pagave të punonjësve të shoqërisë për vitin 2022 dhe numrin e përgjithshëm të punonjësve.

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion, pagat dhe shpërblimet, përgjithësisht është vepruar në zbatim të Ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008 òPër tregtarët dhe shoqëritë tregtareò, me ndryshimet vijuese të tij, Ligjit nr. 7961, datë 12.07.1995 òKodi i Punës i Republikës së Shqipërisëò, me ndryshimet vijuese të tij ligji, mbi sigurimet shoqërore, ligji mbi tatimin mbi të ardhurat, dhe aktet nënligjore të dala në zbatim të tyre.

Pavarësisht nga sa u deklarua më sipër, u konstatuan shkelle të dispozitave dhe ligjore dhe mangësi të cilat në mënyrë të detajuar paraqiten si më poshtë vijon:

-Niveli i pagave është i paargumentuar për pozicionet respektive sipas strukturës organizative. Konkretisht pagat e punonjësve në pozicione të të njëjtit nivel nuk janë të barabarta/standartizuara, çka rrit pabarazinë dhe mungesën e meritokracisë dhe performancën e punës së përditshme të tyre.

-Dosjet e Personelit

Auditimi u krye me përzgjedhje¹.

Nga 383 punonjës që ka shoqëria u audituan 135 dosje personeli, ose 35% e tyre.

Në 12 raste mungon dëshmia e penalitetit, vërtetimi nga gjykata në afërsisht 70% të rasteve, vërtetimi nga prokuroria mungon në 60% të rasteve, dhe vërtetimi nga njësia bashkiake që nuk merr përkrahje sociale mungon në të gjitha rastet, në 2% të rasteve mungon urdhri i brendshëm i punësimit dhe raporti mjekoóligjor. Veprim në kundërshtim me Vendim nr. 117, datë 05.03.2014 òPër përmbajtjen, procedurën dhe administrimin e dosjeve të personelit e të regjistrit qendror të personelitò.

Theksojmë se neni 5, pika 2 òKushtet e punësimitò, të kontratës individuale të punës, nuk ka të përcaktuar dokumentacionin që duhet të ketë dosja e personelit.

Procedura e Rekrutimit të Punonjësve

-Për periudhën objekt auditimi u konstatua se mungojnë parashikimet specifike në drejtim të zhvillimit dhe administrimit të procesit të rekrutimeve të reja, si dhe të rregullave të parashikuara në statut ose rregullore të procedurave/kritereve/garancive lidhur me transferimet dhe ngritjet në detyrë. Në të gjithë deklaratimet për vende të lira pune për periudhën objekt auditimi nuk deklarohet afati brenda të cilit individët mund të paraqesin aplikimet e tyre. Për më tepër, në

¹ *Auditimi me zgjedhje zhvillohet sipas ISA 530 (i rishikuar) "Kampioni i auditimit", i cili tregon tipet e ndryshme të testeve që audituesi kryen.*

Përkufizimi i një kampioni të zgjedhur për auditim sipas ISA 530 është: "Aplikimi i procedurave të auditimit në më pak se 100% të artikujve brenda një grupi të caktuar të transaksioneve ose llogarive kontabël etj, në atë mënyrë që të gjithë kampionët të kenë të njëjtin shans për tu zgjedhur"

shumë raste evidentohet kohë shumë e shkurtër nga momenti i deklarimit të pozicionit të lirë të punës deri në momentin e emërimit në punë të fituesit. Evidentohet në disa raste mungesa e deklarimeve për vende të lira pune në Zyrën e Punësimit Elbasan, si dhe kriteret e nevojshme për përzgjedhjen/rekrutimin në pozicionet e lira. Evidentohen që për të njëjtin pozicion pune nuk janë të njehsuara kriteret e nevojshme për punësim.

Veprim në kundërshtim me nenin 18 pika 7/1 e VKM nr. 63 datë 27.1.2016, "Për riorganizimin e operatoreve që ofrojnë shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm, grumbullimin, largimin dhe trajtimin e ujërave të ndotura".

Masat disiplinore

Për periudhën objekt auditimi në total janë dhënë 29 masa disiplinore në UKE SHA, nga këto 17 ÷Vërejtje me shkrim, 8 masa ÷Vërejtje me shkrim, paralajmërim për largim nga puna, 4 masa ÷Kalim në një detyrë të një niveli apo klasë më të ulët dhe 0 masa ÷Pushim nga puna. Janë audituar 12 nga këto procedura, ose 41%.

Sipas kontratës tip të punës, neni 16 ÷Disiplina në punë, masat disiplinore: ÷Masat disiplinore shkallëzohen në: vërejtje; vërejtje me paralajmërim; zgjidhje e kontratës së punës; kalim në një detyrë të një niveli apo klasë më të ulët.÷

Evidencat e masave disiplinore sipas viteve 2019-2021.

Nr.	UKE SHA/ Viti	Vërejtje	Vërejtje me paralajmërim për pushim nga puna	Kalim në një detyrë të një niveli apo klasë më të ulët	Zgjidhje e kontratës së punës
1	2019	8	1	0	0
2	2020	5	3	0	0
3	2021	4	4	4	0
Total		17	8	4	0

Burimi: UK Elbasan SHA.

Për periudhën objekt auditimi në total janë dhënë: shtatëmbëdhjetë vërejtje, tetë vërejtje me paralajmërim për pushim nga puna, zero zgjidhje të kontratës së punës dhe katër kalim në një detyrë të një niveli apo klase më të ulët.

Paraqitja e vendimeve gjyqësore për punonjësit e larguar nga detyra para vitit 2019, për të cilët vendimi i formës së prerë dhe likuidimi përkon në vitet 2019-2021:

Nr	Emër Mbiemër	Vendimi i formës së prerë (numër dhe datë)	Vlera e përfituar nga punonjësi	Vlera e shpenzime përmbartimore dhe gjyqësore	Totali i likujduar	Data e likuidimit
1	M. B.	Nr.1709 Dt.26.09.2019	888,602	106 ,632	995,234	30.10.2019
2	D. K.	NR.642 Dt.16.10.2018	437,200	39,600	476,800	05.02.2019
3	A. C.	Nr.499 Dt.23.7.2019	2,763,200	265,267	3,028,467	03.10.2019
4	I. A.	Nr.183 Dt.26.6.2019	571,200	57,120	628,320	26.07.2021
5	V. K.	Nr.736 Dt.12.12.2019	653,000	78,360	73 ,360	03.02.2020
6	Z. H.	Nr.567 Dt.26.09.2019	374 ,000	0	374,000	29.10.2019
TOTALI			5,687,202	546, 979	6,234,181	

Burimi: UK Elbasan SHA

Për periudhën objekt auditimi, shoqëria nuk ka patur procese gjyqësore për punonjësit e larguar. Proceset gjyqësore ndër vite, por të përfunduara me vendim të formës së prerë në periudhën objekt auditimi janë të pasqyruara në tabelën e mësipërme. Në total vlera e përfituar nga punonjësit është 5,687,202 lekë, vlera e shpenzimeve përmbartimore dhe gjyqësore është 546,979 lekë dhe totali i likuiduar është 6,234,181 lekë.

Respektimi i dispozitave ligjore për krijimin e fondit të veçantë, dhënien e shpërblimeve për rezultatet në punë, ndihma për fatkeqësi, për nevoja kulturore, etj.

Nga auditimi, konstatohet se fondi i shpërblimeve përdoret sipas nevojave të cilat dalin në pah në varësi të nevojave të ndryshme në periudhën objekt auditimi.

Të dhëna përmbledhëse për përdorimin e fondit të veçantë përgjatë periudhës së auditimit.

Nr.	Emërtimi	Viti 2019	Viti 2020	Viti 2021
1	Fondi i veçantë			
2	Shpërblime për rezultate në punë	0	45,000	0
3	Shpërblime për fund viti	0	0	0
4	Shpërblime sëmundje	0	0	0
5	Për largime nga puna	0	0	0
6	Për raste fatkeqësie/lindje	37,843	50,000	0
7	Për dalje në pension	352,077	423,225	102,000

Burimi: UK Elbasan SHA.

Fondi i veçantë është përdorur për shpërblime për raste fatkeqësie/lindjeje dhe për dalje në pension. Për raste fatkeqësie/lindje është përdorur në vitin 2019 në vlerën 37,843 lekë dhe në vitin 2020 në vlerën 50,000 lekë. Ndërsa për dalje në pension është përdorur në vitin 2019 në vlerën 352,077 lekë, në vitin 2020 në vlerën 423,225 lekë dhe në vitin 2021 në vlerën 102,000 lekë.

1. Titulli i gjetjes:	Mbi rekrutimin e punonjësve sipas kriterëve të pa përcaktuara.
Situata:	-Për periudhën objekt auditimi u konstatua se mungojnë parashikimet specifike në drejtim të zhvillimit dhe administrimit të procesit të rekrutimeve të reja, si dhe të rregullave të parashikuara në Statut ose Rregullore të procedurave/kritereve/garancive lidhur me transferimet dhe ngritjet në detyrë. Në të gjithë deklaratimet për vende të lira pune për periudhën objekt auditimi nuk deklarohet afati brenda të cilit individët mund të paraqesin aplikimet e tyre. Për më tepër, në shumë raste evidentohet kohë shumë e shkurtër nga momenti i deklaratimit të pozicionit të lirë të punës deri në momentin e emërimit në punë të fituesit. Evidentohet në disa raste mungesa e deklaratimeve për vende të lira pune në Zyrën e Punësimit Elbasan, si dhe kriteret e nevojshme për përzgjedhjen/rekrutimin në pozicionet e lira. Evidentohen që për të njëjtin pozicion pune nuk janë të njehsuara kriteret e nevojshme për punësim.
Kriteri:	Nenin 18 pika 7/1 VKM nr.63 datë 27.1.2016, "Për riorganizimin e operatoreve që ofrojnë shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm,

	grumbullimin, largimin dhe trajtimin e ujërave të ndotura".
Ndikimi/Efekti:	Rregullorja e pasaktë/paqartë krijon konfuzion për përzgjedhjen e duhur të punonjësve të rinj dhe për mirëfunksionimin e shoqërisë duke shtuar indirekt kostot operationale të shoqërisë.
Shkaku:	Rekrutimi i punonjësve pa kritere të mirëpërcaktuara.
Rëndësia:	E lartë
Rekomandimi 1.1:	Nga organet drejtuese të bëhen parashikime të detajuara statutore dhe rregullatore lidhur me zhvillimin dhe administrimin e procesit të rekrutimeve të reja, si dhe të procedurave/kritereve/garancive lidhur me transferimet dhe ngritjet në detyrë.
Rekomandimi 1.2:	Nga organet drejtuese të bëhet adresim korrekt në rregullore i përgjegjësive të punonjësve bazuar në lidhjen shkakësore të veprimeve të tyre me pasojat e kundra ligjshme që mund të shkaktohen.
Rekomandimi 1.3:	Nga Administratori i Shoqërisë të përcaktohet në deklaratimet për pozicione të lira pune, edhe afati brenda të cilit të interesuarit për pozicionin e punës duhet të shprehin interesin dhe paraqesin dokumentacionin e nevojshëm provues.

2.5. Mbi rregullshmërinë e kryerjes së shpenzimeve me arkë, bankë dhe blerjet me vlera të vogla (shpenzimet administrative, për automjetet, udhëtim e dieta brenda dhe jashtë vendit, sponsorizime, etj).

Zbatimi i ligjshmërisë në veprimet me arkë në lekë dhe valutë:

Auditimi u ushtrua me zgjedhje², konkretisht u audituan urdhër transfertat (Shpenzimet me anë të bankës), për muajin dhjetor 2019, viti 2020 dhe muajin dhjetor 2021, në total 1019 transaksione (urdhër transfertat) me vlerë 692,842 mijë lekë. Sipas viteve:

Për muajin dhjetor 2019 janë kryer 131 transaksione bankare në vlerën 67,584 mijë lekë, për vitin 2020 janë kryer 786 transaksione bankare në vlerën 528,075 mijë lekë dhe për muajin dhjetor 2021 janë kryer 102 transaksione bankare në vlerën 97,183 mijë lekë.

Nga auditimi i veprimeve të kryera rast pas rasti, nëpërmjet arkës në lekë dhe valutë, për periudhën 01.01.2019 deri me datë 31.12.2021 u konstatua se, regjistrimet kontabile në ditarin e arkës janë bërë në mënyrë kronologjike e sistematike, veprim për veprim sipas datës së vlerësimit kontabël, bazuar në dokumentet justifikuese. Të gjitha mandatarkëtimet dhe mandatpagesat janë plotësuar dhe firmosur në rregull, sipas të dhënave të dokumenteve justifikuese dhe për çdo muaj është kuadruar ditari i arkës me gjendjen e librit të arkës konformë Ligjit nr. 25/2018, òPër kontabilitetin dhe pasqyrat financiare, me ndryshimet vijuese të tij dhe Udhëzimit MF nr. 30, datë 27.12.2011 òPër menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik, me ndryshimet vijuese të tij.

^{2 2} *Auditimi me zgjedhje zhvillohet sipas ISA 530 (i rishikuar) "Kampioni i auditimit", i cili tregon tipet e ndryshme të testeve që audituesi kryen.*

Përkufizimi i një kampioni të zgjedhur për auditim sipas ISA 530 është: "Aplikimi i procedurave të auditimit në më pak se 100% të artikujve brenda një grupi të caktuar të transaksioneve ose llogarive kontabël etj, në atë mënyrë që të gjithë kampionët të kenë të njëjtin shans për tu zgjedhur".

Zbatimi i ligjshmërisë në veprimet me bankë në lekë dhe valutë:

Nga auditimi i veprimeve të kryera, nëpërmjet bankës në lekë dhe valutë, për periudhën muajin dhjetor 20119, viti 2020 dhe muajin dhjetor 2021 nga dokumentacioni i vënë në dispozicion u konstatua se transaksionet janë kryer konformë Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 për menaxhimin financiar dhe kontrollin, me ndryshimet vijuese të tij, Ligjit nr. 25/2018, për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare, me ndryshimet vijuese të tij, Ligjit 83/2019 për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008 për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë, i ndryshuar, Udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011 për menaxhimin e aktiviteteve në njësitë e sektorit publik, me ndryshimet vijuese të tij.

Veprimet financiare janë regjistruar në regjistrat e kontabilitetit, bazuar në dokumente vërtetues. Dokumentacioni është i sistemuar në mënyrë kronologjike.

Pavarësisht nga sa u citua më sipër u konstatuan dhe shkelje dhe parregullsi ligjore ose rregullatore në 33 transaksione (urdhër transfert) me vlerë 103,400 mijë lekë, ku në mënyrë të detajuar paraqiten si më poshtë:

Me urdhër transfertë datë 13.05.2020 nëpërmjet C është likuiduar Shoqëria ðAö shpk për vlerën 15,087,984 lekë. Dokumenti justifikues fatura nr. 75, datë 12.05.2020 në vlerën 15,087,984 lekë me objekt materiale hidraulike, firmosur nga A. M. me detyrë ish-drejtorë e Drejtorisë Tregtare dhe për Shoqërinë ðAö shpk A. N. Fatura cilëson materiale sipas listës bashkëlidhur. Lista bashkëlidhur në vlerën 15,087,984 lekë, dokument i fotokopjuar firmosur vetëm nga administratorja e Shoqërisë ðAö L. N., dokument i pa vlefshëm për tu marr në konsideratë, pasi jo vetëm është dokument i fotokopjuar por edhe nuk është firmosur nga A. M. Veprim në kundërshtim me Udhëzimin e Ministrisë së Drejtësisë nr. 6291, datë 17.8.2005 për evidentimin, administrimin dhe ruajtjen e akteve e të dokumenteve noteriale, si dhe për organizimin dhe ruajtjen e arkivave noteriale Udhëzimin e MF nr. 30 datë 27.12.2011 për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik, i ndryshuar me nr. 20, datë 17.11.2014 pika 36 dhe 44. Fletëhyrja nr. 18, datë 12.05.2020.

Urdhër i administratorit të Shoqërisë L. D. nr. 272/11 prot, datë 28.04.2020 për marrjen në dorëzim për blerjen e materialeve hidraulike, i përberë nga K. C., K. M. dhe Y. A.

Procesverbali i marrjes në dorëzim me nr. 65872575 prot., datë 12.05.2020 i firmosur nga K. C., K. M. dhe Y. A., ku është cilësuar ðMalli u dorëzua sipas listës bashkëlidhur faturës, duke mos cilësuar zbatimin ose jo të specifikimeve teknike (shtojca 10 e dokumenteve të tenderit) Shtojca 6 ðDeklaratë mbi përmbushjen e specifikimeve teknike nga operatori ekonomik dhe nenin 9/1 i kontratës ðMallrat e furnizuara sipas kontratës duhet të jenë konformë kodeve dhe Standardeve Teknike të parashikuara në specifikimet teknike. Nëse gjatë ekzekutimit të kontratës, ka ndryshime në kodet përkatëse ose në Standardet Teknike, këto ndryshime do të zbatohen vetëm pas aprovimit nga Autoriteti Kontraktor.

Veprim në kundërshtim me:

- Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 për prokurimin publik, i ndryshuar, neni 60, pika 1, e cila përcakton se: ð1. Kushtet e kontratës, të lidhur sipas këtij ligji, nuk ndryshojnë nga ato të përshkruara në dokumentet e tenderit dhe në ofertën fituese.

- Ligjin nr. 7850, datë 29.07.1994 ðKodi Civil i Republikës së Shqipërisë, neni 419, 420, neni 659, 698 dhe neni 690 në të cilin është shprehur ð.....Mos përmbushja e detyrimeve përkatëse sjell lindjen e përgjegjësisë juridiko-civile për palën mos përmbushëse, përgjegjësi e cila konkretizohet në detyrimin për të shpërblyer palës/palëve të tjera shpërblyerim dhe dëmit të pësuar në formën dëmit efektiv dhe fitimit të munguar.

-Udhëzimin e Ministrisë Financave nr. 30 datë 27.12.2011, për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik, i ndryshuar me nr. 20, datë 17.11.2014 pika 35.

Për sa mësipër mban përgjegjësi grupi i akt kolaudimit i përbërë nga K. C., K. M. dhe Y. A. Me urdhër transfertë datë 27.07.2020 nëpërmjet C është likuiduar Shoqëria ðAö shpk për vlerën 9,000,000 lekë. Dokumenti justifikues fatura nr. 86, datë 20.07.2020 në vlerën 26,409,312 lekë me objekt materiale hidraulike, firmosur nga A. M. me detyrë me detyrë ish-drejtores e Drejtorisë Tregtare dhe për Shoqërinë ðAö shpk A. N.. Fatura cilëson materiale sipas listës bashkëlidhur. Lista bashkëlidhur në vlerën 26,409,312 lekë, firmosur vetëm nga administratorja e Shoqërisë ðAö L. N., dokument nuk është firmosur nga A. M.

Fletëhyrja nr. 25/1, datë 20.07.2020 me fraksion, nuk është mbajtur procesverbal për fraksionin e fletëhyrjes, veprim në kundërshtim me Udhëzimin MF nr. 30 datë 27.12.2011 ðPër menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik, i ndryshuar, pika 53 ku është shprehur në mënyrë eksplicite *ðKontrollohet numri rendor i dokumentit, si për fletëhyrje dhe fletëdalje, të cilat duhet të ndjekin rendin kronologjik dhe të mos kenë kapërcim numri, të ketë adresën nga vjen dhe kujt i dërgohet malli. Kur konstatohet kapërcim i numrit rendor apo data jo kronologjike, nëpunësi zbatues mban procesverbal me personat me përgjegjësi materiale, dokumenton dhe sinjalizon çdo parregullsi.*

Për sa mësipër mban përgjegjësi A. M. me detyrë me detyrë ish-drejtores e Drejtorisë Tregtare dhe Y. A. me detyrë magazinier.

Urdhër i administratorit të Shoqërisë L. D. nr. 272/11 prot, datë 28.04.2020 ðPër marrjen në dorëzim për blerjen e materialeve hidraulike, i përbërë nga K. C., K. M. dhe Y. A. Nuk ka procesverbal të marrjes në dorëzim të materialeve hidraulike nga grupi i marrjes në dorëzim i përbërë nga K. C., K. M. dhe Y. A. dhe A. M., veprim në kundërshtim me Udhëzimin MF nr. 30 datë 27.12.2011 ðPër menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik, i ndryshuar, pika 54, si dhe me urdhrin e administratorit nr. 272/11 prot., datë 28.04.2020.

Me urdhër transfertë datë 29.02.2020 nëpërmjet A është likuiduar autoservis-llamarinist X. Sh. për vlerën 100,000 lekë. Dokumenti justifikues dëftesa tatimore me numër serie 5039345, firmosur nga A. M. me detyrë me detyrë ish-drejtores e Drejtorisë Tregtare dhe Xh. Sh. për autoservis-llamarinist. Fatura nuk është plotësuar në të gjitha gjenalitetet, nuk të shënuar niptin dhe datën.

Veprim në kundërshtim me Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 ðPër menaxhimin financiar dhe kontrollin, me ndryshimet vijuese të tij, neni 2 dhe neni 4, Ligjin nr. 25/2018, ðPër kontabilitetin dhe pasqyrat financiare, me ndryshimet vijuese të tij, neni 7, Ligjin 83/2019 ðPër disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008 ðPër procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë, neni 2, 3 dhe 6, Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 ðPër menaxhimin e aktivitetëve në njësitë e sektorit publik, me ndryshimet vijuese të tij, pika 35.

Procesverbali i konstatimit të shkeljes nga Drejtoria e Policisë Vendore Elbasan me nr. serie 8907209, punonjësi me nr. 14375, data 09.09.2020, për drejtuesin e mjetit S. M., për mjetin Volksvagen me targë E. Automjeti me targë E ka qenë i siguruar me policë sigurimi me nr. serial 2002055398 me periudhe sigurimi 20.05.2020 deri 19.05. 2021 tek Shoqëria S. Si pasojë e këtij sigurimi kjo shoqëri ka likuiduar vlerën 100,000 lekë, nëpërmjet B me mandat elektronik datë 30.10.2020.

Me urdhër transfertë datë 29.12.2020 nëpërmjet BKT Bankë është likuiduar Shoqëria ðEö Shpk për vlerën 2,297,700 lekë. Dokumenti justifikues faturë tatimore shitje me numër 54, datë 22.09.2020, firmosur dhe vulosur vetëm nga Shoqëria ðEö Shpk. Fatura nuk është e firmosur nga blerësi, në kundërshtim me Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 ðPër menaxhimin financiar dhe kontrollin, me ndryshimet vijuese të tij, neni 2 dhe neni 4, Ligjin nr. 25/2018, ðPër kontabilitetin dhe pasqyrat financiare, me ndryshimet vijuese të tij, neni 7, Ligjin 83/2019 ðPër disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008 ðPër procedurat tatimore në

Republikën e Shqipërisë nënien 2, 3 dhe 6, Udhëzimin MF nr. 30, datë 27.12.2011 për menaxhimin e aktiviteteve në njësitë e sektorit publik, me ndryshimet vijuese të tij, pika 35. Situacioni nr. 1, i pa datuar për vlerën 2,297,700 lekë. Urdhri për marrjen dorëzimit, i pa protokolluar dhe i pa datuar firmosur nga ish-administratori, i përberë nga L. D., J. D. dhe J. D. Procesverbali i marrjes në dorëzim datë 25.09.2020 është firmosur nga L. D., J. D. dhe J. D. Me urdhër transfertë datë 02.03.2020 nëpërmjet B është likuiduar Shoqëria "E" Shpk për vlerën 21,600 lekë. Dokumenti justifikues faturë tatimore shitje me numër 3, datë 15.01.2020, punime shërbimi ngjitje tubi me aparat, firmosur dhe vulosur vetëm nga Shoqëria "E" Shpk. Fatura nuk është e firmosur nga blerësi, si dhe nuk ka asnjë dokument tjetër vërtetues. Veprim në kundërshtim me Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 për menaxhimin financiar dhe kontrollin, me ndryshimet vijuese të tij, nënien 2 dhe nënien 4, Ligjin nr. 25/2018, për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare, nënien 7, Ligjin 83/2019 për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008 për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë nënien 2, 3 dhe 6, Udhëzimin MF nr. 30, datë 27.12.2011 për menaxhimin e aktiviteteve në njësitë e sektorit publik, me ndryshimet vijuese të tij, pika 35.

Për sa më sipër mban përgjegjësi A. M. me detyrë me detyrë ish-drejtores dhe Drejtorisë Tregtare.

Me urdhër transfertë datë 27.07.2020 nëpërmjet BKT Bankë është likuiduar personi fizik K. S. për vlerën 703,096 lekë. Dokumenti justifikues faturë tatimore shitje me numër 143, datë 29.04.2020, e cila cilëson dizinfektim Covid-19. Nuk ka asnjë dokument tjetër, nuk cilëson dezinfektim i brendshëm ose i jashtëm. Nuk ka të përcaktuar produktet biocide që do përdoren për dizinfektim, të cilat duhet të jenë në listën e miratuar nga Ministri i Shëndetësisë, të kenë veprim baktericid, fungicid dhe virusicid, nuk duhet të shkaktojnë efekte anësore që rrezikojnë jetën dhe shëndetin e njerëzve, kafshëve dhe bimëve, si dhe nuk duhet të kenë ndikim negativ në mjedisë. Nuk është përcaktuar sasia dhe grafiku. Mënyra e dezinfektimit me spërkatje mjegullës në të ftohtë, mjetet e përdorura (pompa /cantë shpine me presion etj. Veprim në kundërshtim me udhëzimin e përbashkët Agjencia e prokurimit Publik me nr. 2857 prot, datë 06.05.2020 dhe Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale nr. 2163 prot, datë 06.05.2020 për përcaktimin e listës së mallrave dhe shërbimeve për përbashkimin e situatës së krijuar nga epidemia Covid-19.

Me urdhër transfertë datë 27.07.2020 nëpërmjet C është likuiduar Shoqëria "A" Sh.a për vlerën 901,170 lekë. Dokumenti justifikues faturë tatimore shitje me numër 203, datë 01.06.2020 për vlerën 445,555 lekë, për 3000 litra dizel dhe 500 litra benzinë. Fletë hyrje nr. 21, datë 01.06.2020, kuotimi i çmimit të biznesit, të paraqitur nga shoqëria A Sh.a, buletini i APP nr.32, datë 01.06.2020 Për çmimin e karburanteve të marr nga Bursa "P", datë 20.05.2020, kursi zyrtar i kthimit nga Dollar Amerikan(USD) në lekë për njësi për periudhën 01.06.2020 deri më 01.06.2020. Kjo faturë nuk shoqërohet me raport analizë para zhdoganimit, të lëshuar nga laboratorit i Kontrollit të Naftës dhe Gazit, (Drejtorit e laboratorit Qendror të Kontrollit; Inspektoratit Shtetëror Teknik dhe Industrial), për pasoj nuk mund të verifikohet zbatimi/ose jo i specifikimeve (shtojca 9 e dokumenteve të tenderit) Shtojca 6 "Deklaratë mbi përmbushjen e specifikimeve teknike nga operatori ekonomik dhe nënien 9/1 i kontratës "Mallrat e furnizuara sipas kontratës duhet të jenë konformë kodeve dhe Standardeve Teknike të parashikuara në specifikimet teknike. Nëse gjatë ekzekutimit të kontratës, ka ndryshime në kodet përkatëse ose në Standardet Teknike, këto ndryshime do të zbatohen vetëm pas aprovimit nga Autoriteti Kontraktorë. Fatura është e pa firmosur nga blerësi dhe transportuesi. Dokumenti justifikues faturë tatimore shitje me numër 233, datë 01.06.2020 për vlerën 456,615 lekë, për 3000 litra dizel dhe 500 litra benzinë. Fletë hyrje nr. 24, datë 26.06.2020, kuotimi i çmimit të biznesit, të paraqitur nga shoqëria "A" Sh.a, buletini i APP nr.37, datë 22.06.2020 Për çmimin e karburanteve të marr nga Bursa "P", datë 15.06.2020, kursi zyrtar i kthimit nga Dollar

Amerikan.(USD) në lekë për njësi për periudhën 26.06.2020 deri më 26.06.2020. Kjo faturë nuk shoqërohet me raport analizë para zhdoganimit, të lëshuar nga Laboratori i Kontrollit të Naftës dhe Gazit,(Drejtoria laboratorit Qendror të Kontrollit; Inspektorati Shtetëror Teknik dhe Industrial), për pasoj nuk mund të verifikohet zbatimi/ose jo i specifikimeve (shtojca 9 e dokumenteve të tenderit) Shtojca 6 òDeklaratë mbi përmbushjen e specifikimeve teknike nga operatori ekonomik dhe nenin 9/1 i kontratës òMallrat e furnizuara sipas kontratës duhet të jenë konform kodeve dhe Standardeve Teknike të parashikuara në specifikimet teknike. Nëse gjatë ekzekutimit të kontratës, ka ndryshime në kodet përkatëse ose në Standardet Teknike, këto ndryshime do të zbatohen vetëm pas aprovimit nga Autoriteti Kontraktorë. Fatura është e pa firmosur nga blerësi dhe transportuesi, Veprim në kundërshtim me:

- Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 òPër prokurimin publikò, i ndryshuar, neni 60, pika 1, e cila përcakton se: ò1. Kushtet e kontratës, të lidhur sipas këtij ligji, nuk ndryshojnë nga ato të përshkruara në dokumentet e tenderit dhe në ofertën fitueseò.

- Ligjin nr. 7850, datë 29.07.1994 òKodi Civil i Republikës së Shqipërisëò, neni 419, 420, neni 659, 698 dhe neni 690 në të cilin është shprehur ò.....Mos përmbushja e detyrimeve përkatëse sjell lindjen e përgjegjësisë juridiko-civile për palën mos përmbushëse, përgjegjësi e cila konkretizohet në detyrimin për ti shpërblyer palës/palëve të tjera shpërblimin e dëmit të pësuar në formën dëmit efektiv dhe fitimit të munguarò.

-Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 òPër menaxhimin financiar dhe kontrollinò, me ndryshimet vijuese të tij, neni 2 dhe neni 4, Ligjin nr. 25/2018, òPër kontabilitetin dhe pasqyrat financiareò, me ndryshimet vijuese të tij, neni 7, Ligjin 83/2019 òPër disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008 òPër procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisëò , neni 2, 3 dhe 6

-Udhëzimin e Ministrisë Financave nr. 30 datë 27.12.2011, òPër menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publikò, i ndryshuar me nr. 20, datë 17.11.2014 pika 35.

Për sa mësipër mban përgjegjësi A. M. me detyrë me detyrë ish-drejtores e Drejtorisë Tregtare.

Me urdhër transfertë datë 09.09.2020 nëpërmjet Credins Bankë është likuiduar Shoqëria òAò Sh.a për vlerën 535,800 lekë. Dokumenti justifikues faturë tatimore shitje me numër 891, datë 24.07.2020 për vlerën 535,800 lekë, për 4000 litra dizel. Fletë hyrje nr. 26, datë 24.07.2020, kuotimi i çmimit të biznesit, të paraqitur nga shoqëria òAò Sh.a, buletini i APP nr.43, datë 20.07.2020 Për çmimin e karburanteve të marr nga Bursa òPò, datë 14.07.2020, kursi zyrtar i kthimit nga Dollar Amerikan (USD) në lekë për njësi për periudhën 24.07.2020 deri më 24.07.2020. Kjo faturë nuk shoqërohet me raport analizë para zhdoganimit, të lëshuar nga Laboratori i Kontrollit të Naftës dhe Gazit,(Drejtoria e Laboratorit Qendror të Kontrollit; Inspektorati Shtetëror Teknik dhe Industrial), për pasoj nuk mund të verifikohet zbatimi/ose jo i specifikimeve (shtojca 9 e dokumenteve të tenderit) Shtojca 6 òDeklaratë mbi përmbushjen e specifikimeve teknike nga operatori ekonomik dhe nenin 9/1 i kontratës òMallrat e furnizuara sipas kontratës duhet të jenë konformë kodeve dhe standardeve teknike të parashikuara në specifikimet teknike. Nëse gjatë ekzekutimit të kontratës, ka ndryshime në kodet përkatëse ose në standardet teknike, këto ndryshime do të zbatohen vetëm pas aprovimit nga Autoriteti Kontraktorë.

Veprim në kundërshtim me:

- Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 òPër prokurimin publikò, i ndryshuar, neni 60, pika 1, e cila përcakton se: ò1. Kushtet e kontratës, të lidhur sipas këtij ligji, nuk ndryshojnë nga ato të përshkruara në dokumentet e tenderit dhe në ofertën fitueseò.

- Ligjin nr. 7850, datë 29.07.1994 òKodi Civil i Republikës së Shqipërisëò, neni 419, 420, neni 659, 698 dhe neni 690 në të cilin është shprehur ò.....Mos përmbushja e detyrimeve përkatëse sjell lindjen e përgjegjësisë juridiko-civile për palën mos përmbushëse, përgjegjësi e

cila konkretizohet në detyrimin për ti shpërblyer palës/palëve të tjera shpërblimin e dëmit të pësuar në formën dëmit efektiv dhe fitimit të munguar.

Për sa mësipër mban përgjegjësi A. M. me detyrë me detyrë ish-drejtores e Drejtorisë Tregtare.

Me urdhër transfertë datë 09.09.2020 nëpërmjet C. është likuiduar Shoqëria òAò Sh.a për vlerën 267,940 lekë. Dokumenti justifikues faturë tatimore shitje me numër 427, datë 25.08.2020 për vlerën 267,940 lekë, për 2000 litra dizel. Fletë hyrje nr. 27, datë 25.08.2020, kuotimi i çmimit të biznesit, të paraqitur nga shoqëria òAò Sh.a, buletini i APP nr.59, datë 24.08.2020 Për çmimin e karburanteve të marr nga Bursa òPò, datë 19.08.2020, kursi zyrtar i kthimit nga Dollar Amerikan.(USD) në lekë për njësi për periudhën 25.08.2020 deri më 25.08.2020. Kjo faturë nuk shoqërohet me raport analizë para zhdoganimit, të lëshuar nga Laboratori i Kontrollit të Naftës dhe Gazit,(Drejtoria e laboratorit Qendror të Kontrollit; Inspektorati Shtetëror Teknik dhe Industrial), për pasoj nuk mund të verifikohet zbatimi/ose jo i specifikimeve (shtojca 9 e dokumenteve të tenderit) Shtojca 6 òDeklaratë mbi përmbushjen e specifikimeve teknike nga operatori ekonomik dhe nenin 9/1 i kontratës òMallrat e furnizuara sipas kontratës duhet të jenë konformë kodeve dhe standardeve teknike të parashikuara në specifikimet teknike. Nëse gjatë ekzekutimit të kontratës, ka ndryshime në kodet përkatëse ose në standardet teknike, këto ndryshime do të zbatohen vetëm pas aprovimit nga Autoriteti Kontraktorë. Fatura është e pa firmosur nga blerësi dhe transportuesi.

Veprim në kundërshtim me:

- Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 òPër prokurimin publikò, i ndryshuar, neni 60, pika 1, e cila përcakton se: ò1. Kushtet e kontratës, të lidhur sipas këtij ligji, nuk ndryshojnë nga ato të përshkruara në dokumentet e tenderit dhe në ofertën fitueseò.

- Ligjin nr. 7850, datë 29.07.1994 òKodi Civil i Republikës së Shqipërisëò, neni 419, 420, neni 659, 698 dhe neni 690 në të cilin është shprehur ò.....Mos përmbushja e detyrimeve përkatëse sjell lindjen e përgjegjësisë juridiko-civile për palën mos përmbushëse, përgjegjësi e cila konkretizohet në detyrimin për ti shpërblyer palës/palëve të tjera shpërblimin e dëmit të pësuar në formën dëmit efektiv dhe fitimit të munguar.

-Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 òPër menaxhimin financiar dhe kontrollinò, me ndryshimet vijuese të tij, neni 2 dhe neni 4, Ligjin nr. 25/2018, òPër kontabilitetin dhe pasqyrat financiareò, me ndryshimet vijuese të tij, neni 7.

-Udhëzimin e Ministrisë Financave nr. 30 datë 27.12.2011, òPër menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publikò, i ndryshuar me nr. 20, datë 17.11.2014 pika 35.

Për sa mësipër mban përgjegjësi A. M. me detyrë me detyrë ish-drejtores e Drejtorisë Tregtare.

Me urdhër transfertë datë 27.11.2020 nëpërmjet Credins Bankë është likuiduar Shoqëria òAò Sh.a për vlerën 510,520 lekë. Dokumenti justifikues faturë tatimore shitje me numër 854, datë 01.10.2020 për vlerën 510,520 lekë, për 4000 litra dizel Fletë hyrje nr. 31, datë 01.10.2020, kuotimi i çmimit të biznesit, të paraqitur nga shoqëria òAò Sh.a, buletini i APP nr.77, datë 28.09.2020 Për çmimin e karburanteve të marr nga Bursa òPò, datë 22.09.2020, kursi zyrtar i kthimit nga Dollar Amerikan.(USD) në lekë për njësi për periudhën 01.10.2020 deri më 01.10.2020. Kjo faturë nuk shoqërohet me raport analizë para zhdoganimit, të lëshuar nga Laboratori i Kontrollit të Naftës dhe Gazit,(Drejtoria e Laboratorit Qendror të Kontrollit; Inspektorati Shtetëror Teknik dhe Industrial), për pasoj nuk mund të verifikohet zbatimi/ose jo i specifikimeve (shtojca 9 e dokumenteve të tenderit) Shtojca 6 òDeklaratë mbi përmbushjen e specifikimeve teknike nga operatori ekonomik dhe nenin 9/1 i kontratës òMallrat e furnizuara sipas kontratës duhet të jenë konformë kodeve dhe standardeve teknike të parashikuara në specifikimet teknike. Nëse gjatë ekzekutimit të kontratës, ka ndryshime në kodet përkatëse ose

në standardet teknike, këto ndryshime do të zbatohen vetëm pas aprovimit nga Autoriteti Kontraktorë. Fatura është e pa firmosur nga blerësi dhe transportuesi.

Veprim në kundërshtim me:

- Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 ÷Për prokurimin publikë, i ndryshuar, neni 60, pika 1, e cila përcakton se: ÷1. Kushtet e kontratës, të lidhur sipas këtij ligji, nuk ndryshojnë nga ato të përshkruara në dokumentet e tenderit dhe në ofertën fitueseë.

- Ligjin nr. 7850, datë 29.07.1994 ÷Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë, neni 419, 420, neni 659, 698 dhe neni 690 në të cilin është shprehur ÷.....Mos përmbushja e detyrimeve përkatëse sjell lindjen e përgjegjësisë juridiko-civile për palën mos përmbushëse, përgjegjësi e cila konkretizohet në detyrimin për ti shpërblyer palës/palëve të tjera shpërblimin e dëmit të pësuar në formën dëmit efektiv dhe fitimit të munguarë.

-Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 ÷Për menaxhimin financiar dhe kontrollinë, me ndryshimet vijuese të tij, neni 2 dhe neni 4, Ligjin nr. 25/2018, ÷Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiareë, me ndryshimet vijuese të tij, neni 7, Ligjin 83/2019 ÷Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008 ÷Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë neni 2, 3 dhe 6

-Udhëzimin e Ministrisë Financave nr. 30 datë 27.12.2011, ÷Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publikë, i ndryshuar me nr. 20, datë 17.11.2014 pika 35.

Me urdhër transfertë datë 29.12.2020 nëpërmjet C është likuiduar Shoqëria ÷Aö Sh.a për vlerën 537,080 lekë. Dokumenti justifikues faturë tatimore shitje me numër 480, datë 07.12.2020 për vlerën 537,080 lekë, për 4000 litra dizel. Fletë hyrje nr. 44, datë 07.12.2020, kuotimi i çmimit të biznesit, të paraqitur nga shoqëria ÷Aö Sh.a, buletini i APP nr.115, datë 07.12.2020 Për çmimin e karburanteve të marr nga Bursa ÷Pö, datë 30.11.2020, kursi zyrtar i kthimit nga Dollar Amerikan (USD) në lekë për njësi për periudhën 07.12.2020 deri më 07.12.2020. Kjo faturë nuk shoqërohet me raport analizë para zhdoganimit, të lëshuar nga laboratorit i Kontrollit të Naftës dhe Gazit,(Drejtorit e Laboratorit Qendror të Kontrollit; Inspektorati Shtetëror Teknik dhe Industrial), për pasoj nuk mund të verifikohet zbatimi/ose jo i specifikimeve (shtojca 9 e dokumenteve të tenderit) Shtojca 6 ÷Deklaratë mbi përmbushjen e specifikimeve teknike nga operatori ekonomikë dhe nenin 9/1 i kontratës ÷Mallrat e furnizuara sipas kontratës duhet të jenë konformë kodeve dhe standardeve teknike të parashikuara në specifikimet teknike. Nëse gjatë ekzekutimit të kontratës, ka ndryshime në kodet përkatëse ose në Standardet Teknike, këto ndryshime do të zbatohen vetëm pas aprovimit nga Autoriteti Kontraktor. ÷ Fatura është e pa firmosur nga blerësi dhe transportuesi

Veprim në kundërshtim me:

-Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 ÷Për prokurimin publikë, i ndryshuar, neni 60, pika 1, e cila përcakton se: ÷1. Kushtet e kontratës, të lidhur sipas këtij ligji, nuk ndryshojnë nga ato të përshkruara në dokumentet e tenderit dhe në ofertën fitueseë.

- Ligjin nr. 7850, datë 29.07.1994 ÷Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë, neni 419, 420, neni 659, 698 dhe neni 690 në të cilin është shprehur ÷.....Mos përmbushja e detyrimeve përkatëse sjell lindjen e përgjegjësisë juridiko-civile për palën mos përmbushëse, përgjegjësi e cila konkretizohet në detyrimin për ti shpërblyer palës/palëve të tjera shpërblimin e dëmit të pësuar në formën dëmit efektiv dhe fitimit të munguarë.

-Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 ÷Për menaxhimin financiar dhe kontrollinë, me ndryshimet vijuese të tij, neni 2 dhe neni 4, Ligjin nr. 25/2018, ÷Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiareë, me ndryshimet vijuese të tij, neni 7, Ligjin 83/2019 ÷Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008 ÷Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë neni 2, 3 dhe 6

-Udhëzimin e Ministrisë Financave nr. 30 datë 27.12.2011, ÷Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publikë, i ndryshuar me nr. 20, datë 17.11.2014 pika 35.

Për sa më sipër mban përgjegjësi A. M. me detyrë me detyrë ish-drejtores e Drejtorisë Tregtare.

Me urdhër transfertë datë 13.02.2020 nëpërmjet Credins Bankë është likuiduar Shoqëria òAò Sh.a për vlerën 735,654 lekë. Dokumenti justifikues faturë tatimore shitje me numër 517, datë 27.01.2020 për vlerën 77,715 lekë, për 500 litra benzinë. Fletë hyrje nr. 6, datë 27.01.2020, kuotimi i çmimit të biznesit, të paraqitur nga shoqëria òAò Sh.a, buletini i APP nr.3, datë 27.01.2020 Për çmimin e karburanteve të marr nga Bursa òPò, datë 20.01.2020, kursi zyrtar i kthimit nga Dollar Amerikan (USD) në lekë për njësi për periudhën 27.01.2020 deri më 27.01.2020. Kjo faturë nuk shoqërohet me raport analizë para zhdoganimit, të lëshuar nga laboratorit i Kontrollit të Naftës dhe Gazit, (Drejtorit e Laboratorit Qendror të Kontrollit; Inspektorati Shtetëror Teknik dhe Industrial), për pasoj nuk mund të verifikohet zbatimi/ose jo i specifikimeve (shtojca 9 e dokumenteve të tenderit) Shtojca 6 òDeklaratë mbi përmbushjen e specifikimeve teknike nga operatori ekonomik dhe nenin 9/1 i kontratës òMallrat e furnizuara sipas kontratës duhet të jenë konformë kodeve dhe standardeve teknike të parashikuara në specifikimet teknike. Nëse gjatë ekzekutimit të kontratës, ka ndryshime në kodet përkatëse ose në standardet teknike, këto ndryshime do të zbatohen vetëm pas aprovimit nga Autoriteti Kontraktorë.

Dokumenti justifikues faturë tatimore shitje me numër 739, datë 07.01.2020 për vlerën 657,920 lekë, për 4000 litra naftë. Fletë hyrje nr. 1, datë 07.01.2020, kuotimi i çmimit të biznesit, të paraqitur nga shoqëria òAò Sh.a, buletini i APP nr.53, datë 31.12.2020 Për çmimin e karburanteve të marr nga Bursa òPò, datë 24.12.2019, kursi zyrtar i kthimit nga Dollar Amerikan.(USD) në lekë për njësi për periudhën 07.01.2020 deri më 07.01.2020. Kjo faturë nuk shoqërohet me raport analizë para zhdoganimit, të lëshuar nga Laboratorit i Kontrollit të Naftës dhe Gazit, (Drejtorit e laboratorit Qendror të Kontrollit; Inspektorati Shtetëror Teknik dhe Industrial), për pasoj nuk mund të verifikohet zbatimi/ose jo i specifikimeve (shtojca 9 e dokumenteve të tenderit) Shtojca 6 òDeklaratë mbi përmbushjen e specifikimeve teknike nga operatori ekonomik dhe nenin 9/1 i kontratës òMallrat e furnizuara sipas kontratës duhet të jenë konformë kodeve dhe Standardeve Teknike të parashikuara në specifikimet teknike. Nëse gjatë ekzekutimit të kontratës, ka ndryshime në kodet përkatëse ose në standardet teknike, këto ndryshime do të zbatohen vetëm pas aprovimit nga Autoriteti Kontraktorë.

Veprim në kundërshtim me:

- Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 òPër prokurimin publikò, i ndryshuar, neni 60, pika 1, e cila përcakton se: ò1. Kushtet e kontratës, të lidhur sipas këtij ligji, nuk ndryshojnë nga ato të përshkruara në dokumentet e tenderit dhe në ofertën fitueseò.

- Ligjin nr. 7850, datë 29.07.1994 òKodi Civil i Republikës së Shqipërisëò, neni 419, 420, neni 659, 698 dhe neni 690 në të cilin është shprehur ò.....Mos përmbushja e detyrimeve përkatëse sjell lindjen e përgjegjësisë juridiko-civile për palën mos përmbushëse, përgjegjësi e cila konkretizohet në detyrimin për ti shpërblyer palës/palëve të tjera shpërblyerimin e dëmit të pësuar në formën dëmit efektiv dhe fitimit të munguarò.

-Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 òPër menaxhimin financiar dhe kontrollinò, me ndryshimet vijuese të tij, neni 2 dhe neni 4, Ligjin nr. 25/2018, òPër kontabilitetin dhe pasqyrat financiareò, me ndryshimet vijuese të tij, neni 7,

-Udhëzimin e Ministrisë Financave nr. 30 datë 27.12.2011, òPër menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publikò, i ndryshuar me nr. 20, datë 17.11.2014 pika 35.

Për sa më sipër mban përgjegjësi A. M. me detyrë me detyrë ish-drejtores e Drejtorisë Tregtare.

Me urdhër transfertë datë 31.01.2020 nëpërmjet C. është likuiduar òShoqëria òAò Shpk për vlerën 106,560 lekë. Dokumenti justifikues faturë tatimore shitje me numër 1758, datë 03.12.2019 për vlerën 1,006,560 lekë, për 2,400 kg Hipoklorit Natriumi. Fletë hyrje nr. 46, datë

03.12.2019, duke cilësuar hipoklorit lëngë në emërtimin e mallit, ndërsa tek njësia kg 2400. Procesverbal dorëzimi datë 03.12.2019 i firmosur nga B. Zh., punonjës i stacionit të pompimit dhe për òAö L. Sh.

Çertifikatë origjine me logo òAö òCö shpk e firmosur nga Administratori N. Sh. Specifikat (raport analize dhe Skedë sigurie) për furnizimin e datë 03.12.2019, me logo òAö òCö shpk Korçë e firmosur nga Administratori i N. Sh., e pa firmosur nga kimisti/kimistja që ka bërë analizën Kjo faturë nuk shoqërohet me certifikatën e analizës nga Instituti i Shëndetit Publik, ose dëshmi të lëshuara nga autoritete/institucione/ente të autorizuar për lëshimin e tyre, për analize toksikologjike për NaOCl (hipoklorit natriumi) të marre brenda tre muajve të fundit nga data e zhvillimit të tenderit, referuar kërkesave për kualifikim pikës 2.3.3 të kapacitetit teknik (shtojcë datë 06.02.2020), për pasojë nuk mund të verifikohet zbatimi/ose jo i specifikimeve (shtojca 10 e dokumenteve të tenderit) Shtojca 6 òDeklaratë mbi përmbushjen e specifikimeve teknike nga operatori ekonomik dhe nenin 9/1 i kontratës òMallrat e furnizuara sipas kontratës duhet të jenë konformë kodeve dhe Standardeve Teknike të parashikuara në specifikimet teknike. Nëse gjatë ekzekutimit të kontratës, ka ndryshime në kodet përkatëse ose në Standardet Teknike, këto ndryshime do të zbatohen vetëm pas aprovimit nga Autoriteti Kontraktorë.

Për pasoj raportit i analizës specifikat (raport analize dhe skedë sigurie) nga laboratorit òAö òCö shpk Korçë, është dokument i pavlefshëm, pasi ky laborator nuk është i akredituar nga Drejtoria e Përgjithshme Kalibrimeve, veprim në kundërshtim me Ligjin nr. 116/2014 për akreditimin e organeve të vlerësimit të konformitetit në Republikën e Shqipërisë, i ndryshuar, neni 5, pika 1 dhe 4, Rekomandimin e Agjencisë së Prokurimit Publik nr. 3330 prot, datë 20.03.2018 dhe Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit nr. 145 prot, datë 16.03.2018.

Për posë sa mësipër, nuk ka gjurmë(dokumentacion) të kthimit nga litra në kg, referuar nivelit të depozitës së klorinit para furnizimit, mbas furnizimit dhe koficientët e përdorur për kthimin nga litra në kg.

Veprim në kundërshtim me:

- Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 òPër prokurimin publik, i ndryshuar, neni 60, pika 1, e cila përcakton se: ò1. Kushtet e kontratës, të lidhur sipas këtij ligji, nuk ndryshojnë nga ato të përshkruara në dokumentet e tenderit dhe në ofertën fituese.

- Ligjin nr. 7850, datë 29.07.1994 òKodi Civil i Republikës së Shqipërisë, neni 419, 420, neni 659, 698 dhe neni 690 në të cilin është shprehur ò.....Mos përmbushja e detyrimeve përkatëse sjell lindjen e përgjegjësisë juridiko-civile për palën mos përmbushëse, përgjegjësi e cila konkretizohet në detyrimin për ti shpërblyer palës/palëve të tjera shpërblyerim e dëmit të pësuar në formën dëmit efektiv dhe fitimit të munguar.

-Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 òPër menaxhimin financiar dhe kontrollin, me ndryshimet vijuese të tij, neni 2 dhe neni 4, Ligjin nr. 25/2018, òPër kontabilitetin dhe pasqyrat financiare, neni 7.

-Udhëzimin e Ministrisë Financave nr. 30 datë 27.12.2011, òPër menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik, i ndryshuar me nr. 20, datë 17.11.2014 pika 35.

Për sa mësipër mban përgjegjësi A. M. me detyrë me detyrë ish-drejtorë e Drejtorisë Tregtare.

Me urdhër transfertë datë 26.03.2020 dhe datë 28.04.2020 nëpërmjet C është likuiduar Shoqëria òAö Shpk respektivisht për vlerën 1,361,700 lekë dhe vlerën 186,900 lekë. Dokumenti justifikues faturë tatimore shitje me numër 423, datë 19.03.2020 për vlerën 1,361,700 lekë, për 25,500 kg hipoklorit natriumi dhe Faturë tatimore shitje me numër 424, datë 19.03.2020 për vlerën 186,900 lekë për 3,500 kg, e pa firmosur nga blerësi. Fletë hyrje nr. 12, datë 19.03.2020 duke cilësuar hipoklorit lëngë në emërtimin e mallit, ndërsa tek njësia 29,000 kg. Procesverbal të marrjes në dorëzim datë 19,03,2020 i firmosur nga M. R., A. M. ,K. C., dhe Y. A., ku është

cilësuar ÷Fatura 161, datë 21.04.2020, sasia 20,000 kg, sipas skedës teknike, çertifikatës së origjinës dhe skedë sigurie.

Çertifikatë origjine me logo ÷Aö ÷Cö shpk e firmosur nga Administratori N. Sh. Specifikat (raport analize dhe Skedë sigurie) për furnizimin e datë 19.03.2020, me logo ÷Aö ÷Cö shpk Korçë e firmosur nga Administratori N. Sh.. Këto fatura nuk shoqërohen me certifikatën e analizës nga Instituti i Shëndetit Publik, ose dëshmi të lëshuara nga autoritete/institucione/ente të autorizuar për lëshimin e tyre, për analize toksikologjike për NaOCl. (hipoklorit natriumi) të marre brenda tre muajve të fundit nga data e zhvillimit të tenderit, për pasoj nuk mund të verifikohet zbatimi/ose jo i specifikimeve (shtojca 10 e dokumenteve të tenderit) Shtojca 6 ÷Deklaratë mbi përmbushjen e specifikimeve teknike nga operatori ekonomik dhe nenin 9/1 i kontratës ÷Mallrat e furnizuara sipas kontratës duhet të jenë konformë kodeve dhe standardeve teknike të parashikuara në specifikimet teknike. Nëse gjatë ekzekutimit të kontratës, ka ndryshime në kodet përkatëse ose në standardet teknike, këto ndryshime do të zbatohen vetëm pas aprovimit nga Autoriteti Kontraktor.

Për pasoj raporti i analizë specifikat (fletë analize dhe Skedë sigurie) me logo nga laborator i ÷Aö ÷Cö shpk Korçë, është dokument i pavlefshëm, pasi ky laborator nuk është i akredituar nga Drejtoria e Përgjithshme Kalibrimeve, veprim në kundërshtim me Ligjin nr. 116/2014 ÷Për akreditimin e organeve të vlerësimit të konformitetit në Republikën e Shqipërisë, i ndryshuar, neni 5, pika 1 dhe 4, Rekomandimin e Agjencisë së Prokurimit Publik nr. 3330 prot, datë 20.03.2018 dhe Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit nr. 145 prot, datë 16.03.2018.

Për posë sa mësipër, nuk ka gjurmë(dokumentacion) të kthimit nga litra në kg, referuar nivelit të depozitës së klorinit para furnizimit, mbas furnizimit dhe koficientët e përdorur për kthimin nga litra në kg.

Veprim në kundërshtim me:

- Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 ÷Për prokurimin publik, i ndryshuar, neni 60, pika 1, e cila përcakton se: ÷1. Kushtet e kontratës, të lidhur sipas këtij ligji, nuk ndryshojnë nga ato të përshkruara në dokumentet e tenderit dhe në ofertën fituese.

Pasqyrat financiare janë hartuar nga përgjegjësi i sektorit të financës dhe miratuar nga Këshilli Administrativ me Vendimin nr. 10, datë 17.06.2020. Me urdhrin nr. 121, datë 26.12.2019 është ngritur grupi i punës për inventarizimin, në përbërje të cilit përsëri është edhe përgjegjësi i magazinës, në kundërshtim me paragrafin 99 të Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 për menaxhimin e aktiveve në NjSPö, i ndryshuar.

Pozicioni financiar i UK Elbasan për vitin 2019 paraqitet si vijon:

Pasqyra e aktiveve për vitin 2019.

Aktive afatshkurtra total	424,284,392
- Aktive monetare	84,092,528
- Të drejta të arkëtueshme	267,811,590
- Inventarët	72,380,274
Aktivet afatgjata total	2,242,252,539
- Toka dhe ndërtesa	222,204,550
- Impiante dhe makineri	1,990,393,119
- Të tjera instalime dhe pajisje	29,654,870
- Parapagime për aktive materiale dhe në proces	0
Aktivet total	2,666,536,931

Burimi i të dhënave: UK Elbasan sha.

Nga auditimi rezultoi se llogaria Të drejta të arkëtueshme në bilanc në vlerën totale 267,11,590 lekë, përbëhet nga të drejta të arkëtueshme nga aktiviteti i shfrytëzimit llogaria 411 në vlerën 520,672,089 lekë, nga zhvlerësimi i mallrave, produkteve, klientëve në vlerën -285,929,652 lekë dhe nga të tjera kërkesa për të arkëtuar llogaria 467 në vlerën 33,069,153 lekë, vlera të cilat po të ishin marrë masa konkrete për arkëtimin e tyre, do arrihej të mbulohej një pjesë e vlerës së detyrimeve. Ky zë është rënduar kryesisht nga mos vjelja e detyrimeve nga debitorët për furnizim me ujë, pasi llogaria debitorë të tjerë nuk ka pësuar ndryshime për këtë vit.

Inventari

Është kryer inventarizimi fizik i materialeve në datën 31.12.2019.

Në këtë zë janë përfshirë materialet ndihmëse dhe lënda djegëse, balanca e së cilave më 31 dhjetor 2019 paraqitet:

-Lëndë e parë dhe material të tjera 70,159,119 lekë
 -Materiale ndihmëse dhe lëndë djegëse 214,664 lekë

-Inventar i imët	946,717 lekë
-Mallra	1,059,775 lekë

Totali i inventarit është: 72,380,274 lekë.

Nuk janë konstatuar mallra stoqe dhe me qarkullim të ngadalshëm, dhe shoqëria nuk ka llogaritur zhvlerësim të tyre.

Pasqyra e detyrimeve për vitin 2019.

Detyrimet afatshkurtra total	395,608,579
- Të pagueshme për aktivitetin e shfrytëzimit	337,847,811
- Të pagueshme ndaj punonjësve dhe sigurimeve shoqërore	3,534,860
- Tatim të Ardhura nga Punësimi	427,698
- TVSH	379,010
- Tatimi në burim	19,695
- Tatime të tjera për t'u paguar	27,822,094
- Të ardhura të shtyra	25,577,411
Detyrimet afatgjata total	485,752,465
- Të ardhura të shtyra	485,752,465
Kapitali total	881,361,044

Burimi i të dhënave: UK Elbasan sha.

Në zërin detyrime afatshkurtra në vlerën totale prej 395,608,579 lekë, ndër të tjera Ujësjiellës Kanalizime Elbasan ka shtuar përsëri detyrime të prapambetura kryesisht nga mos likuidimi i energjisë elektrike, ku është mbartur një pjesë edhe nga fshatrat që nga momenti i bashkimit të UKE sha të fshatit me qytetin. Deri më 31 dhjetor 2019, shpenzimet e energjisë elektrike zënë një shumë të konsiderueshme në shpenzime në vlerën 140,974,243 lekë. Përsëri edhe për këtë vit, këto detyrime të akumuluar që nga viti 2018 (viti i bashkimit të tyre), duhej të kontabilizoheshin në zërin detyrime afatgjata. Ndërsa detyrimet afatgjata totale përbëhen vetëm nga të ardhura të shtyra, që na rezultojnë në vlerën 485,752,465 lekë.

Pasqyra e performancës për vitin 2019.

- Të ardhura nga aktiviteti i shfrytëzimit	344,204,079
- Puna e kryer nga njësia ekonomike dhe e kapitalizuar	2,751,945
- Të ardhura të tjera të shfrytëzimit	15,741,431
Të ardhura total	383,471,484
- Lënda e parë dhe materiale të konsumueshme	-13,604,730
- Të tjera shpenzime (Energji elektrike)	-140,974,243
- Blerje/Shpenzime mallrash, shërbimesh	-33,715,974
- Shpenzime të personelit	-179,380,522
- Zhvlerësimi i aktiveve afatgjata material	-97,170,768
- Shpenzime konsumi dhe amortizimi provigjone	-26,212,612
- Tatime dhe taksa vendore	-5,317,745
- Shpenzime të tjera të veçanta korrente shpërblimi pensi	-463,000
- Të ardhura nga subvencionimi me faturë	8,322,500
- Të ardhura nga aktivet pa pagesë Grante matësa uji	12,448,524
- Të ardhura nga interesi	3,005
Totali i shpenzimeve	-496,839,594
- Shpenzime të tjera financiare paga shpenzime përmbarimore	-4,918,880
- Shpenzime të tjera shfrytëzimi: gjopa nga tatimet	-6,271,074
Fitimi/humbja para tatimit	-124,558,064

Burimi i të dhënave: UK Elbasan sha.

Sa i takon pasqyrës së performancës, Shoqëria ka gjeneruar të ardhura nga aktiviteti i shfrytëzimit, pasqyruar në vlerën 344,204,079 lekë, ndërkohë që nga evidenca e arkëtimeve për periudhën rezulton se vlera e të ardhurave është 357,368,486 lekë dhe nuk është pasqyruar saktë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Të ardhura nga aktiviteti i shfrytëzimit përbëhet nga: Të ardhura nga shitja e ujit në vlerën 339,625,606 lekë, vendosje matësi në vlerën 803,871 lekë, lidhje/rilidhje uji në vlerën 2,218,100 lekë, klientë për tarifa në vlerën 436,000 lekë, miratim plan vendosje në vlerën 457,833 lekë dhe klientë për prerje/rilidhje në vlerën 662,669 lekë.

Ndërkohë shpenzimet në total janë pasqyruar në vlerën 496,839,594 lekë, ku në zërin shpenzime të tjera shfrytëzimi, me rreth 25% të vlerës e zënë shpenzimet për energji elektrike për funksionimin e sistemit të pompave të ujësjellësit në vlerën 140,974,243 lekë dhe llogaria shpenzime të personelit në vlerën 179,380,522 lekë me rreth 34% të vlerës totale. Në fund të periudhës, shoqëria rezulton me një performancë negative financiare në vlerën 124,558,064 lekë.

Fatura të prapambetura të energjisë

Sipas akt-rakordimit datë 23.07.2021, palët nënshkruese të Furnizuesit të Shërbimit Universal sha (O) përfaqësuar nga M. Xh. dhe Ujësjellës Kanalizime Elbasan sha përfaqësuar nga A. M. bien dakord për detyrimet totale të energjisë elektrike që klienti ka ndaj F sha, për periudhën Janar 2017 deri në Qershor 2021 janë:

- Pricipali është në vlerën 394,006,272 lekë.
- Kamatë-vonesat janë në vlerën 312,970,421 lekë.
- Vlera totale e detyrimit ndaj F sha (O) është në vlerën 706,976,693 lekë.

Në bazë të shkresës së Ujësjellës Kanalizime Elbasan sha me nr. 2308 prot., datë 03.08.2021, òLetër angazhimiò ndaj Përmbauesit B. Sh. dhe për dijeni të F sha, se UKE sha do të marrë përsipër që të paguajë çdo datë 5 të muajit pasardhës dhe deri në përfundim të detyrimit prej 130,620,708.53 lekë të shlyejë ç muaj detyrimet e prapambetura të akumuluarua ndër vite si dhe duke pranuar dhe përgjegjësitë, të cilat rrjedhin nga mos shlyerja e këtyre detyrimeve.

Duke qenë se fshatrat kishin shumë debi në lidhje me faturat e papaguara të energjisë elektrike ndaj F sha (O) deri në vitin 2018 përpara bashkimit të fshatrave me qytetin, u bë një ristrukturim i vlerës së debisë. Kjo ndodhi pasi Shoqëria çua në përmbaerim, ku më pas iu bllokuan të gjitha llogaritë bankare.

Vlera e debisë ndaj F sha deri më sot është 139,496,795 lekë, plus 177,517,015 lekë që është vlera e debisë së mbartur nga Ujësjellësi Fshat. Rakordimi i fundit me F sha është i datës 23.07.2021.

Shuma e marrë nga përmbaerimi është si më poshtë:

Banka	Data	Vlera/Lekë
X	26.07.2021	23,995,361
U	11.08.2021	11,934,000
Y	06.08.2021	994,785
C	06.08.2021	990,000
H	03.08.2021	3,494,331
P	03.08.2021	2,460,005
		43,868,482

Burimi i të dhënave: UK Elbasan sha.

Për vitin 2020:

Pozicioni financiar i UK Elbasan për vitin 2020 paraqitet si vijon:

Pasqyra e aktiveve për vitin 2020.

Aktive afatshkurtra total	463,878,882
- Inventari	117,834,435
- Të tjera të arkëtueshme	38,598,152
- Llogari të arkëtueshme	238,565,050
- Mjete monetare dhe ekuivalentë	68,881,245
Aktivet afatgjata total	2,229,025,309
- Aktive afatgjata materiale	2,229,025,309
Aktivet total	2,692,904,191

Burimi i të dhënave: UK Elbasan sha.

Totali i aktiveve afatshkurtra për vitin 2020 është në vlerën 463,878,882 lekë. Ndërsa totali i aktiveve afatgjata është në vlerën 2,229,025,309. Në total aktivet janë në vlerën 2,692,904,191 lekë.

Inventari

Është kryer inventarizimi fizik i materialeve në datën 31.12.2020.

Në këtë zë janë përfshirë materialet ndihmëse dhe lënda djegëse, balanca e së cilave më 31 dhjetor 2020 paraqitet:

-Lëndë e parë dhe material të tjera	78,395,840 lekë
-Materiale ndihmëse dhe lëndë djegëse	37,644,850 lekë
-Inventar i imët	946,717 lekë
-Mallra	847,028 lekë

Totali i inventarit është: 117,834,435 lekë

Pasqyra e detyrimeve për vitin 2019.

Detyrimet afatshkurtra total	433,685,566
- Llogari të pagueshme dhe të tjera të pagueshme	433,411,680
- Grante dhe të ardhura të shtyra	273,886
Detyrimet afatgjata total	598,010,327
- Grante dhe të ardhura të shtyra	598,010,327
Kapitali total	1,031,695,893

Burimi i të dhënave: UK Elbasan sha.

Në zërin detyrime afatshkurtra në vlerën totale prej 433,411,680 lekë, ndër të tjera Shoqëria ka shtuar përsëri detyrime të prapambetura kryesisht nga mos likuidimi i energjisë elektrike, ku është mbartur një pjesë edhe nga fshatrat që nga momenti i bashkimit të UKE sha të fshatit me qytetin. Ndërsa detyrimet afatgjata totale përbëhen vetëm nga të ardhura të shtyra, që na rezultojnë në vlerën 598,010,327 lekë.

Tabelë

- Të ardhura nga shitja	346,262,421
- Puna e kryer nga njësia ekonomike dhe e kapitalizuar	2,292,546
- Të ardhura të tjera operative	16,624,276
- Lënda e parë dhe materiale të konsumueshme	-21,463,961
- Shpenzime energjie elektrike	-119,501,512
- Shpenzime të tjera operative	-50,093,898
- Shpenzime personeli	-184,669,447
- Shpenzime amortizimi	-118,265,706
- Zhvlerësimi i llogarive të arkëtueshme	-28,239,759
Humbje nga veprimtaritë e shfrytëzimit	-157,055,040
- Të ardhura nga grantet dhe subvencionet	33,909,816
- Të ardhura nga interesat	1,509

Humbje para fitimit	-123,143,715
- Tatimi mbi fitimin	-
Humbje neto e vitit financiar	-123,143,715
Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse	1,762,605
- Të ardhura nga rimarrja e rezervës së rivlerësimit	1,762,605
Totali i të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse	1,762,605
Totali i të ardhurave gjithëpërfshirëse	-121,381,110

Burimi i të dhënave: UK Elbasan sha.

Siç pasqyrohet në tabelën e mësipëre humbjet nga veprimtaritë e shfrytëzimit janë në vlerën - 157,055,040 lekë. Ndërsa humbjet para fitimit janë në vlerën -123,143,715 lekë. Humbjet neto të vitit financiar janë në vlerën -12,143,715 lekë. Ndërsa totali të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse është -121,381,110 lekë.

- Pasqyrat financiare të vitit ushtrimor 2021, nuk u audituan pasi deri më datë 11.05.2022, datë në të cilën përfundoj auditimi, nuk janë miratuar nga Asambleja e Përgjithshme.

1. Titulli i gjetjes:	Nuk është kryer inventari fizik i aktiveve dhe mbajtja në një regjistër të tyre
Situata:	Nuk është kryer inventari fizik i aktiveve, por vetëm inventari i imët, pajisje zyre dhe ai ekonomik. -Gjatë investimeve në linja e kanalizime të reja, dhe impiante, nga shoqëria nuk janë evidentuar linjat e vjetra të cilat kanë dalë jashtë përdorimit për të kontabilizuar si shpenzimin për vlerën kontabël të mbetur.
Kriteri:	Ligji nr. 25, datë 10.05.2018 òPër kontabilitetin dhe pasqyrat financiareò, neni 15, pika 1 dhe 2. Udhëzimi i MF nr. 30, datë 27.12.2011 òPër menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publikò, i ndryshuar, KREU III, pika 30 dhe 85/c.
Ndikimi/Efekti:	Risk për keq menaxhim të aktiveve.
Shkaku:	Keq interpretim i akteve nën ligjore dhe rregullatore.
Rëndësia:	E Lartë
Rekomandimi:	Nga Administratori i Shoqërisë dhe Drejtoria Tregtare të merren masa për të kryer inventarin fizik të aktiveve të shoqërisë, të evidentohen linjat e vjetra të cilat kanë dalë jashtë përdorimit, si dhe të mbahet regjistri i aktiveve.

2. Titulli i gjetjes:	Në certifikimin e pasqyrave financiare të vitit 2019 dhe 2020 nuk ka gjetur zbatim SNK 250.
Situata:	Në certifikimin e pasqyrave financiare të vitit 2019 dhe 2020, nga ekspertët kontabël të kontraktuar: a. Nuk ka zbatim të SNK 250, i rishikuar òMbajtja parasysh e ligjeve dhe rregullave në një auditim të pasqyrave financiareò për auditim ligjshmërie dhe përputhshmërie nga ekspertët kontabël. b. Nuk ka dokumentacion përkatës që vërteton punën e kryer të ekspertëve, psh krahasimi i programit me faktin e realizuar dhe kush e ka konfirmuar situacion e punës së kryer prej tyre.
Kriteri:	SNK 250, i rishikuar òMbajtja parasysh e ligjeve dhe rregullave në një auditim të pasqyrave financiareò.
Ndikimi/Efekti:	Risk në keq menaxhim të aktivitetit ekonomiko-financiar

Shkaku:	Keq interpretim i standarteve të kontabilitetit
Rëndësia:	E Mesme
Rekomandimi:	Nga Organet e Shoqërisë t'i kushtohet vëmendje e duhur institucionale procesit të emërimit dhe kontraktimit të ekspertëve kontabël.

3. Titulli i gjetjes:	Mos regjistrim të asetet në Drejtorinë Vendore të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Elbasan.
Situata:	Nga auditimi u konstatua se nga Shoqëria ÷Ujës-jellës Kanalizime Elbasanë S HA, asetet nuk janë regjistruar në Drejtorinë Vendore të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Elbasan.
Kriteri:	Ligjin nr. 111/2018 ÷Për Kadastrën, i ndryshuar, neni 3, pika 2.
Ndikimi/Efekti:	Risk për mosadministrim të asetëve.
Shkaku:	Keq interpretim i dispozitave ligjore që kanë të bëjnë me administrimin e asetëve.
Rëndësia:	E lartë
Rekomandimi:	Nga Shoqëria ÷Ujës-jellës Kanalizime Elbasanë SHA të zbatohen procedurat ligjore, për të regjistruar në Drejtorinë Vendore të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Elbasan, të gjitha objektet që janë regjistruar në ÷Zërin trojeë në kontabilitet

4. Titulli i gjetjes:	Mos publikim në faqen zyrtare të Shoqërisë të pasqyrave financiare vjetore
Situata:	Në faqen zyrtare të Shoqërisë nuk është bërë publikimi i pasqyrave financiare vjetore, raporti i ecurisë së veprimtarisë, raporti i auditimit, në rastet kur përgatitja e këtyre dokumenteve është e detyrueshme. Kjo situatë ka ardhur dhe si pasojë e një rregulloreje jo shumë të plotë për funksionimin e shoqërisë.
Kriteri:	Ligjin nr. 25, datë 10.05.2018 ÷Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare, neni 22, pika 2.
Ndikimi/Efekti:	Mos transparencë
Shkaku:	Keq interpretim i akteve nënligjore dhe rregullatore
Rëndësia:	E Lartë
Rekomandimi:	Nga organet drejtuese të shoqërisë të merren masa për të publikuar në faqen zyrtare të Shoqërisë të pasqyrave financiare vjetore, raporti i ecurisë së veprimtarisë, si dhe raporti i auditimit.

5. Titulli i gjetjes:	Kontabilizim ekstra kontabël i aktiveve dhe inventarit ekonomik, dhe mos kontabilizim zë për zë por në vlerë totale.
Situata:	Në pasqyrat financiare të vitit 2020 në llogarinë 21271 ÷Rrjeti i shpërndarjes së ujit ndërtimeë paraqitet në vlerën 50,492,139 lekë, dhe llogaria 2181 ÷Mobilje dhe pajisje zyreë , paraqitet në vlerën 16,122,898 lekë, që kanë të bëjnë me kontratën ÷Financim, instalim dhe realizim punimesh civile, sistemi, matje Wirelessë. Llogaria 2317 ÷A në proces Rrjeti i shpërndarjesë është në vlerën 68,770,000 lekë pa TVSH. Kontabilizimet e mësipërme janë kryer në vlerë totale dhe nuk janë zë për zë referuar situacioneve respektive.

Kriteri:	Ligji nr. 25, datë 10.05.2018 për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare, neni 3, pika 14, neni 7 pika 2, neni 25, pika 1 dhe 2.
Ndikimi/Efekti:	Të dhënat e kontabilitetit nuk përputhen me bilancin
Shkaku:	Mos vëmendje e duhur institucionale
Rëndësia:	E Lartë
Rekomandimi:	Nga Administratori i shoqërisë të merren masa për të kryer inventarizimin fizik, rivlerësimin, klasifikimin inventar ekonomik apo aktive dhe kontabilizimin zë për zë.

2.7. Mbi zbatimin e ligjshmërie në prokurimet e fondeve publike dhe ankandet, lidhjen dhe zbatimin e kontratave.

Auditimi u krye me zgjedhje³.

Informacion i përgjithshëm:

Për vitin 2019, janë zhvilluar 24 procedura prokurimi me vlerë 157,079 mijë lekë.

Për vitin 2020, janë zhvilluar 18 procedura prokurimi me vlerë 188,249 mijë lekë.

Për vitin 2021, janë zhvilluar 15 procedura prokurimi me vlerë 239,942 mijë lekë,

Në total për periudhën objekt auditimi janë zhvilluar 60 procedura me vlerë 585,270 mijë lekë.

Janë audituar 8 procedura për vlerën 360,889 lekë, ose 60 % e vlerës së procedurave të zhvilluara.

Viti 2019:

000/lekë

Nr	Procedura	Nr I procedurave	Fondi limit	Vlera e kontrates	Diferenca	
					Vlere	%
1	Procedura e hapur	4	117,889	115,179	2,710	2.30
2	Procedura Kerkese per propozim	7	26,663	25,355	1,308	4.91
3	Procedura Negocim pa shpallje	3	8,200	7,969	231	2.82
4	Procedura Blerje e vogel	10	4,327	3,041	1,286	29.72
	Shuma	24	157,079	151,544	5,535	3.52

Burimi: UK Elbasan.

Viti 2020:

000/lekë

Nr	Procedura	Nr I procedurave	Fondi limit	Vlera e kontrates	Diferenca	
					Vlere	%
1	Procedura e hapur	3	164,319	156,884	7,435	4.52
2	Procedura Kerkese per propozim	8	20,249	18,168	2,081	10.28

³ Auditimi me zgjedhje zhvillohet sipas ISA 530 (i rishikuar) "Kampioni i auditimit", i cili tregon tipet e ndryshme të testeve që audituesi kryen.

Përkuftizimi i një kampioni të zgjedhur për auditim sipas ISA 530 është: "Aplikimi i procedurave të auditimit në më pak se 100% të artikujve brenda një grupi të caktuar të transaksioneve ose llogarive kontabël etj, në atë mënyrë që të gjithë kampionët të kenë të njëjtin shans për tu zgjedhur"

3	Procedure Negocim pa shpallje	1	586	586	0	0.00
4	Procedure Blerje e vogel	6	3,095	2,555	540	17.45
	Shuma	18	188,249	178,193	10,056	5.34

Burimi: UK Elbasan.

Viti 2021:

000/lekë

Nr	Procedura	Nr I procedurave	Fondi limit	Vlera e kontrates	Diferenca	
					Vlere	%
1	Procedure e hapur	4	217,006	213,982	3,024	1.39
2	Procedure e hapur e thjeshtuar	4	13,702	12,548	1,154	8.42
3	Procedure Kerkese per propozim	1	1,400	878	522	37.29
4	Procedure Negocim pa shpallje	1	5,286	5,076	210	3.97
5	Procedure Blerje e vogel	5	2,548	1,979	569	22.33
	Shuma	15	239,942	234,463	5,479	2.28

Burimi: UK Elbasan.

Në procedurat e audituara, nga dokumentacioni i vënë në dispozicion, si dhe aksesimi në sistemin e prokurimit elektronik (S.P.E.) të A.P.P, u konstatua se përgjithësisht është zbatuar Ligji nr. 9643, datë 20.11.2006 òPër prokurimin publikò, me ndryshimet vijuese të tij, VKM nr. 914, datë 29.12.2014 òRregullat e Prokurimitò, me ndryshimet vijuese të tij, si dhe aktet nënligjore në funksion të tyre, në lidhje me përzgjedhjen e procedurave të prokurimit, llogaritjen e fondit limit, argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kërkesave për kualifikim, kualifikimin, shpalljen fitues të operatorëve ekonomik, si dhe lidhjen dhe zbatimin e kontratave.

Pavarësisht nga sa u citua më sipër u konstatuan dhe shkelje dhe parregullsi ligjore ose rregullatore, të cilat në mënyrë të detajuar për çdo procedurë prokurimi paraqiten si më poshtë vijon:

1. Procedura e prokurimit me objekt "Hipoklorit natriumi, viti 2020-2021.

1. Urdhër Prokurimi nr. 12 datë 16.01.2020	3. Njësia e prokurimit Urdhër nr. 74 prot. datë 16.01.2020 - J. D., me detyrë Drejtor Teknik - A. M., me detyrë Drejtor Tregtar - I. S., me detyrë Juriste	4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave Urdhër nr. 74/1 datë 16.01.2020 - G. P., me detyrë Ing. Investimesh - N. H., me detyrë Përgjegjëse Finance - E. D., me detyrë Juriste
2. Lloji i Procedurës së Prokurimit òProcedurë e hapurò (mallra) Marrëveshje kuadër		
5. Fondi Limit (pa tvsh) 14,248,000 lekë	6. Oferta fituese (pa tvsh) 13,884,000 lekë	7. Diferenca me fondin limit (pa tvsh) 364,000 (treqind e gjashtëdhjetë e katër mijë) lekë
8. Data e hapjes së tenderit 14.02.2020	9. Burimi Financimit Fond nga Buxheti i Shtetit	10. Operatorët Ekonomike a) Pjesëmarrës në tender Numër _2_OE b) Sëkualifikuar 1 OE,

		c) Kualifikuar ___I__ OE
11. Ankimime Pranë AK - nuk ka	12. Përgjigje Ankesës nga AK - nuk ka	13. Përgjigje Ankesës nga Komisioni i Prokurimit Publik - nuk ka
b. Zbatimi i Kontratës të Mallrave		
14. Lidhja e kontratës nr. 74/10, datë 20.03.2020	15. Vlera e kontratës (me tvsh) 4,620,000 lekë	16. Afati i kontratës në dite 20.03.2020 deri në 30.11.2020
nr.74/12, datë 10.09.2020	2,349,600 lekë	10.09.2020 deri në 31.12.2020
nr.74/15, datë 08.02.2021	6,141,000 lekë	08.02.2021 deri në 31.12.2021
nr.74/17 datë 08.02.2021	3,550,192.2 lekë	18.03.2022 deri në tërheqjen e gjithë sasisë

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion, si dhe aksesimit në sistemin e prokurimit elektronik (S.P.E.) të A.P.P, u konstatua se:

Fondi i këtij i këtij shpenzimi është akorduar nga të ardhurat e shoqërisë me vlerë 14,248,000 lekë.

Kjo procedurë është parashikuar në regjistrin e parashikimeve të prokurimeve publike të Shoqërisë ÷Ujësjellës Kanalizime Elbasanë Sh.a.

Me kërkesë të L. D. me detyrë Drejtore e Drejtorisë teknike, ka bërë kërkesë për blerje hipoklorit natriumi për periudhën viti 2020 dhe dy muajt e pare te vitit 2021 me sasi 312,000 kg.

Me urdhër të Administratorit të Shoqërisë L. D. nr. 12, datë 16.01.2020, është urdhëruar të kryhet prokurimi elektronik në vlerën 14,248,000 lekë, forma e prokurimit, prokurimi në mënyrë elektronike, lloji i procedurës së prokurimit ÷Procedurë e hapurë mallra, marrëveshje kuadër.

Njësia e prokurimi e përbërë nga J. D. me detyrë drejtor teknik, me profesion ing hidro, A. M. me detyrë drejtor tregtar me profesion ekonomiste, dhe I. S. me detyrë juriste me profesion juriste.

Me urdhër të Administratorit të Shoqërisë L. D. nr. 3, datë 04.01.2019, është ngritur grupi i punës për argumentin e fondit limit, i përbërë nga M. T., A. K., M. R., E. B., A. N.

Me procesverbal të protokolluar datë 14.01.2020, grupi i përllogaritjes së fondit limit i përbërë nga M. T., A. K., M. R., E. B., A. N. ka përcaktuar vlerën 14,248,000 lekë pa TVSH.

Pra, përllogaritja e vlerës së kontratës është përcaktuar në vlerën 14,248,000 lekë, duke cilësuar në preventiv hipoklorit natriumi 13-15%, sasia 312,000 kg x 45.7 lekë/kg = 14,248,000 leke për vitin 2020-2021. Në fakt përllogaritja është gabim matematikor, pasi vlera duhet 14,258,400 dhe jo 14,248,000 (312,000 kg x 45.7 = 14,258,400).

Pra, përllogaritja e vlerës së kontratës është përcaktuar në vlerën 14,248,000 lekë, pas ofertës të ofruar nga operatorët ÷Aö Shpk në vlerën 40 lekë, hipoklorit natriumi 13-15%, ÷Kö Shpk në vlerën 50 lekë.

- Ka një kontradikcion tek përllogaritja e vlerës së kontratës tek shoqëria ÷Aö Shpk, ne ofertën për procedurën e prokurimit 312,000 kg x 44.5 lekë/kg = 13,884,000 lekë, ndërsa në ofertën e paraqitur për përllogaritjen e vlerës së kontratës 312,000 kg x 40 lekë/kg = 12,488,000 lekë, me diferenca 1,404,000 lekë (13,884,000 - 12,488,000 = 1,404,000).

Në fakt vlera e përllogaritur e kontratës, referuar mesatares së çmimit duhet të ishte 312,000 kg x 45 lekë/kg = 14,040,000 lekë. Me diferencë **218,400 lekë** (12,488,000 - 14,040,000 = 218,400). Vlera 45 lekë/kg dhe (40 + 50 = 90 : 2 = 45).

Veprim në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 ÷Për miratimin e rregullave të prokurimit publik, i ndryshuar, neni 59, pika 2 ku është shprehur në mënyrë eksplicite se ÷Në përllogaritjen e vlerës limit të kontratës, autoriteti kontraktor duhet të referohet një ose më shumë alternativave të renditura si mëposhtë: Çmimet e botuara nga Instituti i Statistikave

(INSTAT), ose/dhe çmime të tjera zyrtare, të njohura nga institucionet përkatëse (si për shembull, nga organet tatimore a doganore, dhomat e tregtisë, në manuale etj);ose/dhe

a) çmimet e tregut;ose/dhe

b) çmimet e kontratave të mëparshme, të realizuara nga vetë apo nga autoritete të tjera kontraktore;ose/dhe

ç) çmimet ndërkombëtare, të shpallura publikisht.

Autoriteti kontraktor, përpara nxjerrjes së urdhrimit të prokurimit, duhet të argumentojë dhe të dokumentojë përllogaritjen e vlerës së kontratës, bazuar në specifikimet teknike të objektit që prokurohet.

Si konkluzion, përllogaritja e vlerës së kontratës është bërë duke u mbështetur në çmimet e tregut, por nuk është dhënë asnjë argumentim përse nuk është i është referuar edhe alternativave të tjera, si çmimet e kontratave të realizuara nga autoritete të tjera kontraktore, ose/dhe çmime të tjera zyrtare, të njohura nga institucionet përkatëse (si për shembull, nga organet tatimore a doganore, i UK te tjera) veprim në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 òPër miratimin e rregullave të prokurimit publikò, i ndryshuar, neni 59, pika 2.

Për sa trajtuar si më sipër ngarkohet me përgjegjësi grupi i llogaritjes së vlerës së kontratës i përbërë nga Majlinda Tafani, A. K., M. R., E. B., A. N.

Me urdher të Administratorit të Shoqërisë L. D. nr. 12/1, datë 16.01.2020, është ngritur komisioni i vlerësimit të ofertave i përbërë nga G. P. me detyrë inxhinier investimesh, me profesion hidro, N. H. me detyrë përgjegjëse finance me profesion ekonomiste dhe E. D. me detyrë juriste. Komisioni nuk ka në përbërje specialistë të fushës VKM nr. 914, datë 29.12.2014 òPër miratimin e rregullave të prokurimit publikò, me ndryshimet vijuese të tij neni 58, çka ngarkon me përgjegjësi L. D., me detyrë ish-administrator, në cilësinë e Titullarin Të Autoritetit Kontraktor.

Data e publikimit është 17.01.2020, afati për dorëzim të ofertave data 10.02.2020 ora 12.00.

Me ndryshimin e dokumenteve të tenderit (Specifikimeve teknike), shtojca e publikuar më datë 06.02.2020, nuk është bërë shtyrja e afatit kohor për dorëzimin e ofertave me 5 ditë, por është lënë i njëjti afat i dorëzimit të ofertave data 14.02.2020 ora 12.00, me diferencë një ditë, veprim në kundërshtim me neni 42, pika 2/1 e Ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 òPër prokurimin publikò, me ndryshimet vijuese të tij.

- Hartimi i kërkesave të veçanta për kualifikim/specifikimet teknike.

Nuk ka një dokument shkresor (procesverbal etj) të njësisë së prokurimit e përbërë nga të firmosur nga njësia e prokurimit e përbërë nga J. D., A. M. dhe I. S., ku të jenë miratuar dokumentet e tenderimit (D.T.) dhe në veçanti nuk ka një dokument shkresor ku të jenë përcaktuar kriteret e vlerësimit, edhe pse në S.P.E . Konkretisht, në nenin 61, pika 1, të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 òPër miratimin e rregullave të prokurimit publikò, me ndryshimet vijuese të tij, parashikohet se: Dokumentet e tenderit hartohen nga njësia e prokurimit në përputhje më këto rregulla dhe me legjislacionin në fuqi, ndërsa në pikën 2 të këtij neni parashikohet se: Seti i dokumenteve të tenderit firmoset në çdo faqe nga njësia e prokurimit.

Konkretisht, në nenin 61, pika 2, të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 òPër miratimin e rregullave të prokurimit publikò, me ndryshimet vijuese të tij, parashikohet se: "Hartimi i kërkesave të veçanta për kualifikim, që lidhen me kapacitetin teknik, specifikimet teknike, kriteret e vlerësimit (nëse është rasti) dhe çdo informacion tjetër specifik i nevojshëm bëhen nga specialisti i fushës, anëtar i njësisë së prokurimit. Në çdo rast, hartimi i tyre duhet të argumentohet teknikisht dhe ligjërish, si dhe të dokumentohet në një procesverbal të mbajtur nga personat e ngarkuar për përgatitjen e tyre. Ky procesverbal i vihet në dispozicion personit/ave përgjegjës për prokurimin, i cili/të cilët e bën/bëjnë pjesë të dosjes së tenderit".

Zhvillimi i procedurë së prokurimit.

Në këtë procedurë prokurimi kanë marr pjesë operatorët ekonomik.

- ðAö me ofertë në vlerën 13,884,000 lekë.

- ðAö shpk me ofertë në vlerën 0 lekë.

Pas vlerësimit të KVO u kualifikua dhe shpall fitues operatori ekonomik ðAö Shpk, me ofertë në vlerën 13,884,000 lekë, duke u skualifikuar operatori ekonomik ðAö shpk me ofertë në vlerën 0 lekë.

Në pikën 2.3.4 ðKapaciteti teknikö është përcaktuar të kapacitetit teknik kërkohet: Ofertuesi duhet të vërtetojë se produkti që do të furnizohet është i përshtatshëm në trajtimin e ujit të destinuar për konsum njerëzor, konform normave europiane: **EN 901:2013**. Për këtë qëllim duhet të paraqitet si dokument kualifikues dokumentacion nga prodhuesi, ose nga Distributori i Autorizuar nga Prodhuesi, që dëshmon që produkti i prodhuar plotëson Standartin European të kërkuar EN 901:2013ö ose **ekuivalente me te** dokument që plotëson standartin shqiptar **S SH/EN 901:2013** mbi parametrat e hipokloritit të natriumit.

Ky operator nuk provohet ta ketë përmbushur këtë kërkesë, pasi nuk e ka paraqitur ISO EN 901:2013 ose ekuivalente me te dokument që plotëson standartin shqiptar S SH/EN 901:2013 në dokumentet e dorëzuara.

Por pas çdo furnizimi me klor operatori ekonomik ðAö ka paraqitur certifikatë e origjinë me logo ðAö ðCö shpk e firmosur nga Administratori N. Sh. Specifikat (raport analize dhe Skedë sigurie) për furnizimin e datë 03.12.2019, me logo ðAö ðCö shpk Korçë e firmosur nga Administratori i N. Sh., e pa firmosur nga kimisti/kimistja që ka bërë analizën faturat nuk shoqërohen me certifikatën e analizës nga Instituti i Shëndetit Publik, ose dëshmi të lëshuara nga autoritete/institucione/ente të autorizuara për lëshimin e tyre, për analize toksikologjike për NaOCl (hipoklorit natriumi) të marre brenda tre muajve të fundit nga data e zhvillimit të tenderit, referuar kërkesave për kualifikim pikës 2.3.3 të kapacitetit teknik (shtojcë datë 06.02.2020), për pasojë nuk mund të verifikohet zbatimi/ose jo i specifikimeve (shtojca 10 e dokumenteve të tenderit) Shtojca 6 ðDeklaratë mbi përmbushjen e specifikimeve teknike nga operatori ekonomik dhe nenin 9/1 i kontratës ðMallrat e furnizuara sipas kontratës duhet të jenë konform kodeve dhe standardeve teknike të parashikuara në specifikimet teknike. Nëse gjatë ekzekutimit të kontratës, ka ndryshime në kodet përkatëse ose në standardet teknike, këto ndryshime do të zbatohen vetëm pas aprovimit nga Autoriteti Kontraktorö.

Për pasoj raportit i analizës specifikat (raport analize dhe Skedë sigurie) me nga laboratorit ðAö ðCö shpk Korçë, është dokument i pavlefshëm, pasi ky laborator nuk është i akredituar nga Drejtoria e Përgjithshme Kalibrimeve, veprim në kundërshtim me Ligjin nr. 116/2014 për akreditimin e organeve të vlerësimit të konformitetit në Republikën e Shqipërisë, i ndryshuar, neni 5, pika 1 dhe 4, Rekomandimin e Agjencisë së Prokurimit Publik nr. 3330 prot, datë 20.03.2018 dhe Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit nr. 145 prot, datë 16.03.2018.

Raporti përmbledhës nga komisioni i vlerësimit është hartuar me nr. 74/6 prot., datë 20.02.2020, raport i cili është miratuar nga Titullari i Autoritetit Kontraktor, ku ka shpallur fitues operatorin ekonomik ðAö Shpk, me ofertë ekonomike 13,884,000 pa TVSH .

Titullari i Autoritetit Kontraktor me vendimin nr.74/1 prot. Datë 02.03.2020 ka vendosur shpalljen fitues të operatorin ekonomik ðAö Shpk me çmim njësi pa tvsh 44,5 lekë.

Me shkresën nr.74/8 datë 12.03.2020 Formular i Njoftimit të Fituesit.

Marrëveshja kuadër është lidhur me nr. 74/9 prot., datë 20.03.2020, ndërmjet Shoqërisë Ujësjetës Kanalizime Elbasan sha të përfaqësuar nga L. D. në cilësinë e Administratorit të shoqërisë dhe operatorit/e shoqërisë ðAö Shpk në vlerën 44,5 lekë pa TVSh, kohëzgjatja e

marrëveshjes kuadër është për një periudhë 2-vite, nga data e nënshkrimit të kësaj marrëveshje (periudha 20.03.2020-20.03.2022).

Kualifikimi, shpallja fitues dhe lidhja e marrëveshjes e operatorit ekonomik òAò Shpk është kryer në kundërshtim me Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 òPër prokurimin publikò, i ndryshuar, neni 46, neni 53 pika 3, VKM nr. 914, datë 29.12.2014 òRregullat e Prokurimitò, i ndryshuar, neni 66 pika 3, Ligjin nr. 44/2015 òKodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisëò nenet 108-118.

Për sa trajtuar si më sipër ngarkohet me përgjegjësi KVO e përbërë G. P., N. H. E. D.

Pavarësisht shkeljeve dhe parregullsive ligjore ose rregullatore të përmendur si më sipër, veprimet e mësipërme nga KVO janë kryer nga mos njohja/ose keqinterpretimi i legjislacionit specifik të procedurave të prokurimit dhe në veçanti atij të mallrave dhe nuk kanë krijuar asnjë pasojë financiare në dëm Institucionit, pasi operatori ekonomik òAò Shpk është operatori i vetëm në proçedurë. Gjithsesi për shkeljet dhe parregullsitë e përmendura më lart, del më se e domosdoshme marrja e masave urgjente për të korrigjuar këtë praktikë në zhvillimin e proceduarve të prokurimit. Qëllimi i këtyre masave është jo vetëm ndreqja e gjendjes së shkeljeve dhe parregullsive, por edhe ndikimi me anë të efektit parandalues mbi punonjësit e tjerë të administratës, për të parandaluar për të ardhmen shkeljet e ligjeve.

Kontrata është lidhur me nr. 74/10 prot., datë 20.03.2020, ndërmjet Shoqërisë Ujësjetllës Kanalizime Elbasan sha të përfaqësuar nga L. D. në cilësinë e Administratorit të shoqërisë dhe operatorit/e shoqërisë òAò Shpk në sasinë 86516,8kg,në vlerën 4,620,000 lekë me TVSh, kohëzgjatja e kontratës është për një periudhë (periudha 20.03.2020-20.03.2022).

Me shkresën nr.74/11 datë 31.03.2020 njoftimi i kontratës

Kontrata është lidhur me nr. 74/12 prot., datë 10.09.2020, ndërmjet Shoqërisë Ujësjetllës Kanalizime Elbasan sha të përfaqësuar nga L. D. në cilësinë e Administratorit të shoqërisë dhe operatorit/e shoqërisë òAò Shpk në sasinë 44,000 kg, në vlerën 2,349,600 lekë me TVSh, kohëzgjatja e kontratës është për një periudhë (periudha 10.09.2020-31.12.2020).

Me shkresën nr.74/13 datë 10.09.2020 njoftimi i kontratës.

Kontrata është lidhur me nr. 74/15 prot., datë 08.02.2021, ndërmjet Shoqërisë Ujësjetllës Kanalizime Elbasan sha të përfaqësuar nga L. K. në cilësinë e Administratorit të shoqërisë dhe operatorit/e shoqërisë òAò Shpk në sasinë 115,000 kg, në vlerën 6,141,000 lekë me TVSh, kohëzgjatja e kontratës është për një periudhë (periudha 08.02.2021-31.12.2021).

Kontrata është lidhur me nr. 74/17 prot., datë 18.03.2022, ndërmjet Shoqërisë Ujësjetllës Kanalizime Elbasan sha të përfaqësuar nga L. K. në cilësinë e Administratorit të shoqërisë dhe operatorit/e shoqërisë òAò Shpk në sasinë 66,483.2 kg, në vlerën 3,550,192.2 lekë me TVSh, kohëzgjatja e kontratës është për një periudhë (periudha 18.03.2022 deri në përfundim të tërheqjes së sasisë).

2. Proçedura e prokurimit me objekt “Blerje makineri pajisje për UK.

1. Urdhër Prokurimi nr. 462Prot. datë 29.03.2021	3. Njësia e prokurimit Urdhër nr. 83 prot. datë 29.01.2021 - J. D., me detyrë Shef dega ujësjetllës - O. D., me detyrë juriste - E. B.,me detyrë inxhinier mekanik,	4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave Urdhër nr. 83/1 datë 29.01.2021 - A. M., me detyrë Drejtor Tregtar - N. H., me detyrë Përgjegjëse Finance - J. D., me detyrë Drejtor Teknik
2. Lloji i Proçedurës së Prokurimit òProçedurë e hapurò (mallra)		
5. Fondi Limit (pa tvsh) 150,000,000 lekë	6. Oferta fituese (pa tvsh) 148,000,000 lekë	7. Diferenca me fondin limit (pa tvsh) 2,000,000(dy milion) lekë
8. Data e hapjes së tenderit 27.04.2021	9. Burimi Financimit Fond nga Buxheti i Shtetit vitet	10. Operatorët Ekonomike a) Pjesëmarrës në tender Numër _1_OE

	2021-2024	b) Sëkualifikuar 0 OE, c) Kualifikuar <u>1</u> OE
11. Ankimime Pranë AK - nuk ka	12. Përgjigje Ankesës nga AK - nuk ka	13. Përgjigje Ankesës nga Komisioni i Prokurimit Publik - nuk ka
b. Zbatimi i Kontratës të Mallrave		
14. Lidhja e kontratës nr. 436/8, datë 24.06.2021	15. Vlera e kontratës (me tvsh) 177,600,000 lekë	16. Afati i kontratës në dite 12muaj nga nënshkrimi i kontratës

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion, si dhe aksesimit në sistemin e prokurimit elektronik (S.P.E.) të A.P.P, u konstatua se:

Fondi i këtij shpenzimi është akorduar nga Buxheti i shtetit (Agjencia Kombëtare e Ujësjetllës Kanalizimeve dhe Infrastrukturës së Mbetjeve) me shkresën nr. 373 prot., datë 12.02.2021 me vlerë 150,000,000 lekë.

Kjo procedurë është parashikuar në regjistrin e parashikimeve të prokurimeve publike të Shoqërisë ëUjësjetllës Kanalizime Elbasanë Sh.a.

Me urdhër të Administratorit të Shoqërisë L. K. nr. 462, datë 29.03.2021, është urdhëruar të kryhet prokurimi elektronik në vlerën 150,000,000 lekë, forma e prokurimit, prokurimi në mënyrë elektronike, lloji i procedurës së prokurimit ëProcedurë e hapurë mallra.

Njësia e prokurimi e përbërë nga O. D. me detyrë juriste, E. B. me detyrë inxhinier mekanik, dhe J. D. me detyrë Shef Dega Ujësjetllës me profesion inxhinier ndërtimi.

Në pikën 2.3.2 të kriterëve të kualifikimit ëKapaciteti financiarë, është përcaktuar se, operatorët duhet të paraqesin, Vërtetim nga Administrata Tatimore për xhiron mesatare te viteve 2018, 2019 dhe 2020, me një vlere jo me te vogël se 40 % e vlerës se fondit limit.

Veprim në kundërshtim me shkresën Agjencisë së Prokurimit Publik (Drejtoria juridike dhe e Monitorimit), nr. 3341/1 prot., date 20.03.2018, pasi nuk duhesh ëKërkuar që kontrata të ngjashme me një vlerë jo më të vogël se 40 % të vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit të veprimtarisë së operatorit , *por të tre vitet e fundit nga data e zhvillimit të tenderit*”.

Me urdhër të Administratorit të Shoqërisë L. K. nr. 462/1, datë 29.03.2021, është ngritur komisioni i vlerësimit të ofertave i përbërë nga A. M. me detyrë drejtor tregtar me profesion ekonomiste, J. D. me detyrë drejtor teknik, me profesion inxhinier hidro, N. H. me detyrë përgjegjëse finance me profesion ekonomiste.

Data e publikimit është 31.03.2021, afati për dorëzim të ofertave data 27.04.2021 ora 11.00.

- Hartimi i kërkesave të veçanta për kualifikim/specifikimet teknike.

Proçesverbali datë 30.03.2021 i njësisë së prokurimit e përbërë nga të firmosur nga njësia e prokurimit e përbërë O. D., E. B. dhe J. D. ku janë miratuar dokumentet e tenderimit (D.T.).

Zhvillimi i procedurës së prokurimit.

Në këtë procedurë prokurimi kanë marr pjesë operatorët ekonomik.

- Bashkimi i Operatorëve Ekonomik ëZë sh.p.k & ëLë sh.p.k me ofertë në vlerën 148,000,000 lekë (pa tvsh).

Pas vlerësimit të KVO u kualifikua dhe shpall fitues Bashkimi i Operatorëve Ekonomik ëZë sh.p.k & ëLë sh.p.k me ofertë në vlerën 148,000,000 lekë (pa tvsh).

Në pikën 2.3.2 ëKapaciteti teknikë është përcaktuar: Operatori Ekonomik duhet të disponoje certifikatën ISO 9001:2015 mbi ëSistemet e menaxhimit te cilësisëë, lëshuar nga institucionet zyrtare te akredituar për këtë qellim.

Certifikata kërkohet të jetë e vlefshme në kohën e zhvillimit të tenderit.

Në rastet e bashkimit të operatoreve ekonomik, secili operator ekonomik duhet të dorëzojë certifikatën ISO sipas zërave të mallrave që do të marrë përsipër sipas akt-marrëveshjes.)

Ky operator nuk provohet ta ketë përmbushur këtë kërkesë, pasi: Operatori ekonomik òZò shpk referuar marrëveshjes së bashkëpunimit me operatorin L shpk date 26.04.2021 , nuk ka paraqitur përmbushjen e detyrimeve për furnizimin e pajisjeve sipas zërave të mëposhtëm :

Eskavator me goma	Cope	1	15,000,000.00	15,000,000.00
Mjet me karroceri tip Pick up	Cope	2	6,200,000.00	12,400,000.00
Kamioncine dopio kabine me karroceri fikse	Cope	2	7,300,000.00	14,600,000.00
Minifadrome	Cope	1	8,424,000.00	8,424,000.00
Rimorkiator	Cope	1	6,503,000.00	6,503,000.00
Kamioncine vetëshkarkuese tek kabine,dopio gome	Cope	2	8,536,500.00	17,073,000.00

Operatori ka paraqitur certifikatën EN-ISO 9001:2015 me numër seri AQS/Q/37962019 të lëshuar nga kompania Q, për òZò shpk, e përkthyer dhe noterizuar në gjuhën shqipe. me date lëshimi 25.02.2019, dhe datë skadence 24.02.2022,

Nga verifikimi referuar Rekomandimit të Agjencisë së Prokurimit Publik nr. 3330 prot., datë 20.03.2018 dhe Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit nr. 145 prot., datë 16.03.2018, u konstatua se kompania Q ne Angli është e akredituar ndërkombëtarisht, por kjo certifikatë me numër serie AQS/Q/37962019 nuk është publikuar në faqen e kësaj kompanie ò<https://aqscert.org>, për pasojë është dokument i pabesueshëm për tu marre në konsiderate referuar rekomandimit të sipërpërmendur.

Veprim në kundërshtim me Rekomandimin e Agjencisë së Prokurimit Publik nr. 3330 prot., datë 20.03.2018 dhe Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit nr. 145 prot., datë 16.03.2018, pika 5.

Raporti përmbledhës nga komisioni i vlerësimit është hartuar me nr. 462/5 prot., datë 18.05.2021, raport i cili është miratuar nga Titullari i Autoritetit Kontraktor, ku ka shpallur fitues operatorin ekonomik Bashkimi i Operatorëve Ekonomik òZò sh.p.k & òLò sh.p.k me ofertë ekonomike në vlerën 148,000,000 lekë pa TVSH.

Titullari i Autoritetit Kontraktor me vendimin nr. 462/5 prot., datë 18.05.2021 ka vendosur shpalljen fitues te Bashkimit të Operatorëve Ekonomik òZò sh.p.k & òLò sh.p.k me ofertë ekonomike në vlerën 148,000,000 lekë pa TVSH.

Me shkresën nr. 462/7 prot., datë 19.05.2021 Formular i Njoftimit te Fituesit.

Kontrata është lidhur me nr. 462/8 prot., datë 04.06.2021, ndërmjet Shoqërisë Ujësjiellës Kanalizime Elbasan sha të përfaqësuar nga Administratori i shoqërisë dhe Bashkimit të Operatorëve Ekonomik òZò sh.p.k & òLò sh.p.k òZò sh.p.k & òLò sh.p.k në vlerën 177,600,000 lekë me TVSh, kohëzgjatja e kontratës është për një periudhë 12 muaj nga data e nënshkrimit të kësaj kontrate.

Me shkresën nr.462/9 datë 08.06.2021 njoftimi i kontratës.

Kualifikimi, shpallja fitues dhe lidhja e kontratë Bashkimit të Operatorëve Ekonomik òZò sh.p.k & òLò sh.p.k ò është kryer në kundërshtim me Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 òPër prokurimin publikò, i ndryshuar, neni 46, neni 53 pika 3, VKM nr. 914, datë 29.12.2014 òRregullat e Prokurimitò, i ndryshuar, neni 66 pika 3, Ligjin nr. 44/2015 òKodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisëò nenet 108-118.

Për sa trajtuar si më sipër ngarkohet me përgjegjësi KVO e përbërë A. M., N. H., me detyrë Përgjegjëse Finance J. D..

Pavarësisht shkeljeve dhe parregullsive ligjore ose rregullatore të përmendur si më sipër, veprimet e mësipërme nga KVO janë kryer nga mos njohja/ose keqinterpretimi i legjislacionit specifik të procedurave të prokurimit dhe në veçanti atij të mallrave dhe nuk kanë krijuar asnjë pasojë financiare në dëm Shoqërisë, pasi Bashkimit të Operatorëve Ekonomik òZò sh.p.k & òLò sh.p.k ò është operatori i vetëm në proçedurë. Gjithsesi për shkeljet dhe parregullsitë e përmendura më lart, del më se e domosdoshme marrja e masave urgjente për të korrigjuar këtë praktikë në zhvillimin e proceduarve të prokurimit. Qëllimi i këtyre masave është jo vetëm ndreqja e gjendjes së shkeljeve dhe parregullsive, por edhe ndikimi me anë të efektit parandalues mbi punonjësit e tjerë të administratës, për të parandaluar për të ardhmen shkeljet e ligjeve.

3. Proçedura e prokurimit me objekt “Blerje materiale hidraulike, viti 2021”.

1. Urdhër Prokurimi nr. 8 datë 29.01.2021	3. Njësia e prokurimit Urdhër nr. 83 prot. datë 29.01.2021 - G. P., me detyrë Shef dega ujësjellës - A. M., me detyrë Drejtor Tregtar - Ç. L., me detyrë Drejtor i Shërbimeve të Përgjithshme	4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave Urdhër nr. 83/1 datë 29.01.2021 - J. D., me detyrë Inxhinier - N. H., me detyrë Përgjegjëse Finance - R. H., me detyrë Përgjegjëse Koordinimi Projektesh
2. Lloji i Procedurës së Prokurimit òProcedurë e hapurò (mallra)		
5. Fondi Limit (pa tvsh) 35,000,000 lekë	6. Oferta fituese (pa tvsh) 33,976,344 lekë	7. Diferenca me fondin limit (pa tvsh) 1,023,656 (një milion e njëzet e tre mijë e gjashtëqind e pesëdhjetë e gjashtë) lekë
8. Data e hapjes së tenderit 24.02.2021	9. Burimi Financimit Fond nga Buxheti i Shoqërisë	10. Operatorët Ekonomike a) Pjesëmarrës në tender Numër _2_ OE b) Sëkualifikuar 1 OE, c) Kualifikuar _1_ OE
11. Ankimime Pranë AK - nuk ka	12. Përgjigje Ankesës nga AK - nuk ka	13. Përgjigje Ankesës nga Komisioni i Prokurimit Publik - nuk ka
b. Zbatimi i Kontratës të Mallrave		
14. Lidhja e kontratës nr. 83/6, datë 23.03.2021	15. Vlera e kontratës (me tvsh) 40,771,613 lekë	16. Afati i kontratës në dite 90 ditë nga nënshkrimi i kontratës

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion, si dhe aksesimit në sistemin e prokurimit elektronik (S.P.E.) të A.P.P, u konstatua se:

Fondi i këtij i këtij shpenzimi është akorduar nga të ardhurat e shoqërisë me vlerë 35,000,000 lekë.

Kjo procedurë është parashikuar në regjistrin e parashikimeve të prokurimeve publike të Shoqërisë òUjësjetllës Kanalizime Elbasanò Sh.a.

Me kërkesë datë 03.12.2020 të L. D. me detyrë inxhinier, ka bërë kërkesë për blerje materiale hidraulike për periudhën viti 2021.

Me urdhër të Administratorit të Shoqërisë L. D. nr. 83, datë 29.01.2021, është urdhëruar të kryhet prokurimi elektronik në vlerën 35,000,000 lekë, forma e prokurimit, prokurimi në mënyrë elektronike, lloji i procedurës së prokurimit òProcedurë e hapurò mallra.

Njësia e prokurimi e përbërë nga G. P. me detyrë shef dega ujësjellës, me profesion ing.hidro, A. M. me detyrë drejtor tregtar me profesion ekonomiste, dhe Ç. L. me detyrë Drejtor i Shërbimeve të Përgjithshme me profesion ekonomist.

Me urdhër të Administratorit të Shoqërisë L. D. nr. 4, datë 06.01.2020, është ngritur grupi i punës për argumentin e fondit limit, i përbërë nga M. T., A. K., M. R., E. B., A. N.

Me procesverbal të protokolluar datë 20.01.2021, grupi i përlllogaritjes së fondit limit i përbërë nga M. T., A. K., M. R., E. B., A. N. ka përcaktuar vlerën 35,000,000 lekë pa TVSH.

Pra, përlllogaritja e vlerës së kontratës është përcaktuar në vlerën 35,000,000 lekë, pas çmimit mesatar për çdo artikull të ofruar nga operatorët ekonomik òIò Shpk në vlerën 7,330,048 lekë për njësi, materiale hidraulike, òPò Shpk në vlerën 7,404,716.2 lekë për njësi, òFò Shpk në vlerën 7,105,405 lekë për njësi.

Nga grupi për llogaritjen e vlerës limit të kontratës, nuk është dhënë asnjë argumentim përse nuk është marrë për bazë edhe vlera e kontratave të mëparshme të ngjashme, të realizuara po nga vetë Institucioni n.q.s ka, ose Shoqëritë e tjera të ujësjellësve, ose pse një numër kaq i kufizuar operatorësh, pra pse tre dhe jo mbi pesë.

Veprim në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 òPër miratimin e rregullave të prokurimit publikò, i ndryshuar, neni 59, pika 2 ku është shprehur në mënyrë eksplicite se òNë përlllogaritjen e vlerës limit të kontratës, autoriteti kontraktor duhet t'ò referohet një ose më shumë alternativave të renditura si më poshtë: çmimet e botuara nga Instituti i Statistikave (INSTAT), ose/dhe çmime të tjera zyrtare, të njohura nga institucionet përkatëse (si për shembull, nga organet tatimore a doganore, dhomat e tregtisë, në manuale etj);ose/dhe

a) çmimet e tregut;ose/dhe

b) çmimet e kontratave të mëparshme, të realizuara nga vetë apo nga autoritete të tjera kontraktore;ose/dhe

ç) çmimet ndërkombëtare, të shpallura publikisht.

Autoriteti kontraktor, përpara nxjerrjes së urdhrit të prokurimit, duhet të argumentojë dhe të dokumentojë përlllogaritjen e vlerës së kontratës, bazuar në specifikimet teknike të objektit që prokurohetò.

Si konkluzion, përlllogaritja e vlerës së kontratës është bërë duke u mbështetur në çmimet e tregut, por nuk është dhënë asnjë argumentim përse nuk është i është referuar edhe alternativave të tjera, si çmimet e kontratave të mëparshme të realizuara nga autoritete të tjera kontraktore, ose/dhe çmime të tjera zyrtare, të njohura nga institucionet përkatëse (si për shembull, nga organet tatimore a doganore, i Shoqëritë e tjera të ujësjellësve etj), veprim në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 òPër miratimin e rregullave të prokurimit publikò, i ndryshuar, neni 59, pika 2,

Për sa trajtuar si më sipër ngarkohet me përgjegjësi grupi i përlllogaritjes së vlerës limit të kontratës i përbërë nga M. T., A. K., M. R., E. B. dhe A. N.

Në kërkesat për kualifikim, pika 2.3.4 òKapaciteti teknikò është kërkuar Prodhuesi i mallit duhet të jetë i certifikuar për sistemin e menaxhimit të cilësisë me certifikatë ISO 9001:2015 (Ose ekuivalent) për prodhimin e mallrave objekt prokurimi. Certifikata duhet te jete e vlefshme.

Në kërkesat për kualifikim, pika 2.3.8 òKapaciteti teknikò është kërkuar Operatori ekonomik duhet te paraqesë certifikaten e vlefshme qe vërteton se tubot HDPE te ofruara janë sipas standartit EN 12201-2 ose ekuivalent.

Në kërkesat për kualifikim, pika 2.3.9 është kërkuar Operatori Ekonomik duhet të paraqesë certifikatën ISO 9001:2015 te vlefshme mbi òSistemet e menaxhimit te cilësisëò për mallrat objekt prokurimi te lëshuar nga kompani te cilat njihen nga institucionet zyrtare Shqiptare dhe që janë të akredituara. Për këtë OE duhet te paraqesë Certifikatën ISO dhe dokumentet përkatës që vërtetojnë akreditimin nga institucionet zyrtare Shqiptare.

Në kërkesat për kualifikim, pika 2.3.10 është kërkuar Te gjitha mallrat që kanë kontakt me ujin e pijshëm duhet të kenë certifikatë të aprovimit për përdorimin për ujë të pijshëm te vlefshme (p.sh DVGË, ÈRAS ose ekuivalente me këto) nga të paktën 1 institucion kombëtare, ndërkombëtare ose institucione te pavarura certifikuese/testuese për të gjithë produktet që kanë kontakt me ujin e pijshëm.

Ndërsa në specifikimet specifikimet teknike është përcaktuar

Tubot PE100/PEHD

Tuba polietileni me dendësi të lartë. Të jenë sipas standartit EN 12201 ose ekuivalent me të. Tubat të kenë një koeficient sigurimi minimalisht 1.20. Materialet e përdorura për prodhimin e tubave të jenë jo toksike dhe të mos ndikojnë në cilësinë e ujit (mos t'japin atij as erë as shije). Të jenë fleksibël dhe me rezistencë ndaj vibrimeve dhe goditjeve sizmike, për tu përshtatur me relievin e tokës. Të jenë rezistent ndaj rrezeve ultraviolette dhe ndaj temperaturave -25 deri në 55°C. Të kenë rezistencë të lartë ndaj gërryerjes dhe jetëgjatësi të paktën 50 vjet.

Pamja e jashtme: të kenë sipërfaqe të lëmuar dhe pa dëmtime, të jenë ngjyrë e zezë me vija blu, prerja fundore e tubit duhet të jetë e pastër dhe në kënd të drejtë me qendrën e tubit.

Produktet duhet të kenë certifikate aprovimi nga të paktën 1 (një) institucion ndërkombëtar për përdorimin për ujë të pijshëm (p.sh DVGÜ).

Nga njësia nuk është përcaktuar:

Mënyra e testimit të tubave të jetë sipas standarteve DVGÜ ose ekuivalent.

Dokumentacioni teknik shoqëruar :

Për këtë kontraktuesit për tubacionet polietilen PE do ti kërkohet që tubat dhe pjesët speciale HDPE, duhet të jenë të shoqëruar me dokumentacionin teknik përkatës të kërkuar nga Standartet e mësipërme si:

-Çertifikata e origjinës së mallit nga prodhuesi i tubave dhe pjesëve speciale.

-Çertifikata e origjinës së prodhimit të materialit të PE nga prodhuesi e shoqëruar me tipin e materialit, llojin dhe të dhënat teknike të përshkruara më sipër.

-Çertifikata e Cilësisë ISO 9001/14001 ose ekuivalente.

-Çertifikata e testimit (test raporti i fabrikës) të tubave dhe pjesëve speciale nga prodhuesi i tyre.

-Leja zyrtare për prodhimin e tubave dhe pjesëve speciale për prodhuesin.

Në kërkesat për kualifikim nuk është kërkuar:

a. Në kërkesat për kualifikim nuk është kërkuar Certifikata: ISO 1452-1:2009 "Plastics piping systems for water supply and for buried and above-ground drainage and sewerage under pressure Sistemet e tubacioneve të plastikës për furnizimin me ujë dhe për kullimin e groposur dhe mbi tokë dhe kanalizimin nën presionë.

b. Dëshmi për rezultatet e testeve zyrtare, të lëshuara nga institucione të autorizuar, që vërtetojnë pajtueshmërinë e produkteve me specifikimet teknike.

c. Operatori ekonomik duhet të jetë i çertifikuar nga CE (European Community) për prodhimin dhe/ose tregtimin e materialeve hidraulike sipas preventivit. Në rast se operatori ekonomik është vetëm importues dhe tregtues, furnizuesi i tij duhet të jetë i çertifikuar nga CE (European Community) për prodhimin ose tregtimin e materialeve hidraulike sipas preventivit, bazuar në direktivën 89/106/CEE ndryshuar me direktivën 93/68/CEE të Unionit Europian.

d. Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë Çertifikatën e Prodhuesit, që vërteton se sistemi i menaxhimit të mjedisit të prodhuesit të mallrave objekt prokurimi, është sipas ISO 14001-2004 (e përkthyer dhe e noterizuar në shqip) e vlefshme në kohën e zhvillimit të tenderit.

e. Operatori ekonomik duhet të dorëzojë një deklaratë që merr përsipër transportin e mallrave drejt ambienteve të UK Elbasan sipas kërkesave të këtij të fundit.

Veprim në kundërshtim me Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar, neni 46, pika 1, VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, neni 30, pika 2, ku është shprehur në mënyrë eksplicite se "Certifikatat e kërkuara duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me objektin e kontratës, duke respektuar edhe parimin e mos diskriminimit".

Për sa trajtuar si më sipër ngarkohet me përgjegjësi njësia e prokurimit e përbërë G. P., A. M. dhe Ç. L.

Me urdhër të Administratorit të Shoqërisë L. D. nr. 83/1, datë 29.01.2021, është ngritur komisioni i vlerësimit të ofertave i përbërë nga J. D. me detyrë inxhinier, me profesion inxhinier ndërtimi, N. H. me detyrë përgjegjëse Finance me profesion ekonomiste dhe R. H. me detyrë Përgjegjëse Koordinimi Projektsh.

Data e publikimit është 01.02.2021, afati për dorëzim të ofertave data 24.02.2021 ora 11.00.

- Hartimi i kërkesave të veçanta për kualifikim/specifikimet teknike.

Procesverbali datë 29.01.2021 i njësisë së prokurimit i firmosur nga njësia e prokurimit e përbërë G. P., A. M., dhe Ç. L. ku të jenë miratuar dokumentet e tenderimit (D.T.)

Zhvillimi i procedurë së prokurimit.

Në këtë procedurë prokurimi kanë marr pjesë operatorët ekonomik.

- Æ sh.p.k me ofertë në vlerën 33,976,344 lekë (pa tvsh).

- Æ shpk me ofertë në vlerën 34,891,900 lekë (pa tvsh).

Pas vlerësimit të KVO u kualifikua dhe shpall fitues operatori ekonomik Æ sh.p.k me ofertë në vlerën 33,976,344 lekë (pa tvsh), duke u skualifikuar operatori ekonomik - Æ shpk me ofertë në vlerën 34,891,900 lekë (pa tvsh).

Në pikën 2.3.4 ÆKapaciteti teknikë është përcaktuar: Prodhuesi i mallit duhet të jetë i çertifikuar për sistemin e menaxhimit të cilësisë me (Ose ekuivalent) për prodhimin e mallrave objekt prokurimi. Certifikata duhet të jetë e vlefshme:

Ky operator nuk provohet ta ketë përmbushur këtë kërkesë, pasi:

Operatori ka paraqitur çertifikatën ISO 9001:2015 të lëshuar nga kompania Q, për A group, e përkthyer dhe noterizuar në gjuhën shqipe. Nga Certifikuar më date 01.07.2018 dhe datë skadence 30.06.2021.

Nga verifikimi referuar Rekomandimit të Agjencisë së Prokurimit Publik nr. 3330 prot., datë 20.03.2018 dhe Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit nr. 145 prot., datë 16.03.2018, u konstatua se kompania Q ne Angli është e akredituar ndërkombëtarisht, por kjo certifikatë me numër seri Q 30675457/72/Q Rev:001 nuk është publikuar në faqen e kësaj kompanie, për pasojë është dokument i pabesueshëm për tu marre në konsiderate referuar rekomandimit të sipërpërmendur.

Raporti përmbledhës nga komisioni i vlerësimit është hartuar me nr. 83/3 prot., datë 12.03.2021, raport i cili është miratuar nga Titullari i Autoritetit Kontraktor, ku ka shpallur fitues operatorin ekonomik Æ sh.p.k me ofertë ekonomike në vlerën 33,976,344 lekë pa TVSH.

Titullari i Autoritetit Kontraktor me vendimin nr.83/4 prot. Datë 12.03.2021 ka vendosur shpalljen fitues te operatorin ekonomik Æ sh.p.k me ofertë ekonomike në vlerën 33,976,344 lekë pa TVSH.

Me shkresën nr.83/5 datë 16.03.2021 formular i njoftimit te fituesit.

Kontrata është lidhur me nr. 83/6 prot., datë 23.03.2021, ndërmjet Shoqërisë Ujësjetllës Kanalizime Elbasan sha të përfaqësuar nga L. K. në cilësinë e Administratorit të shoqërisë dhe operatorit/e shoqërisë Æ sh.p.k në vlerën 40,771,613 lekë me TVSh, kohëzgjatja e kontratës është për një periudhë 90 ditë, nga data e nënshkrimit të kësaj kontrate.

Me shkresën nr.83/7 datë 28.03.2021 njoftimi i kontratës.

Kualifikimi, shpallja fitues dhe lidhja e marrëveshjes e operatorit ekonomik Æ sh.p.kë është kryer në kundërshtim me Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 ÆPër prokurimin publikë, i ndryshuar, neni 46, neni 53 pika 3, VKM nr. 914, datë 29.12.2014 ÆRregullat e Prokurimitë, i ndryshuar, neni 66 pika 3, Ligjin nr. 44/2015 ÆKodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisëë nenet 108-118.

Për sa trajtuar si më sipër ngarkohet me përgjegjësi operatorit ekonomik òAò sh.p.kò refreruar ligjit të prokurimit publik dhe Ligjit nr. 9754, datë 14.06.2007 òPërgjegjësinë penale të personave juridikò, neni 3.

Pavarësisht shkeljeve dhe parregullsive ligjore ose rregullatore të përmendur si më sipër, veprimet e mësipërme nga KVO janë kryer nga mos njohja/ose keqinterpretimi i legjislacionit specifik të procedurave të prokurimit dhe në veçanti atij të mallrave dhe nuk kanë krijuar asnjë pasojë financiare në dëm Shoqërisë, pasi operatori ekonomik òOò sh.p.k, pjesëmarrës në këtë procedurë prokurimi ka paraqitur ofertën 34.891.900 lekë, pra me vlerë më të lartë në vlerën 915,556 lekë. Gjithsesi për shkeljet dhe parregullsitë e përmendura më lart, del më se e domosdoshme marrja e masave urgjente për të korrigjuar këtë praktikë në zhvillimin e proceduarve të prokurimit. Qëllimi i këtyre masave është jo vetëm ndreqja e gjendjes së shkeljeve dhe parregullsive, por edhe ndikimi me anë të efektit parandalues mbi punonjësit e tjerë të administratës, për të parandaluar për të ardhmen shkeljet e ligjeve

Zbatimi i kontratës

Me urdhër transfertë datë 04.05.2021 nëpërmjet C është likuiduar Shoqëria òAò sh.p.k shpk për vlerën 5,733,895 lekë. Dokumenti justifikues fatura nr. 63, datë 27.04.2021 në vlerën 5,733,895 lekë me objekt materiale hidraulike, firmosur nga A. M. me detyrë ish-drejtoare e Drejtorisë Tregtare. Fatura cilëson materiale sipas listës bashkëlidhur. Lista bashkëlidhur në vlerën 5,733,895 lekë, dokument i fotokopjuar firmosur vetëm nga administratorja e Shoqërisë òAò A. S., Veprim në kundërshtim me Udhëzimin MF nr. 30 datë 27.12.2011 òPër menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publikò, i ndryshuar me nr. 20, datë 17.11.2014 pika 36 dhe 44. Fletëhyrja nr. 9, datë 27.04.2021.

Me urdhër transfertë datë 15.04.2021 nëpërmjet C është likuiduar Shoqëria òAò sh.p.k për vlerën 5,531,646 lekë. Dokumenti justifikues fatura nr. 61, datë 13.04.2021 në vlerën 5,531,646 lekë me objekt materiale hidraulike, firmosur nga A. M. me detyrë ish-drejtoare e Drejtorisë Tregtare. Fatura cilëson materiale sipas listës bashkëlidhur. Lista bashkëlidhur në vlerën 5,531,646 lekë, dokument i fotokopjuar firmosur vetëm nga administratorja e Shoqërisë òAò A. S., Veprim në kundërshtim me Udhëzimin MF nr. 30 datë 27.12.2011 òPër menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publikò, i ndryshuar me nr. 20, datë 17.11.2014 pika 36 dhe 44. Fletëhyrja nr. 8, datë 13.04.2021.

Procesverbali i marrjes në dorëzim datë 13.04.2021 i firmosur nga K. C., K. M. dhe Y. A., ku është cilësuar òMalli i pranuar plotëson kërkesat e vendosura në procedurën e prokurimitò, duke mos cilësuar zbatimin ose jo të specifikimeve teknike (shtojca 10 e dokumenteve të tenderit) Shtojca 6 òDeklaratë mbi përmbushjen e specifikimeve teknike nga operatori ekonomikò dhe nenin 9/1 i kontratës òMallrat e furnizuara sipas kontratës duhet të jenë konform kodeve dhe Standardeve Teknike të parashikuara në specifikimet teknike. Nëse gjatë ekzekutimit të kontratës, ka ndryshime në kodet përkatëse ose në Standardet Teknike, këto ndryshime do të zbatohen vetëm pas aprovimit nga Autoriteti Kontraktorò.

Veprim në kundërshtim me:

- Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 òPër prokurimin publikò, i ndryshuar, neni 60, pika 1, e cila përcakton se: ò1. Kushtet e kontratës, të lidhur sipas këtij ligji, nuk ndryshojnë nga ato të përshkruara në dokumentet e tenderit dhe në ofertën fitueseò.

- Ligjin nr. 7850, datë 29.07.1994 òKodi Civil i Republikës së Shqipërisëò, neni 419, 420, neni 659, 698 dhe neni 690 në të cilin është shprehur ò.....Mos përmbushja e detyrimeve përkatëse sjell lindjen e përgjegjësisë juridiko-civile për palën mos përmbushëse, përgjegjësi e cila konkretizohet në detyrimin për ti shpërblyer palës/palëve të tjera shpërblyerit e dëmit të pësuar në formën dëmit efektiv dhe fitimit të munguarò.

-Udhëzimin e Ministrisë Financave nr. 30 datë 27.12.2011, òPër menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publikò, i ndryshuar me nr. 20, datë 17.11.2014 pika 35.

Me urdhër transfertë datë 23.08.2021 për vlerën 5,817,591 lekë, urdhër transfertë datë 01.09.2021 për vlerën 1,500,000 lekë, urdhër transfertë datë 01.09.2021 për vlerën 1,500,000 lekë, urdhër transfertë datë 17.09.2021 për vlerën 2,000,000 lekë, urdhër transfertë datë 01.11.2021 për vlerën 5,000,000 lekë, urdhër transfertë datë 23.11.2021 për vlerën 3,500,000 lekë nëpërmjet Credins Bank është likuiduar Shoqëria òAò sh.p.k. Dokumenti justifikues fatura nr. 75, datë 22.06.2021 në vlerën 17,817,592 lekë me objekt materiale hidraulike, firmosur nga A. M. me detyrë ish-drejtorë e Drejtorisë Tregtare, e pa firmosur nga furnizuesi, vetëm vulosur. Fatura cilëson materiale sipas listës bashkëlidhur. Lista bashkëlidhur në vlerën 17,817,592 lekë, dokument vulosur nga Shoqëria òAò pa firmosur, veprim në kundërshtim me Udhëzimin MF nr. 30 datë 27.12.2011 òPër menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publikò, i ndryshuar me nr. 20, datë 17.11.2014 pika 36 dhe 44.

Fletëhyrja nr. 16, datë 22.06.2021.

Procesverbali i marrjes në dorëzim datë 22.06.2021 i firmosur nga K. C., K. M. dhe Y. A., ku është cilësuar òMalli i pranuar plotëson kërkesat e vendosura në procedurën e prokurimitò, duke mos cilësuar zbatimin ose jo të specifikimeve teknike (shtojca 10 e dokumenteve të tenderit) Shtojca 6 òDeklaratë mbi përmbushjen e specifikimeve teknike nga operatori ekonomikò dhe nenin 9/1 i kontratës òMallrat e furnizuara sipas kontratës duhet të jenë konform kodeve dhe Standardeve Teknike të parashikuara në specifikimet teknike. Nëse gjatë ekzekutimit të kontratës, ka ndryshime në kodet përkatëse ose në Standardet Teknike, këto ndryshime do të zbatohen vetëm pas aprovimit nga Autoriteti Kontraktorò.

Veprim në kundërshtim me:

- Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 òPër prokurimin publikò, i ndryshuar, neni 60, pika 1, e cila përcakton se: ò1. Kushtet e kontratës, të lidhur sipas këtij ligji, nuk ndryshojnë nga ato të përshkruara në dokumentet e tenderit dhe në ofertën fitueseò.

- Ligjin nr. 7850, datë 29.07.1994 òKodi Civil i Republikës së Shqipërisëò, neni 419, 420, neni 659, 698 dhe neni 690 në të cilin është shprehur ò.....Mos përmbushja e detyrimeve përkatëse sjell lindjen e përgjegjësisë juridiko-civile për palën mos përmbushëse, përgjegjësi e cila konkretizohet në detyrimin për ti shpërblyer palës/palëve të tjera shpërblyerim të demit të pësuar në formën demit efektiv dhe fitimit të munguarò.

-Udhëzimin e Ministrisë Financave nr. 30 datë 27.12.2011, òPër menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publikò, i ndryshuar me nr. 20, datë 17.11.2014 pika 35.

Me urdhër transfertë datë 11.06.2021 për vlerën 2,500,000 lekë, urdhër transfertë datë 20.05.2021 për vlerën 5,500,000 lekë, urdhër transfertë datë 02.07.2021 për vlerën 3,688,480 lekë, është likuiduar Shoqëria òAò sh.p.k shpk. Dokumenti justifikues fatura nr. 65, datë 12.05.2021 në vlerën 11,688,480 lekë me objekt materiale hidraulike, firmosur nga A. M. me detyrë ish-drejtorë e Drejtorisë Tregtare, dhe për shoqërinë A. S. Fatura cilëson materiale sipas listës bashkëlidhur. Lista bashkëlidhur në vlerën 11,688,480 lekë , dokument firmosur dhe vulosur nga Shoqëria òAò pa firmosur nga blerësi, veprim në kundërshtim me Udhëzimin MF nr. 30 datë 27.12.2011 òPër menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publikò, i ndryshuar me nr. 20, datë 17.11.2014 pika 36 dhe 44.

Fletëhyrja nr. 11, datë 12.05.2021.

Procesverbali i marrjes në dorëzim datë 12.05.2021 i firmosur nga K. C., K. M. dhe Y. A., ku është cilësuar òMalli i pranuar plotëson kërkesat e vendosura në procedurën e prokurimitò, duke mos cilësuar zbatimin ose jo të specifikimeve teknike (shtojca 10 e dokumenteve të tenderit) Shtojca 6 òDeklaratë mbi përmbushjen e specifikimeve teknike nga operatori ekonomikò dhe

nenin 9/1 i kontratës ÷Mallrat e furnizuara sipas kontratës duhet të jenë konform kodeve dhe Standardeve Teknike të parashikuara në specifikimet teknike. Nëse gjatë ekzekutimit të kontratës, ka ndryshime në kodet përkatëse ose në Standardet Teknike, këto ndryshime do të zbatohen vetëm pas aprovimit nga Autoriteti Kontraktorë.

Veprim në kundërshtim me:

- Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 ÷Për prokurimin publikë, i ndryshuar, neni 60, pika 1, e cila përcakton se: ÷1. Kushtet e kontratës, të lidhur sipas këtij ligji, nuk ndryshojnë nga ato të përshkruara në dokumentet e tenderit dhe në ofertën fitueseë.

- Ligjin nr. 7850, datë 29.07.1994 ÷Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë, neni 419, 420, neni 659, 698 dhe neni 690 në të cilin është shprehur ÷.....Mos përmbushja e detyrimeve përkatëse sjell lindjen e përgjegjësisë juridiko-civile për palën mos përmbushëse, përgjegjësi e cila konkretizohet në detyrimin për ti shpërblyer palës/palëve të tjera shpërblyerim e dëmit të pësuar në formën dëmit efektiv dhe fitimit të munguarë.

-Udhëzimin e Ministrisë Financave nr. 30 datë 27.12.2011, ÷Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publikë, i ndryshuar me nr. 20, datë 17.11.2014 pika 35.

Materialet hidraulike nuk janë të shoqëruara me test raport fabrike, për pasojë grupi i auditimit nuk mund të shprehet për saktësinë dhe vërtetësinë e materialeve hidraulike. Pra nuk mund të bëhet verifikimi i specifikimeve teknike (që janë pjesë e kontratës) dhe të dhënat e test-raportit të fabrikës, që të konfirmohet që këto pajisje janë të njëjta me ato të prokuruar (specifikimeve teknike), dhe për të cilën Shoqëria ÷Aö sh.p.k Shpk ka fituar tenderin dhe është likuiduar, veprim ky në kundërshtim me Ligjin nr. 10,489 datë 15.12.2011 ÷Për trajtimin dhe mbikëqyrjen e tregut të produkteve jo ushqimoreë, neni 3 pika 11, 12, 16, 17, 18, 21 neni 8 , neni 9 dhe neni 10.

Për pasojë grupi i auditimit referuar praktikës dokumentare të vënë në dispozicion, e cila rezultoi e pasaktë dhe me mangësi, nuk mund të jap opinionin e tij, që këto materialet janë të njëjta me ato të prokuruar dhe për të cilat Shoqëria ÷Aö Shpk, ka fituar tenderin dhe është likuiduar.

Deri në paraqitjen nga Shoqëria ÷Aö sh.p.k të test raport fabrike, që të konfirmohet që këto pajisje janë të njëjta me ato të prokuruar (specifikimeve teknike), dhe për të cilën Shoqëria ÷Aö Shpk ka fituar tenderin dhe është likuiduar, vlera 40,771,612 lekë për Shoqërinë ÷UKö Elbasan dhe Buxhetin e Shtetit, përbën dëm ekonomik dhe duhet të dëmshpërblehet nga Shoqëria ÷Aö Shpk.

4. Proçedura e prokurimit me objekt “Blerje matesa uji individuale ½, ¾ dhe 1 , viti 2019”.

1. Urdhër Prokurimi nr. 104 datë 19.07.2019	3. Njësia e prokurimit Urdhër nr. 1712 prot. datë 19.07.2019 - G. P., me detyrë Shef dega ujesjellës - I. S., me detyrë juriste - P. A., me detyrë Përgjegjese Burime Njerëzore	4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave Urdhër nr. 1712 /2 datë 19.07.2019 - A. M., me detyrë Drejtor Tregtar - Ç. L., me detyrë Drejtor i Shërbimeve të Përgjithshme - N. H., me detyrë Përgjegjëse Finance
2. Lloji i Procedurës së Prokurimit ÷Procedurë e hapurë (mallra)		
5. Fondi Limit (pa tvsh) 10,668,701 lekë	6. Oferta fituese (pa tvsh) 10,373,770 lekë	7. Diferenca me fondin limit (pa tvsh) 294,931 (dyqind e nëntëdhjetë e katër mijë e nëntëqind e tridhjetë e një) lekë
8. Data e hapjes së tenderit 15.08.2019	9. Burimi Financimit Fond nga Buxheti i Shtetit	10. Operatorët Ekonomike a) Pjesëmarrës në tender Numër _2_OE b) Sëkualifikuar 1 OE, c) Kualifikuar _1_ OE
11. Ankimime Pranë AK - nuk ka	12. Përgjigje Ankesës nga AK - nuk ka	13. Përgjigje Ankesës nga Komisioni i Prokurimit Publik - nuk ka
b. Zbatimi i Kontratës të Mallrave		

14. Lidhja e kontratës nr. 1712/6, datë 06.09.2019	15. Vlera e kontratës (me tvsh) 12,448,524 lekë	16. Afati i kontratës në dite 15 ditë nga nënshkrimi i kontratës
--	--	---

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion, si dhe aksesimit në sistemin e prokurimit elektronik (S.P.E.) të A.P.P, u konstatua se:

Fondi i këtij i këtij shpenzimi është akorduar nga të ardhurat e shtetit me vlerë 10,668,701 lekë. Kjo procedurë është parashikuar në regjistrin e parashikimeve të prokurimeve publike të Shoqërisë ÷ Ujësjetllës Kanalizime Elbasanë Sh.a.

Me kërkesë datë 1841 prot. hyrës datë 24.06.2019 ÷ Dërgojmë detajimin e fondit ÷ Reforma e Ujitë për vitin 2019, në programin ÷ Furnizimi me ujë dhe kanalizime të Agjencisë së Ujësjetllës Kanalizime dhe Infrastrukturës së Mbetjeve, sektori i planifikimit të investimeve.

Me urdhër të Administratorit të Shoqërisë L. D. nr. 1712 prot., datë 19.07.2019, është urdhëruar të kryhet prokurimi elektronik në vlerën 10,668,701 lekë, forma e prokurimit, prokurimi në mënyrë elektronike, lloji i procedurës së prokurimit ÷ Procedurë e hapurë mallra.

Njësia e prokurimi e përbërë nga G. P. me detyrë shef dega ujësjetllës, me profesion ing.hidro, I. S., me detyrë specialist jurist, me profesion juriste, P. A., me detyrë Përgjegjëse Burimeve Njerëzore.

Në dosje nuk ka urdhër të Administratorit të Shoqërisë për ngritjen grupit të punës për argumentin e fondit limit, si dhe nuk ka ndonjë dokument për llogaritje e vlerës së kontratës, përveç tre ofertave, konkretisht operatori ekonomik Marilyn 2012 për vlerën 10,844,588 lekë, operatori ekonomik ÷ F. G. ÷ shpk për vlerën 10,684,030 lekë dhe personi fizik A. C. për vlerën 10,477,484 lekë.

Veprim në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 ÷ Për miratimin e rregullave të prokurimit publikë, i ndryshuar, neni 59, pika 2 ku është shprehur në mënyrë eksplicite se ÷ Në përlllogaritjen e vlerës limit të kontratës, autoriteti kontraktor duhet të referohet një ose më shumë alternativave të renditura si mëposhtë: Çmimet e botuara nga Instituti i Statistikave (INSTAT), ose/dhe çmime të tjera zyrtare, të njohura nga institucionet përkatëse (si për shembull, nga organet tatimore a doganore, dhomat e tregtisë, në manuale etj); ose/dhe

a) çmimet e tregut; ose/dhe

b) çmimet e kontratave të mëparshme, të realizuara nga vetë apo nga autoritete të tjera kontraktore; ose/dhe

ç) çmimet ndërkombëtare, të shpallura publikisht.

Autoriteti kontraktor, përpara nxjerrjes së urdhrës të prokurimit, duhet të argumentojë dhe të dokumentojë përlllogaritjen e vlerës së kontratës, bazuar në specifikimet teknike të objektit që prokurohet.

Si konkluzion, përlllogaritja e vlerës së kontratës është bërë duke u mbështetur në çmimet e tregut, por nuk është dhënë asnjë argumentim përse nuk është i është referuar edhe alternativave të tjera, si çmimet e kontratave të realizuara nga autoritete të tjera kontraktore, ose/dhe çmime të tjera zyrtare, të njohura nga institucionet përkatëse (si për shembull, nga organet tatimore a doganore, i UK te tjera) veprim në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 ÷ Për miratimin e rregullave të prokurimit publikë, i ndryshuar, neni 59, pika 2.

Për sa trajtuar si më sipër ngarkohet me përgjegjësi L. D. me detyrë Ish-Administrator në cilësinë e Titullarit të Autoritetit Kontraktor.

Me urdhër të Administratorit të Shoqërisë L. D. nr. 1712/2, datë 19.07.2019, është ngritur komisioni i vlerësimit të ofertave të përbërë nga A. M., me detyrë Drejtor Tregtar, Ç. L., me detyrë Drejtor i Shërbimeve të Përgjithshme, N. H., me detyrë Përgjegjëse Finance.

Data e publikimit është 22.07.2019, afati për dorëzim të ofertave data 15.08.2019 ora 11.00.

Në pikën 3,të kriterëve të kualifikimit ÷Kapaciteti teknik ÷ është përcaktuar se, Për te provuar përvojën e mëparshme, kërkohen dëshmi për furnizimet e mëparshme, te ngjashme, te kryera gjate tri viteve te fundit. Vlera e kërkuar duhet te jete jo me e vogël se 40 % e vlerës se përlllogaritur te kontratës, qe prokurohet dhe qe është realizuar gjate tri viteve te fundit. Autoriteti kontraktor si dëshmi për përvojën e mëparshme kërkon vërtetime te lëshuara nga një ent publik ose fatura tatimore të shitjes, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore te shitjes, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave te furnizuara .

Veprim në kundërshtim me shkresën Agjencisë së Prokurimit Publik (Drejtoria juridike dhe e Monitorimit), nr. 3341/1 prot., datë 20.03.2018, pasi nuk duhet përcaktuar që është realizuar gjatë tre viteve të fundit të veprimtarisë së operatorit, por të tre vitet e fundit nga data e zhvillimit të tenderit.

Shkelja e dispozitave ligjore të përmendur më sipër ngarkon me përgjegjësi njësinë e prokurimit të përbërë nga G. P., P. A. dhe I. S.

Zhvillimi i procedurë së prokurimit.

Në këtë procedurë prokurimi kanë marr pjesë operatorët ekonomik.

- ÷A÷ sh.p.k me ofertë në vlerën 10,584,520 lekë (pa tvsh).

- ÷A÷ shpk me ofertë në vlerën 10,373,770 lekë (pa tvsh).

Pas vlerësimit të KVO u kualifikua dhe shpall fitues operatori ÷A÷ shpk me ofertë në vlerën 10,373,770 lekë (pa tvsh).duke u shkualifikuar operatori ekonomik - ÷A÷ sh.p.k me ofertë në vlerën 10,584,520 lekë (pa tvsh).

Në pikën 2.3.4 ÷Kapaciteti teknik÷ është përcaktuar: Operatori Ekonomik duhet të paraqesë certifikatën ISO 9001:2015 mbi ÷Sistemet e menaxhimit te cilësisë÷ për mallrat objekt prokurimi te lëshuar nga kompani të cilat njihen nga institucionet zyrtare Shqiptare dhe që janë të akredituara.

Për plotësimin e kësaj pike OE duhet te paraqesë Certifikatën e cila kërkohet te jete e vlefshme ne kohen e zhvillimit te tenderit dhe dokumentet akreditues qe njihen nga Shteti.

Në rastet e bashkimit të operatoreve ekonomik, secili operator ekonomik duhet të dorëzojë certifikatën ISO sipas zërave te mallrave qe do te marre përsipër sipas akt-marrëveshjes.)

Ky operator nuk provohet ta ketë përmbushur këtë kërkesë, pasi:

Operatori ka paraqitur certifikatën ISO 9001:2015 të lëshuar nga kompania QEC CERTIFICATION,për ÷A÷ shpk, e përkthyer dhe noterizuar në gjuhën shqipe. Certifikuar më date 20.03.2019 dhe datë skadence 19.03.2022.

Nga verifikimi referuar Rekomandimit të Agjencisë së Prokurimit Publik nr. 3330 prot., datë 20.03.2018 dhe Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit nr. 145 prot., datë 16.03.2018, u konstatua se kompania QEC CERTIFICATION ne Angli është e akredituar ndërkombëtarisht, por kjo certifikatë me numër seri QEC 45827561/18/Q Rev:001 nuk është publikuar në faqen e kësaj kompanie, për pasojë është dokument i pabesueshëm për tu marre në konsideratë referuar rekomandimit të sipërpërmendur.

Raporti përmbledhës nga komisioni i vlerësimit është hartuar me nr. 1712/3 prot., datë 29.08.2019, raport i cili është miratuar nga Titullari i Autoritetit Kontraktor, ku ka shpallur fitues operatorin ekonomik ÷A÷ shpk me ofertë në vlerën 10,373,770 lekë (pa tvsh).Titullari i Autoritetit Kontraktor me vendimin nr.1712/4 prot. Datë 30.08.2019 ka vendosur shpalljen fitues te operatorin ekonomik ÷A÷ shpk me ofertë ekonomike në vlerën 10,373,770 lekë (pa tvsh).

Me shkresën nr.1712/5 datë 30.08.2019 Formular i Njoftimit te Fituesit.

Kontrata është lidhur me nr. 1712/6 prot., datë 06.09.2019, ndërmjet Shoqërisë Ujësjetllës Kanalizime Elbasan sha të përfaqësuar nga L. D. në cilësinë e Administratorit të Shoqërisë dhe operatorit/e shoqërisë òAö shpk në vlerën 12,448,524 lekë me TVSh, kohëzgjatja e kontratës është për një periudhë 15 ditë, nga data e nënshkrimit të kësaj kontrate.

Me shkresën nr.1712/7 datë 10.09.2019 Njoftimi i Kontratës.

Kualifikimi, shpallja fitues dhe lidhja e marrëveshjes e operatorit ekonomik òAö Shpk është kryer në kundërshtim me Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 òPër prokurimin publikò, i ndryshuar, neni 46, neni 53 pika 3, VKM nr. 914, datë 29.12.2014 òRregullat e Prokurimitò, i ndryshuar, neni 66 pika 3, Ligjin nr. 44/2015 òKodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisëò nenet 108-118.

Për sa trajtuar si më sipër ngarkohet me përgjegjësi KVO e përbërë A. M. dhe Ç. L. dhe N. H. Pavarësisht shkeljeve dhe parregullsive ligjore ose rregullatore të përmendur si më sipër, veprimet e mësipërme nga KVO janë kryer nga mos njohja/ose keqinterpretimi i legjislacionit specifik të procedurave të prokurimit dhe në veçanti atij të mallrave dhe nuk kanë krijuar asnjë pasojë financiare në dëm Institucionit, pasi operatori ekonomik òAö Shpk është operatori i vetëm i kualifikuar në këtë procedurë. Gjithsesi për shkeljet dhe parregullsitë e përmendura më lart, del më se e domosdoshme marrja e masave urgjente për të korrigjuar këtë praktikë në zhvillimin e proceduarve të prokurimit. Qëllimi i këtyre masave është jo vetëm ndreqja e gjendjes së shkeljeve dhe parregullsive, por edhe ndikimi me anë të efektit parandalues mbi punonjësit e tjerë të administratës, për të parandaluar për të ardhmen shkeljet e ligjeve.

5. Procedura e prokurimit me objekt “Blerje materiale hidraulike, viti 2020”.

1. Urdhër Prokurimi nr. 39 datë 21.02.2020	3. Njësia e prokurimit Urdhër nr. 272 prot. datë 21.02.2020 - L. D., me detyrë Shef dega ujësjetllës - I. S., me detyrë Juriste - N. H., me detyrë Përgjegjëse Finance	4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave Urdhër nr. 272/2 datë 21.02.2020 - G. P., me detyrë Inxhiner investimesh -A. M., me detyrë Drejtor Tregtar - R. H., me detyrë Përgjegjëse Koordinimi Projektsh
2. Lloji i Procedurës së Prokurimit òProcedurë e hapurò (mallra)		
5. Fondi Limit (pa tvsh) 34,965,390 lekë	6. Oferta fituese (pa tvsh) 34,581,080 lekë	7. Diferenca me fondin limit (pa tvsh) 384,310 (treqind e tetëdhjetë e katër mijë e treqind e dhjetë) lekë
8. Data e hapjes së tenderit 27.03.2020	9. Burimi Financimit Fond nga Buxheti i Shoqërisë	10. Operatorët Ekonomike a) Pjesëmarrës në tender Numër _4_OE b) Sòkualifikuar 3 OE, c) Kualifikuar _1_ OE
11. Ankimime Pranë AK - 1	12. Përgjigje Ankesës nga AK - 1	13. Përgjigje Ankesës nga Komisioni i Prokurimit Publik - nuk ka
b. Zbatimi i Kontratës të Mallrave		
14. Lidhja e kontratës nr. 272/9, datë 27.04.2020	15. Vlera e kontratës (me tvsh) 41,497,296 lekë	16. Afati i kontratës në dite 90 ditë nga nënshkrimi i kontratës

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion, si dhe aksesimit në sistemin e prokurimit elektronik (S.P.E.)të A.P.P, u konstatua se:

Fondi i këtij i këtij shpenzimi është akorduar nga të ardhurat e shoqërisë me vlerë 34,965,390 lekë.

Kjo procedurë është parashikuar në regjistrin e parashikimeve të prokurimeve publike të Shoqërisë òUjësjetllës Kanalizime Elbasanò Sh.a.

Me urdhër të Administratorit të Shoqërisë L. D. 39 datë 21.02.2020, është urdhëruar të kryhet prokurimi elektronik në vlerën 34,965,390 lekë, forma e prokurimit, prokurimi në mënyrë elektronike, lloji i procedurës së prokurimit ÷Procedurë e hapurë mallra.

Njësia e prokurimi e përbërë nga L. D., I. S., N. H.,.

Me urdhër të Administratorit të Shoqërisë L. D. nr. 4, datë 06.01.2020, është ngritur grupi i punës për argumentin e fondit limit, i përbërë nga M. T., A. K., M. R., E. B., A. N.

Me procesverbal të protokolluar datë 21.02.2020, grupi i përlllogaritjes së fondit limit i përbërë nga Majlinda Tafani, A. K., M. R., E. B., A. N. ka përcaktuar vlerën 34,965,390 lekë pa TVSH.

Pra, përlllogaritja e vlerës së kontratës është përcaktuar në vlerën 34,965,390 lekë, pas çmimit mesatar për çdo artikull të ofruar nga operatorët ekonomik ÷DBö Shpk në vlerën 4,441,750 lekë për njësi, materiale hidraulike, ÷H-Sö Shpk në vlerën 5,101,441 lekë për njësi, ÷Wö Shpk në vlerën 4,478,499 lekë për njësi.

Data e publikimit është 24.02.2020, afati për dorëzim të ofertave data 27.03.2020 ora 12.00.

- Hartimi i kërkesave të veçanta për kualifikim/specifikimet teknike.

Në pikën 2.2/1/2 të kriterëve të kualifikimit ÷Kapaciteti ekonomik dhe financiarë është përcaktuar se, operatorët duhet të paraqesin:

-Vërtetim nga Administrata Tatimore për xhiron mesatare të viteve 2016, 2017 dhe 2018, me një vlerë jo më të ulët se vlera e fondit limit.

-Pasqyrat financiare të 3 viteve të fundit (2016, 2017, 2018) të konfirmuara nga administrata tatimore.

Veprim në kundërshtim me shkresën Agjencisë së Prokurimit Publik (Drejtoria juridike dhe e Monitorimit), nr. 3341/1 prot., datë 20.03.2018, pasi nuk duhet përcaktuar që është realizuar gjatë tre viteve të fundit të veprimtarisë së operatorit, por të tre vitet e fundit nga data e zhvillimit të tenderit.

Për sa trajtuar si më sipër ngarkohet me përgjegjësi njësia e prokurimit e përbërë L. D., I. S., N. H.

Me urdhër nr. 272/2 datë 21.02.2020 të Administratorit të Shoqërisë L. D. është ngritur komisioni i vlerësimit të ofertave të përbërë nga G. P., me detyrë Inxhinier investimesh A. M., me detyrë Drejtor Tregtar, R. H., me detyrë Përgjegjëse Koordinimi Projektesh.

Zhvillimi i procedurës së prokurimit.

Në këtë procedurë prokurimi kanë marr pjesë operatorët ekonomik.

-÷Uö sh.p.k me ofertë në vlerën 28,172,445 lekë (pa tvsh).

-÷Aö shpk me ofertë në vlerën 34,581,080 lekë (pa tvsh).

-÷Rrö shpk me ofertë në vlerën 0 lekë (pa tvsh).

-÷Wö shpk me ofertë në vlerën 0 lekë (pa tvsh).

Pas vlerësimit të KVO u kualifikua dhe shpall fitues operatori ekonomik Aö shpk me ofertë në vlerën 34,581,080 lekë (pa tvsh) duke u kualifikuar operatorët ekonomik :

-÷M.ö sh.p.k me ofertë në vlerën 28,172,445 lekë (pa tvsh).

-÷Rrö shpk me ofertë në vlerën 0 lekë (pa tvsh).

-÷W.ö shpk me ofertë në vlerën 0 lekë (pa tvsh).

Në pikën 2.3/3/5 ÷Kapaciteti teknikë është përcaktuar:

-Operatori Ekonomik duhet të paraqesë certifikatën ISO 9001:2015 të vlefshme mbi ÷Sistemet e menaxhimit të cilësisë për mallrat objekt prokurimi të lëshuar nga kompani të cilat njihen nga institucionet zyrtare Shqiptare dhe që janë të akredituara. Për këtë OE duhet të paraqesë Certifikatën ISO dhe dokumentet përkatës që vërtetojnë akreditimin nga institucionet zyrtare Shqiptare.

-Prodhuesi i mallit duhet të jetë i çertifikuar për sistemin e menaxhimit të cilësisë me çertifikatë ISO 9001:2015 (Ose ekuivalent) për prodhimin e mallrave objekt prokurimi. Certifikata duhet të jete e vlefshme.

Ky operator nuk provohet ta ketë përmbushur këtë kërkesë, pasi:

Operatori ka paraqitur çertifikatën ISO 9001:2015 të lëshuar nga kompania D, për C shpk, e përkthyer dhe noterizuar në gjuhën shqipe. Certifikuar më date 20.03.2019 dhe datë skadence 19.03.2022.

Nga verifikimi referuar Rekomandimit të Agjencisë së Prokurimit Publik nr. 3330 prot., datë 20.03.2018 dhe Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit nr. 145 prot., datë 16.03.2018, u konstatua se kompania Q ne Angli është e akredituar ndërkombëtarisht, por kjo çertifikatë me numër seri Q 45827561/18/Q Rev:001 nuk është publikuar në faqen e kësaj kompanie, për pasojë është dokument i pabesueshëm për tu marre në konsiderate referuar rekomandimit të sipërpërmendur.

Raporti përmbledhës nga komisioni i vlerësimit është hartuar me nr. 272/6 prot., datë 14.04.2020, raport i cili është miratuar nga Titullari i Autoritetit Kontraktor, ku ka shpallur fitues operatorin ekonomik òA. Cò shpk me ofertë ekonomike në vlerën në vlerën 34,581,080 lekë (pa tvsh).

Titullari i Autoritetit Kontraktor me vendimin nr.272/7 prot. Datë 14.04.2020 ka vendosur shpalljen fitues te operatorin ekonomik òAò shpk me ofertë ekonomike në vlerën në vlerën 34,581,080 lekë (pa tvsh).

Me shkresën nr.272/8 prot. Datë 14.04.2020 formular i njoftimit te fituesit.

Kontrata është lidhur me nr.272/9 prot. Datë 27.04.2020, ndërmjet Shoqërisë Ujësjiellës Kanalizime Elbasan sha të përfaqësuar nga L. D. në cilësinë e Administratorit të shoqërisë dhe operatorit/e shoqërisë òAò shpk në vlerën 41,497,296 lekë me TVSh, kohëzgjatja e kontratës është për një periudhë 90 ditë, nga data e nënshkrimit të kësaj kontrate.

Me shkresën nr. 272/9 prot. Datë 28.04.2020 njoftimi i kontratës.

Kualifikimi, shpallja fitues dhe lidhja e marrëveshjes e operatorit ekonomik òAò shpk është kryer në kundërshtim me Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 òPër prokurimin publikò, i ndryshuar, neni 46, neni 53 pika 3, VKM nr. 914, datë 29.12.2014 òRregullat e Prokurimitò, i ndryshuar, neni 66 pika 3, Ligjin nr. 44/2015 òKodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisëò nenet 108-118.

Për sa trajtuar si më sipër ngarkohet me përgjegjësi KVO e përbërë nga G. P., A. M. dhe R. H.

6. Procedura e prokurimit me objekt “Instalimi i teknologjive të reja në stacionet e pompimit në sistemin Mengël-Samurr-Godolesh,(për zëvendësimin e pompave dhe pajisjeve viti 2019”.

1. Urdhër Prokurimi nr. 113 datë 20.08.2019	3. Njësia e prokurimit Urdhër nr. 1872 prot. datë 20.08.2019 - A. M., me detyrë Drejtor Tregtar - J. D., me detyrë Drejtor Teknik - I. S., me detyrë Juriste	4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave Urdhër nr. 1872/2 datë 20.08.2019 - G. P., me detyrë Ing. Investimesh - L. D., me detyrë Shef dega ujësjiellës - Ç. L., me detyrë Drejtor i Shërbimeve të Përgjithshme
2. Lloji i Procedurës së Prokurimit òProcedurë e hapurò (mallra)		
5. Fondi Limit (pa tvsh) 56,418,377,5 lekë	6. Oferta fituese (pa tvsh) 54,808,579,8 lekë	7. Diferenca me fondin limit (pa tvsh) 1,609,797,7 (një milion e gjashtëqind e nëntë mijë e shtatëqind e nëntëdhjetë e shtatë presje shtatë) lekë
8. Data e hapjes së tenderit 04.10.2019	9. Burimi Financimit Fond nga Buxheti i Shtetit ,dy vite financim	10. Operatorët Ekonomike a) Pjesëmarrës në tender Numër _2_OE b) Sòkualifikuar 1 OE, c) Kualifikuar _1_ OE
11. Ankimime Pranë AK - nuk ka	12. Përgjigje Ankesës nga AK - nuk ka	13. Përgjigje Ankesës nga Komisioni i Prokurimit Publik - nuk ka

b. Zbatimi i Kontratës të Mallrave		
14. Lidhja e kontratës nr. 1872/8, datë 08.11.2019	15. Vlera e kontratës (me tvsh) 61,797,051,1 lekë	16. Afati i kontratës në dite 45 ditë nga nënshkrimi i kontratës

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion, si dhe aksesimit në sistemin e prokurimit elektronik (S.P.E.) të A.P.P, u konstatua se:

Fondi i këtij shpenzimi është akorduar nga të ardhurat e shtetit me vlerë 56,418,377,5 lekë.

Kjo procedurë është parashikuar në regjistrin e parashikimeve të prokurimeve publike të Shoqërisë ÷Ujës-jellës Kanalizime Elbasanë Sh.a.

Me urdhër të Administratorit të Shoqërisë L. D. nr. 1872/prot, datë 20.08.2019, është urdhëruar të kryhet prokurimi elektronik në vlerën 56,418,377,5 lekë, forma e prokurimit, prokurimi në mënyrë elektronike, lloji i procedurës së prokurimit ÷Procedurë e hapurë mallra.

Njësia e prokurimi e përbërë nga J. D. me detyrë Drejtor Teknik, me profesion ing.hidro, A. M. me detyrë Drejtor Tregtar me profesion ekonomiste, dhe I. S. me detyrë Juriste me profesion juriste.

Në pikën 2.3.8, të kriterëve të kualifikimit ÷Kapaciteti teknik, operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të ketë në listë pagesë mjekun e shoqërisë për periudhën Janar 2019 ÷Korrik 2019, kontratë pune noteriale, diplome, licencë /Urdhër Mjeku. Në rast bashkimi operatorësh secili nga operatorët duhet ta plotësojë këtë kusht.

Veprim i cili është në kundërshtim me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 108, datë 09.02.2011, ÷Për aftësitë që duhet të plotësojnë punëmarrësit, personat dhe shërbimet e specializuara, që merren me çështjet e sigurisë dhe të shëndetit në punë, i ndryshuar, sipas të cilit, shërbimet mjekësore për punëmarrësin, mund të sigurohen jo vetëm me anë të mjekut të punësuar, por edhe me anë të marrëdhëniesve kontraktore me persona apo subjekte të specializuara për këtë qëllim.

Në pikën 2.3.1 të kriterëve të kualifikimit ÷Kapaciteti teknik, Operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet Stafit Teknik i Shoqërisë të ketë në përbërje : Inxhinier Hidroteknik 1; Inxhinier Ndërtim 1; Inxhinier Mjedisi 1; Inxhinier Mjedisi ose Profili Energjitike 1 (i/e pajisur me certifikatë të lëshuar nga Ministria e Mjedisit; Inxhinier Mekanik 1; Inxhinier Elektrik ose Elektronik 1;

Secili prej pjesëtareve të stafit teknik të mësipërm, duhet jetë i pasqyruar në licencën e shoqërisë dhe listëpagesat të paktën 6(gjashtë) muajt e fundit. Për inxhinieret e mësipërm duhet të paraqitet:

Kontrate pune noteriale e vlefshme; Cv; Diplomë dhe Libreze pune.

Këto kriterë janë të ekzagjeruara dhe të pa argumentuara, pasi: Zotësia profesionale e operatorëve ekonomik është e ezauruar në kategoritë e zërave të punimeve të kërkuara si:

NP-1 A (Punime gërmimi në toke);

NP-7 C (Ujës-jellës, gazsjellës, vajsjellesa, vepra kullimi e vaditje);

NS-4 A (Punime rifiniture të nuraturës dhe të lidhura me to, rifiniture me materiale druri, plastik, metalik dhe xhami, dhe rifiniture të natyrës teknike ndërtuese);

NS- 8 A (Ndërtime parafabrikat beton arme, struktura metalike dhe druri);

NS-9 A (Punime strukturore speciale)

NS-16 A (Ndërtim i impianteve të ujit të pijshëm dhe pastrimit të tij)

NS-18 A (Punime topogjeodezike)

Në opinionin e grupit të auditimit, referuar sa më sipër licenca që operatori ekonomik disponon dhe paraqet, janë dëshmia se ai është vlerësuar nga institucionet e autorizuar me ligj, se disponon kapacitetet dhe eksperiencën e mjaftueshme (edhe të drejtuesve teknik) për të kryer punimet e specifikuar në formularin e licencës që disponon, dhe për rrjedhim plotësimi i kërkesave të vendosura nga autoritetet kontraktorë në lidhje me kategoritë dhe klasifikimet respektive që licencat profesionale duhet të përmbajnë, është kusht i mjaftueshëm për autoritetin kontraktor.

Veprime në kundërshtim me nenin 46, të Ligjit nr. 9643, datë 20.11.2009 òPër Prokurimin Publikò, i ndryshuar, dhe VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publikò, i ndryshuar, neni 26, pika 5, si dhe Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 42, datë 16.01.2008 òPër miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimiò, kreu III, pika 1/a, ku është shprehur në mënyrë eksplicite se:

"1. Kategorizimi dhe klasifikimi i licencës,

a) Licenca është dokument juridik e profesional, që i jep të drejtë disponuesit të saj të ushtrojë veprimtari të caktuar, sipas:

I. Kategorive të punimeve të zbatimit duke u mbështetur në:

- profilin e diplomës universitare të individëve që punësohen në rolin e drejtuesit teknik të shoqërisë.

Autoriteti Kontraktor, duhet të hartojë kërkesa të veçanta për kualifikim/specifikimet teknike, që të sigurojë transparencë, trajtim të barabartë të gjithë operatorët ekonomikë të interesuar në kontratat publike, mos diskriminim dhe konkurrencë. Kërkesat/specifikimet teknike duhet të jenë të shkruara në mënyrë të tillë që të argumentohet nevoja që dikton vendosjen e këtyre kriterëve, duke parandaluar në këtë mënyrë para përzgjedhjen paraprake të kandidatit fitues, në zbatim me parimet dhe dispozitat urdhëruese të kuadrit ligjor që rregullon prokurimin publik.

Në pikën 2.3 të DT, është kërkuar që është kërkuar mjek 1, referuar VKM Nr. 742, datë 6.11.2003 "Për masat e veçanta të sigurimit dhe të mbrojtjes së shëndetit në punë" të vërtetuar me kontratë noteriale pune, diplomë, license lëshuar nga sipas urdhrat të mjekut, të jete i përfshirë në listëpagesë.

Veprim i cili është në kundërshtim me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 108, datë 09.02.2011, òPër aftësitë që duhet të plotësojnë punëmarrësit, personat dhe shërbimet e specializuara, që merren me çështjet e sigurisë dhe të shëndetit në punëò, i ndryshuar, sipas të cilit, shërbimet mjekësore për punëmarrësin, mund të sigurohen jo vetëm me anë të mjekut të punësuar, por edhe me anë të marrëdhënive kontraktore me persona apo subjekte të specializuara për këtë qëllim.

Me urdher të Administratorit të Shoqërisë L. D. nr. 1872/2, datë 20.08.2019, është ngritur komisioni i vlerësimit të ofertave i përbërë nga G. P., me detyrë ing. investimesh, me profesion ing. hiro, L. D., me detyrë shef dega ujësjellës me profesion ing. ndërtimi, Ç. L., me detyrë drejtor i shërbimeve të përgjithshme me profesion ekonomist.

Data e publikimit është 21.08.2019, afati për dorëzim të ofertave data 04.10.2019 ora 11.00.

- Hartimi i kërkesave të veçanta për kualifikim/specifikimet teknike.

Shkelja e dispozitave ligjore të përmendur më sipër ngarkon me përgjegjësi njësinë e prokurimit të përbërë nga A. M., J. D. dhe I. S.

Zhvillimi i procedurë së prokurimit.

Në këtë procedurë prokurimi kanë marr pjesë operatorët ekonomik.

-òNò sh.p.k me ofertë në vlerën 54,808,579,8 lekë (pa tvsh).

-òMò sh.p.k me ofertë në vlerën 0 lekë (pa tvsh).

Pas vlerësimit të KVO u kualifikua dhe shpall fitues operatori ekonomik òNò sh.p.k me ofertë në vlerën 54,808,579,8 lekë (pa tvsh) duke skualifikuar operatori ekonomik òM. G.ò shpk me ofertë në vlerën 0 lekë (pa tvsh).

Raporti përmbledhës nga komisioni i vlerësimit është hartuar me nr. 1872/5 prot., datë 29.10.2019, raport i cili është miratuar nga Titullari i Autoritetit Kontraktor, ku ka shpallur fitues operatorin ekonomik òNò sh.p.k me ofertë ekonomike në vlerën 54,808,579,8 lekë pa TVSH.

Titullari i Autoritetit Kontraktor me vendimin nr.1872/6 prot. Datë 30.10.2019 ka vendosur shpalljen fitues te operatorin ekonomik òNò sh.p.k me ofertë ekonomike në vlerën 54,808,579,8 lekë pa TVSH.

Me shkresën nr.1872/7 datë 30.10.2019 është bërë formular i njoftimit te fituesit.

Kontrata është lidhur me nr. 1872/8 prot., datë 08.11.2019, ndërmjet Shoqërisë Ujësjiellës Kanalizime Elbasan sha të përfaqësuar nga L. D. në cilësinë e Administratorit të shoqërisë dhe operatorit/e shoqërisë òNò sh.p.k në vlerën 54,808,579,8 lekë pa TVSH, kohëzgjatja e kontratës është për një periudhë 45 ditë, nga data e nënshkrimit të kësaj kontrate.

Me shkresën nr.1872/9 datë 13.11.2019 është bërë njoftimi i kontratës.

Nuk është siguruar kontrata për humbje ose dëmtim të punimeve, pajisjeve, materialeve, humbje ose dëmtim të kantierit ose pronave të tjera në kantier dhe dëmtimet personale ose vdekjet e palëve të treta, si dhe deri në datën e hartimit të këtij konstatimi Autoriteti Kontraktor, nuk ka zgjatur periudhën e paraqitjes të policës së sigurimit ose nuk ka bërë vet siguracionin dhe të zbresi koston e tij nga pagesa që i jep kontraktorit.

Veprim në kundërshtim me neni 25 të kontratës së lidhur, pika 1 dhe 2, ku është shprehur në mënyrë eksplicite se :

ò25.1 Kontraktori duhet të sigurojë objektin, me emra të përbashkët të Autoritetit Kontraktor dhe kontraktorit, nga data e hyrjes në kantier deri në afatin e realizimit të plote, në shumatat e shprehura në KVK për humbje ose dëmtim të punimeve, pajisjeve, materialeve; humbje ose dëmtim të kantierit ose pronave të tjera në kantier dhe dëmtimet personale ose vdekjet e palëve të treta.

25.2 Polica e sigurimit do të dorëzohet tek drejtuesi i projektit për aprovim brenda 30 ditëve pas shpalljes së fituesit të kontratës. Ky siguracion duhet të mbulojë kompensimin e kërkuar për të kompensuar humbjen ose dëmin e shkaktuar. Nëse kontraktori dështon të sigurojë policën e sigurimit, kontrata do të konsiderohet e anuluar. Megjithatë, Autoriteti Kontraktor, mund të vendosë të zgjasë periudhën e paraqitjes të policës së sigurimit ose të bëjë vetë siguracionin dhe të zbresi koston e tij nga pagesa që i jep kontraktonitò.

Shkelja e dispozitave ligjore të përmendur më sipër ngarkon me përgjegjësi L. D. me detyrë ish-administrator.

7. Proçedura e prokurimit me objekt “Rikonstruksion i rrjetit të brendshëm ekzistues të linjave në rrugët “11 Nëntori”,rruga “Ali Çausi”,rruga “Faik Neziri”,rruga “ Veli Stafa”,një pjesë të lagjes “Çlirimi”dhe “11 Nëntori” të Bashkisë Elbasan, viti 2019”.

1. Urdhër Prokurimi nr. 114 datë 20.08.2019	3. Njësia e prokurimit Urdhër nr. 1873 prot. datë 20.08.2019 - A. M., me detyrë Drejtor Tregtar - J. D.,me detyrë Drejtor Teknik - I. S.,me detyrë Juriste	4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave Urdhër nr. 1873/2 datë 20.08.2019 - G. P., me detyrë Ing.Investimesh - L. D., me detyrë Shef dega ujësjiellës - Ç. L.,me detyrë Drejtor i Shërbimeve të Përgjithshme
2. Lloji i Procedurës së Prokurimit òProcedurë e hapurò (punë)		
5. Fondi Limit (pa tvsh) 23,002,330 lekë	6. Oferta fituese (pa tvsh) 22,473,891 lekë	7. Diferenca me fondin limit (pa tvsh) 528,439 (pesëqind e njëzet e tetë mijë e katërqind e tridhjetë e nëntë) lekë
8. Data e hapjes së tenderit 30.09.2019	9. Burimi Financimit Fond nga Buxheti i Shtetit ,dy vite	10. Operatorët Ekonomike a) Pjesëmarrës në tender Numër _2_ OE

	financim	b) Sekualifikuar 1 OE, c) Kualifikuar <u>1</u> OE
11. Ankimime Pranë AK - nuk ka	12. Përgjigje Ankesës nga AK - nuk ka	13. Përgjigje Ankesës nga Komisioni i Prokurimit Publik - nuk ka
b. Zbatimi i Kontratës të Mallrave		
14. Lidhja e kontratës nr. 1873/9, datë 30.10.2019	15. Vlera e kontratës (me tvsh) 26,968,676,4 lekë	16. Afati i kontratës në dite 60 ditë nga nënshkrimi i kontratës

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion, si dhe aksesimit në sistemin e prokurimit elektronik (S.P.E.) të A.P.P, u konstatua se:

Fondi i këtij shpenzimi është akorduar nga të ardhurat e shtetit me vlerë 23,002,330 lekë.

Kjo procedurë është parashikuar në regjistrin e parashikimeve të prokurimeve publike të Shoqërisë ÷ Ujësjiellës Kanalizime Elbasanë Sh.a.

Me kërkesë datë 14.06.2019 të L. D. me detyrë inxhinierë, ka bërë detyrë projektimi.

Me urdhër të Administratorit të Shoqërisë L. D. nr. 1873 prot, datë 20.08.2019, është urdhëruar të kryhet prokurimi elektronik në vlerën 23,002,330 lekë, forma e prokurimit, prokurimi në mënyrë elektronike, lloji i procedurës së prokurimit ÷ Procedurë e hapurë punë.

Njësia e prokurimi e përbërë nga J. D. me detyrë Drejtor Teknik, me profesion ing. hidro, A. M. me detyrë drejtor tregtar me profesion ekonomiste, dhe I. S. me detyrë juriste me profesion juriste.

Në pikën 2.3.1 të kriterëve të kualifikimit ÷ Kapaciteti teknikë, Operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet Stafit Teknik i Shoqërisë të ketë në përbërje : Inxhinier Hidroteknik 1; Inxhinier Ndërtim 1; Inxhinier Mjedisi 1; Inxhinier Mekanik 1; Inxhinier topograf 1; Secili prej pjesëtareve të stafit teknik të mësipërm, duhet jetë i pasqyruar në Licencën e Shoqërisë dhe Listëpagesat te paktën 6(gjashte) muajt e fundit. Për inxhinieret e mësipërm duhet te paraqitet:

Kontrate pune noteriale e vlefshme; Cv; Diplomë dhe Libreze pune.

Këto kriterë janë të ekzagjeruar dhe të pa argumentuara, pasi: Zotësia profesionale e operatorëve ekonomik është e ezauruar në kategoritë e zërave të punimeve të kërkuara si:

NP-1 A (Punime gërmimi ne toke);

NP-7 C (Ujësjiellës, gazsjellës, vajsjellesa, vepra kullimi e vaditje);

NS- 8 A (Ndërtimi parafabrikat beton arme, struktura metalike dhe druri);

NS-9 A (Punime strukturore speciale)

NS-18 A (Punime topogjeodezike)

Në opinionin e grupit të auditimit, referuar sa më sipër licenca që operatori ekonomik disponon dhe paraqet, janë dëshmia se ai është vlerësuar nga institucionet e autorizuara me ligj, se disponon kapacitetet dhe eksperiencën e mjaftueshme (edhe të drejtuesve teknik) për të kryer punimet e specifikuar në formularin e licencës që disponon, dhe për rrjedhim plotësimi i kërkesave të vendosura nga autoritetet kontraktorë në lidhje me kategoritë dhe klasifikimet respektive që licensat profesionale duhet të përmbajnë, është kusht i mjaftueshëm për autoritetin kontraktor.

Veprime në kundërshtim me nenin 46, të Ligjit nr. 9643, datë 20.11.2009 ÷ Për Prokurimin Publikë, i ndryshuar, dhe VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publikë, i ndryshuar, neni 26, pika 5, si dhe Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 42, datë 16.01.2008 ÷ Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licensave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi, kreu III, pika 1/a, ku është shprehur në mënyrë eksplicite se:

"1. Kategorizimi dhe klasifikimi i licencës,

a) Licenca është dokument juridik e profesional, që i jep të drejtë deponuesit të saj të ushtrijë veprimtari të caktuar, sipas:

I. Kategorive të punimeve të zbatimit duke u mbështetur në:

- profilin e diplomës universitare të individëve që punësohen në rolin e drejtuesit teknik të shoqërisë.

Në pikën 2.3.8 të DT, është kërkuar që të ketë ne liste pagesë mjekun e shoqërisë për periudhën Janar 2019 óKorrik 2019, kontrate pune noteriale, diplome, licence /Urdhër Mjeku. Ne rast bashkimi operatorësh secili nga operatorët duhet ta plotësojë këtë kusht.

Veprim i cili është në kundërshtim me Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 108, datë 09.02.2011, óPër aftësitë që duhet të plotësojnë punëmarrësit, personat dhe shërbimet e specializuara, që merren me çështjet e sigurisë dhe të shëndetit në punë, i ndryshuar, sipas të cilit, shërbimet mjekësore për punëmarrësin, mund të sigurohen jo vetëm me anë të mjekut të punësuar, por edhe me anë të marrëdhënieve kontraktore me persona apo subjekte të specializuara për këtë qëllim.

Në pikën 2.3 óKapaciteti teknikó është kërkuar që të ketë fabrike asfalti e pajisur me leje mjedisore; Për impiantin e prodhimit të asfaltobetonit duhet të paraqesë plan vendosjen dhe projektin teknologjik.

a) Linja e prodhimit të Inerteve dhe Impianti i Prodhimit të Asfaltobetonit duhet të ketë një largësi jo më shumë se 25 km nga vendi i punimeve të këtij projekti. Operatori ekonomik duhet të deklarojë vendndodhjen e saktë të Impiantit, të paraqesë planin e vendosjes dhe fotografi të Impiantit. (referuar përcaktimeve të VKM 628 datë 15.07.2015).

Për impiantin e prodhimit të Inerteve operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë raport testimet për materialet si më poshtë:

- Raport Testim të Materialeve Inerte Granil, Metoda e Testimit S SH EN 933- 1; 2012. Metoda e Testimit S SH EN 933- 1; 2012

-Raport Testimi të materialeve Inerte Rërë e Lare Metoda e Testimit S SH EN 933- 1; 2012. Metoda e Testimit S SH EN 933- 1; 2012.

- Testimet e mësipërme duhet të jene nga Laborator i akredituar konform S SH ISO/EN 17025;2006

Raport i testeve duhet të jete sipas standarteve në fuqi bazuar në ligjin Nr.9290 date 07/10/2004 óPër Produktet e Ndërtimitó.

Kërkesë e ekzagjeruar, veprim në kundërshtim me nenin 46, të Ligjit nr. 9643, datë 20.11.2009 óPër Prokurimin Publikó, i ndryshuar, dhe VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publikó, i ndryshuar, neni 26, pika 5.

Autoriteti Kontraktor, duhet të hartojë kërkesa të veçanta për kualifikim/specifikimet teknike, që të sigurojë transparencë, trajtim të barabartë të gjithë operatorët ekonomikë të interesuar në kontratat publike, mos diskriminim dhe konkurrencë. Kërkesat/specifikimet teknike duhet të jenë të shkruara në mënyrë të tillë që të argumentohet nevoja që dikton vendosjen e këtyre kriterëve, duke parandaluar në këtë mënyrë para përzgjedhjen paraprake të kandidatit fitues, në zbatim me parimet dhe dispozitat urdhëruese të kuadrit ligjor që rregullon prokurimin publik.

Shkelja e dispozitave ligjore të përmendur më sipër ngarkon me përgjegjësi njësinë e prokurimit të përbërë nga A. M., J. D. dhe I. S.

Me urdhër të Administratorit të Shoqërisë L. D. nr. 1872/2, datë 20.08.2019, është ngritur komisioni i vlerësimit të ofertave të përbërë nga G. P., me detyrë ing. investimesh, me profesion ing. hiro, L. D., me detyrë shef dega ujësjellës me profesion ing. ndërtimi, Ç. L., me detyrë drejtor i shërbimeve të përgjithshme me profesion ekonomist.

Data e publikimit është 21.08.2019, afati për dorëzim të ofertave data 04.10.2019 ora 11.00.

- Hartimi i kërkesave të veçanta për kualifikim/specifikimet teknike.

Me urdhër të Administratorit të Shoqërisë L. D. nr. 1873/2, datë 20.08.2019, është ngritur komisioni i vlerësimit të ofertave i përbërë nga ó G. P., me detyrë ing. investimesh, me profesion ing. hiro, L. D., me detyrë shef dega ujësjellës me profesion ing. ndërtimi, Ç. L., me detyrë drejtor i shërbimeve të përgjithshme me profesion ekonomist.

Data e publikimit është 22.08.2019, afati për dorëzim të ofertave data 30.09.2019 ora 12.00.

- Hartimi i kërkesave të veçanta për kualifikim/specifikimet teknike.

Zhvillimi i procedurë së prokurimit.

Në këtë procedurë prokurimi kanë marr pjesë operatorët ekonomik.

- òNò sh.p.k me ofertë në vlerën 22,473,891 lekë (pa tvsh).

- òDò shpk dhe Z sh.p.k me ofertë në vlerën 20,278,329,4lekë (pa tvsh).

Pas vlerësimit të KVO u kualifikua dhe shpall fitues operatori ekonomik òNò sh.p.k me ofertë në vlerën 22,473,891 lekë (pa tvsh) duke u sækualifikuar operatori ekonomik òDò shpk & òZò sh.p.k me ofertë në vlerën 20,278,329,4 lekë (pa tvsh).

Raporti përmbledhës nga komisioni i vlerësimit është hartuar me nr. 1873/6 prot., datë 21.10.2019, raport i cili është miratuar nga Titullari i Autoritetit Kontraktor, ku ka shpallur fitues operatorin ekonomik òNò sh.p.k me ofertë ekonomike në vlerën 22,473,891 lekë pa TVSH
Titullari i Autoritetit Kontraktor me vendimin nr.1873/7 prot. Datë 21.10.2019 ka vendosur shpalljen fitues te operatorin ekonomik òNò sh.p.k me ofertë ekonomike në vlerën 22,473,891 lekë pa TVSH.

Me shkresën nr.1873/8 datë 22.10.2019 formular i njoftimit te fituesit.

Kontrata është lidhur me nr. 1873/9 prot., datë 30.10.2019, ndërmjet Shoqërisë Ujësjaellës Kanalizime Elbasan sha të përfaqësuar nga L. D. në cilësinë e Administratorit të shoqërisë dhe operatorit/e shoqërisë òNò sh.p.k në vlerën 26,968,676,4 lekë me TVSH, kohëzgjatja e kontratës është për një periudhë 60 ditë, nga data e nënshkrimit të kësaj kontrate.

Me shkresën nr.1873/10 datë 31.10.2019 Njoftimi i Kontratës.

-Nuk është siguruar kontrata për humbje ose dëmtim të punimeve, pajisjeve, materialeve, humbje ose dëmtim të kantierit ose pronave të tjera në kantier dhe dëmtimet personale ose vdekjet e palëve të treta, si dhe deri në datën e hartimit të këtij konstatimi Autoriteti Kontraktor, nuk ka zgjatur periudhën e paraqitjes të policës së sigurimit ose nuk ka bërë vet siguracionin dhe të zbresi koston e tij nga pagesa që i jep kontraktorit.

Veprim në kundërshtim me neni 25 të kontratës së lidhur, pika 1 dhe 2, ku është shprehur në mënyrë eksplicite se

ò25.1 Kontraktori duhet të sigurojë objektin, me emra të përbashkët të Autoritetit Kontraktor dhe kontraktorit, nga data e hyrjes në kantier deri në afatin e realizimit të plote, në shumat e shprehura në KVK për humbje ose dëmtim të punimeve, pajisjeve, materialeve; humbje ose dëmtim të kantierit ose pronave të tjera në kantier dhe dëmtimet personale ose vdekjet e palëve të treta.

25.2 Polica e sigurimit do të dorëzohet tek drejtuesi i projektit për aprovim brenda 30 ditëve pas shpalljes së fituesit të kontratës. Ky siguracion duhet të mbulojë kompensimin e kërkuar për të kompensuar humbjen ose dëmin e shkaktuar. Nëse kontraktori dështon të sigurojë policën e sigurimit, kontrata do të konsiderohet e anuluar. Megjithatë, Autoriteti Kontraktor, mund të vendosë të zgjasë periudhën e paraqitjes të policës së sigurimit ose të bëjë vetë siguracionin dhe të zbresi koston e tij nga pagesa që i jep kontraktontit.

Shkelja e dispozitave ligjore të përmendur më sipër ngarkon me përgjegjësi Luan dervishi me detyrë ish-administrator.

8. Procedura e prokurimit me objekt "Sherbimi i ruajtjes me roje fizike i objekteve të sha. Ujësjellës Kanalizime Elbasan".

1. Urdhër Prokurimi nr. 374 datë 09.11.2021	3. Njësia e prokurimit Urdhër nr. 3429 prot. datë 09.11.2021 - O. D., me detyrë Drejtor Juridik - P. A., me detyrë Drejtor Burimeve Njerzore - A. T. ,me detyrë inxhinier	4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave Urdhër nr. 83/1 datë 29.01.2021 - J. D., me detyrë zv.Administrator - E. D., me detyrë Përgjegjëse Sektori Koordinimit - L. C., me detyrë Përgjegjës Finance
2. Lloji i Procedurës së Prokurimit oProcedurë e hapurë (shërbime) Marrëveshje Kuadër		
5. Fondi Limit (pa tvsh) 38,601,321,85 lekë	6. Oferta fituese (pa tvsh) 38,065,348,44 lekë	7. Diferenca me fondin limit (pa tvsh) 535,973,4 (pesëqind e tridhjetë e pesë mijë e nëntëqind e shtatëdhjetë e tre presje katër) lekë
8. Data e hapjes së tenderit 01.12.2021	9. Burimi Financimit Fond nga Buxheti i Shoqërisë	10. Operatorët Ekonomike a) Pjesëmarrës në tender Numër _2_OE b) S kualifikuar 1 OE, c) Kualifikuar ___1__ OE
11. Ankimime Pranë AK - nuk ka	12. Përgjigje Ankesës nga AK - nuk ka	13. Përgjigje Ankesës nga Komisioni i Prokurimit Publik - nuk ka
b. Zbatimi i Kontratës të Mallrave		
14. Lidhja e kontratës nr. 3429/6, datë 06.01.2022	15. Vlera e kontratës (me tvsh) 45,678,418,08 lekë	16. Afati i kontratës në dite 12 muaj nga nënshkrimi i kontratës

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion, si dhe aksesimit në sistemin e prokurimit elektronik (S.P.E.) të A.P.P, u konstatua se:

Fondi i këtij i këtij shpenzimi është akorduar nga të ardhurat e shoqërisë me vlerë 38,601,321,85 lekë.

Kjo procedurë është parashikuar në regjistrin e parashikimeve të prokurimeve publike të Shoqërisë oUjësjellës Kanalizime Elbasanö Sh.a.

Me kërkesë datë 02.11.2021 të J. D. me detyrë zv.Administrator, ka bërë kërkesë për roje ne objektet e prodhimit.

Me urdhër të Administratorit të Shoqërisë L. K. nr. 3429, datë 09.11.2021, është urdhëruar të kryhet prokurimi elektronik në vlerën 38,601,321,85 lekë, forma e prokurimit, prokurimi në mënyrë elektronike, lloji i procedurës së prokurimit oProcedurë e hapurë shërbime Marrëveshje Kuadër.

Njësia e prokurimi e përbërë nga O. D., me detyrë Drejtor Juridik, me profesion juriste, P. A., me detyrë Drejtor Burimeve Njerëzore dhe A. T. ,me detyrë inxhinier me profesion inxhinier ndryshuar me urdhrin nr. 3429/2, datë 15.12.2021 shtuar S. K. me detyrë juriste, me profesion juriste për shkak të largimit nga detyra të O. D.

Me urdhër të Administratorit të Shoqërisë L. K. nr. 3429/1, datë 09.11.2021, është ngritur komisioni i vlerësimit të ofertave i përbërë nga J. D. me detyrë inxhinier, me profesion inxhinier hidro, E. D., me detyrë Përgjegjëse Sektori Koordinimit me profesion ekonomist L. C., me detyrë Përgjegjës Finance me profesion ekonomist.

Data e publikimit është 10.11.2021, afati për dorëzim të ofertave data 01.12.2021 ora 10.00.

- Hartimi i kërkesave të veçanta për kualifikim/specifikimet teknike.

Proçesverbali datë 09.11.2021 i njësisë së prokurimit e përbërë nga të firmosur nga njësia e prokurimit e O. D., P. A. dhe A. T. , ku të jenë miratuar dokumentet e tenderimit (D.T.)

Në pikën 3,të kriterëve të kualifikimit o2.2/1/2 oKapaciteti ekonomik dhe financiarë është përcaktuar se, operatorët duhet të paraqesin:

i. Kopje të deklaratave të xhiros për tre viteve te fundit (2018, 2019, 2020), ku vlera e xhiros ne te paktën njërin prej tre viteve, te jete jo me e vogël se 100 % të fondit total limit te marrëveshjes kuadër.

ii. Kopje te vërtetuar te bilanceve, te audituara nga ekspertet kontabël te licencuar, te konfirmuara nga autoritetet përkatëse te Administratës Tatimore, te tre viteve te fundit (2018, 2019, 2020) ku te paktën ne dy bilancet e njëpasnjëshme, nuk ka raport negative ndërmjet aktivitet dhe pasivit. Akt Ekspertiza e Ekspertit Kontabël te Autorizuar, duhet te paraqitet nga Operatori Ekonomik vetëm ne rastet kur janë ne kushtet e përcaktuara nga neni 41, germa e ligjit nr. 10091, date 05.03.2009 për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar (i ndryshuar).

Veprim në kundërshtim me shkresën Agjencisë së Prokurimit Publik (Drejtoria juridike dhe e Monitorimit), nr. 3341/1 prot., datë 20.03.2018, pasi nuk duhet përcaktuar që është realizuar gjatë tre viteve të fundit të veprimtarisë së operatorit, por të tre vitet e fundit nga data e zhvillimit të tenderit.

Shkelja e dispozitave ligjore të përmendur më sipër ngarkon me përgjegjësi njësinë e prokurimit të përbërë nga O. D., P. A. dhe A. T.

Zhvillimi i procedurë së prokurimit.

Në këtë procedurë prokurimi kanë marr pjesë operatorët ekonomik.

- ÷Uö sh.p.k me ofertë në vlerën 38,065,348,44 lekë (pa tvsh).

Pas vlerësimit të KVO u kualifikua dhe shpall fitues operatori ekonomik - ÷Uö sh.p.k me ofertë në vlerën 38,065,348,44 lekë (pa tvsh).

Raporti përmbledhës nga komisioni i vlerësimit është hartuar me nr. 3429/3 prot., datë 10.01.2022, raport i cili është miratuar nga Titullari i Autoritetit Kontraktor, ku ka shpallur fitues operatorin ekonomik ÷Uö sh.p.k me ofertë ekonomike në vlerën 38,065,348,44 lekë pa TVSH.

Titullari i Autoritetit Kontraktor me vendimin nr. 3429/4 prot., datë 10.01.2022 ka vendosur shpalljen fitues te operatorin ekonomik ÷Uö sh.p.k me ofertë ekonomike në vlerën 38,065,348,44 lekë pa TVSH.

Me shkresën nr.3429/5 datë 31.12.2021, formular i njoftimit te fituesit.

Marrëveshja Kuadër është lidhur me nr. 3429/6 prot., datë 06.01.2022, ndërmjet Shoqërisë Ujësjiellës Kanalizime Elbasan sha të përfaqësuar nga L. K. në cilësinë e Administratorit të shoqërisë dhe operatorit/e shoqërisë ÷Uevi-2015ö sh.p.k në vlerën 45,678,418,08 lekë me TVSh, kohëzgjatja e kontratës është për një periudhë 12 muaj.

Kontrata është lidhur me nr. 3429/7 prot., datë 06.01.2022, ndërmjet Shoqërisë Ujësjiellës Kanalizime Elbasan sha të përfaqësuar nga L. K. në cilësinë e Administratorit të Shoqërisë dhe operatorit/e shoqërisë ÷Uö sh.p.k në vlerën 45,678,418,08 lekë me TVSh, kohëzgjatja e kontratës është për një periudhë 12 muaj.

Me shkresën nr. 3429/8 prot., datë 06.01.2022 është bërë njoftimi i kontratës.

1. Titulli i gjetjes:	Nuk dokumentohet plotësisht marrja në dorëzim të materialeve sipas kontratës nr. 83/6 prot., datë 23.03.2021, nga një grup pune, sipas specifikimeve teknike të vendosura nga Autoriteti Menaxhues.
Situata:	Nga auditimi i zbatimit të kontratës nga Shoqëria ÷Aö shpk, me objekt ÷Materialet hidraulike, në vlerën 40,771,612 lekë, viti 2021, u konstatua se dokumentacioni teknik dhe ligjor i blerjes së materialeve, nuk është i plotë dhe i saktë. Konkretisht pajisjet nuk janë të shoqëruara me test raport fabrike, si dhe Operatori ka paraqitur çertifikatën ISO 9001:2015 të

	<p>lëshuar nga kompania Q, për Shoqërinë òAò shpk, e përkthyer dhe noterizuar në gjuhën shqipe, çertifikuar më date 01.07.2018 dhe datë skadence 30.06.2021.</p> <p>Nga verifikimi, referuar Rekomandimit të Agjencisë së Prokurimit Publik nr. 3330 prot., datë 20.03.2018 dhe Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit nr. 145 prot., datë 16.03.2018, u konstatua se kompania Q në Angli është e akredituar ndërkombëtarisht, por kjo çertifikatë me numër seri 30675457/72/Q Rev:001, nuk është publikuar në faqen e kësaj kompanie, për pasojë është dokument i pabesueshëm për tu marrë në konsiderate referuar rekomandimit të sipërpërmendur.</p> <p>Për pasojë grupi i auditimit nuk mund të shprehet për saktësinë dhe vërtetësinë e materialet hidraulike. Pra nuk mund të bëhet verifikimi i specifikimeve teknike (që janë pjesë e kontratës) dhe të dhënat e test raportit të fabrikës, që të konfirmohet që këto pajisje janë të njëjta me ato të prokuruar (specifikimeve teknike), dhe për të cilën Shoqëria òAò shpk ka fituar tenderin dhe është likuiduar. Në këto kushte grupi i auditimit nuk mund të japë opinionin e tij, për zbatimin e kontratës në cilësi dhe brenda standardeve të kërkuara dhe të konfirmojë që këto pajisje janë të njëjta me ato të prokuruar.</p>
Kriteri:	<p>Ligji nr. 9643, datë 20.11.2006 òPër prokurimin publikò, i ndryshuar, neni 60, pika 1.</p> <p>- Ligji nr. 7850, datë 29.07.1994 òKodi Civil i Republikës së Shqipërisëò, neni 419, 420, neni 659, 698 dhe neni 690.</p> <p>-Udhëzimi e Ministrisë Financave nr. 30 datë 27.12.2011, òPër menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publikò, i ndryshuar me nr. 20, datë 17.11.2014 pika 35.</p> <p>- Ligji nr. 10,489 datë 15.12.2011 òPër trajtimin dhe mbikëqyrjen e tregut të produkteve jo ushqimoreò, neni 3 pika 11, 12, 16, 17, 18, 21 neni 8 , neni 9 dhe neni 10.</p>
Ndikimi/Efekti:	Risk për keq menaxhim të fondeve publike.
Shkaku:	Keq interpretime të akteve ligjore dhe rregullatore të zbatimit të kontratave të mallrave (materialeve hidraulike).
Rëndësia:	E Lartë
Rekomandimi:	<p>- Nga Administratori i Shoqërisë të merren masa të menjëhershme për ngritjen e një grupi teknik me specialistë të fushës (përfshirë ata që kanë qenë pjesë e procesit të kolaudimit dhe të marrjes në dorëzim), i cili të kryejë ekzaminimet teknike dhe të përcaktojë autenticitetin e materialeve hidraulike.</p> <p>Në rast se nga procesi i verifikimit rezulton se pajisjet e furnizuara nga Shoqëria òAò Sh.p.k, nuk garantojnë zbatimin e kontratës në cilësi dhe brenda standardeve të kërkuara dhe të konfirmohet që këto pajisje janë të njëjta me ato të prokuruar, konsiderohet dëm ekonomik dhe të kërkohet në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative, si dhe të gjitha shkallët e gjykimit arkëtimi i vlerës 40,771,612 lekë nga Shoqëria òAò Sh.p.k.</p>

2. Titulli i	Kritere të veçanta për kualifikimit të pa vendosura plotësisht konformë
---------------------	---

gjetjes:	akteve ligjore dhe rregullatorë për prokurimet publike.
Situata:	Në 7 raste në vlerën 348,655 mijë lekë, kriteret e veçanta për kualifikimit nuk janë vendosur plotësisht konformë akteve ligjore dhe rregullatorë për prokurimet publike.
Kriteri:	Ligji nr. 9643, datë 20.11.2009, òPër Prokurimin Publikò, i ndryshuar, neni 46, VKM nr. 914, datë 29.12.2014, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publikò, i ndryshuar, neni 26, pika 5, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 42, datë 16.01.2008, òPër miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimiò, kreu III, pika 1/a, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 108, datë 09.02.2011, òPër aftësitë që duhet të plotësojnë punëmarrësit, personat dhe shërbimet e specializuara, që merren me çështjet e sigurisë dhe të shëndetit në punëò, i ndryshuar, shkresa Agjencisë së Prokurimit Publik (Drejtoria juridike dhe e Monitorimit), nr. 3341/1 prot., datë 20.03.2018.
Ndikimi/Efekti:	Risk për mos sigurim transparence, trajtim i barabartë i të gjithë operatorët ekonomikë të interesuar në kontratat publike.
Shkaku:	Keq interpretime të akteve ligjore dhe rregullatorë për prokurimet publike.
Rëndësia:	E Lartë
Rekomandimi:	Autoriteti Kontraktor, në vijimësi duhet të hartojë kërkesat e veçanta për kualifikim/specifikimet teknike, që të sigurojë transparencë, trajtim të barabartë të gjithë operatorëve ekonomikë të interesuar në kontratat publike, mos diskriminim dhe konkurrencë.

3. Titulli i gjetjes:	Përlllogaritja e vlerës së kontratave jo plotësisht të argumentuara.
Situata:	Në procedurën e prokurimit me objekt òhipoklorit natriumi, viti 2020-2021, në vlerën 14,248 mijë lekë, òBlerje materiale hidraulike, viti 2021 në vlerën 35,000 mijë lekë, òBlerje matesa uji individuale ½, ¾ dhe 1 , viti 2019ò, në vlerën 10,668 mijë lekë, përlllogaritja e vlerës së kontratës është bërë duke u mbështetur në çmimet e tregut, por nuk është dhënë asnjë argumentim përse nuk është i është referuar edhe alternativave të tjera, si çmimet e kontratave të mëparshme të realizuara nga autoritete të tjera kontraktore, ose/dhe çmime të tjera zyrtare, të njohura nga institucionet përkatëse (si për shembull, nga organet tatimore a doganore, dhomat e tregtisë, etj).
Kriteri:	VKM nr. 914, datë 29.12.2014 òPër miratimin e rregullave të prokurimit publikò, i ndryshuar, neni 59, pika 2.
Ndikimi/Efekti:	Risk për mos sigurim të mirë në përdorimin të fondeve publike.
Shkaku:	Keq interpretime të akteve ligjore dhe rregullatorë për prokurimet publike.
Rëndësia:	E Lartë
Rekomandimi:	Nga Autoriteti Kontraktor të merren masa që përlllogaritja e vlerës së kontratave të prokurimit publik, të vlerësohet si procedurë e rëndësishme,

	pasi nga zbatimi i procedurave të përzgjedhjes të prokurimit publik, varet saktësia e kësaj vlere, por dhe efektiviteti maksimal i shpenzimeve publike.
--	---

4. Titulli i gjetjes:	Kualifikim, shpallja fitues e operatorëve ekonomik nga KVO, si dhe lidhja e kontratave, është kryer në mënyrë të padrejtë.
Situata:	Në 5 procedura prokurimi për vlerën 244,882 mijë lekë, kualifikimi, shpallja fitues e operatorëve ekonomik nga KVO, si dhe lidhja e kontratave, është kryer në mënyrë të padrejtë.
Kriteri:	Ligji nr. 9643, datë 20.11.2006 për prokurimin publik, i ndryshuar, neni 46, neni 53 pika 3, VKM nr. 914, datë 29.12.2014 dhe Rregullat e Prokurimit, i ndryshuar, neni 66 pika 3, Ligji nr. 44/2015 Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë nën 108-118.
Ndikimi/Efekti:	Risk për mos sigurim të mirë në përdorimin të fondeve publike
Shkaku:	Keq interpretime të akteve ligjore dhe rregullatorë për prokurimet publike.
Rëndësia:	E lart
Rekomandimi:	Nga Shoqëria t'i kushtohet vëmendje e duhur institucionale procesit të shqyrtimit dhe vlerësimit nga komisionet e vlerësimit të ofertave, i dokumentacionit ligjor dhe administrativ të operatorëve ekonomik dhe ofertave të ofertuesve, pasi rëndësia e procesit të shqyrtimit, kualifikimit dhe shpallja fitues të operatorëve është me rëndësi kapitale.

5. Titulli i gjetjes:	Kontrata të pa siguruara për humbje ose dëmtim të punimeve, pajisjeve, materialeve dhe dëmtimet personale ose vdekjet e palëve të treta.
Situata:	Në procedurën e prokurimit me objekt instalimi i teknologjive të reja në stacionet e pompimit në sistemin Mengël-Samurr-Godolesh, (për zëvendësimin e pompave dhe pajisjeve viti 2019, në vlerën 56,418 mijë lekë dhe procedurën e prokurimit "Rikonstruksion i rjetit të brëndshëm ekzistues të linjave në Rrugët 011 Nëntoriö, Rruga 0Ali Çaushtë, Rruga 0Faik Neziriö, Rruga 0Veli Stafaö, një pjesë të Lagjes 0Çlirimiö dhe 011 Nëntoriö të Bashkisë Elbasan, viti 2019 në vlerën 23,002 mijë lekë, nuk është siguruar kontrata për humbje ose dëmtim të punimeve, pajisjeve, materialeve, humbje ose dëmtim të kantierit ose pronave të tjera në kantier dhe dëmtimet personale ose vdekjet e palëve të treta, si dhe deri në datën e hartimit të këtij konstatimi Autoriteti Kontraktor, nuk ka zgjatur periudhën e paraqitjes të policës së sigurimit ose nuk ka bërë vet siguracionin dhe të zbrisi koston e tij nga pagesa që i jep kontraktorit. Veprim në kundërshtim me neni 25 të kontratës së lidhur, pika 1 dhe 2, ku është shprehur në mënyrë eksplicite se 025.1 Kontraktori duhet të sigurojë objektin, me emra të përbashkët të Autoritetit Kontraktor dhe kontraktorit, nga data e hyrjes në kantier deri në afatin e realizimit të plote, në shumat e shprehura në KVK për humbje

	ose dëmtim të punimeve, pajisjeve, materialeve; humbje ose dëmtim të kantierit ose pronave të tjera në kantier dhe dëmtimet personale ose vdekjet e palëve të treta. 25.2 Polica e sigurimit do të dorëzohet tek drejtuesi i projektit për aprovim brenda 30 ditëve pas shpalljes së fituesit të kontratës. Ky siguracion duhet të mbulojë kompensimin e kërkuar për të kompensuar humbjen ose dëmin e shkaktuar. Nëse kontraktori dështon të sigurojë policën e sigurimit, kontrata do të konsiderohet e anuluar. Megjithatë, Autoriteti Kontraktor, mund të vendosë të zgjasë periudhën e paraqitjes të policës së sigurimit ose të bëjë vetë siguracionin dhe të zbrisi koston e tij nga pagesa që i jep kontraktorit.
Kriteri:	Kontrata me nr. 1872/8 prot., datë 08.11.2019 dhe nr. 1873/9 prot., datë 30.10.2019, lidhur me Shoqërinë òNò shpk.
Ndikimi/Efekti:	Risk për dëmtime shëndeti dhe vjedhje
Shkaku:	Keq interpretime të akteve ligjore dhe rregullatorë për prokurimet publike.
Rëndësia:	E Lart
Rekomandimi:	Nga Administratori i Shoqërisë të merren masa për të korigjuar këtë praktikë në sigurimin e kontratave, me qëllim jo vetëm lidhja tyre të shoqërohet me polica e siguri, por edhe për të parandaluar për të ardhmen përsëritjen e rasteve të tilla.

Për sa trajtuar në këtë pjesë të Raportit Përfundimtar të Auditimit, nga M. T., A. K., M. R., E. B. dhe A. N. është paraqitur observacioni me shkresën nr. 2148 prot., datë 19.05.2022, protokolluar në KLSH me nr. 247/3 prot., datë 23.05.2022,, në lidhje me aktkonstatimin nr. 1,3,5, datë 11.05.2022, ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:

Pretendimi i subjektit

...në këtë pikë grupi i përllogaritjes së kontratës i është referuar shprehjes “Autoriteti kontraktor duhet ti referohet një ose më shumë alternativave të renditura, duke zgjedhur vetëm një nga alternativat e renditura më sipër. Kjo për arsye se çmimet e tjera si ato të kontratave të mëparshme, apo institucioneve përkatëse, manuale etj, nuk mund të merreshin në konsideratë për shkatë të lëvizjes së konsiderueshme të çmimeve njësi nga viti në vit. Kjo do të sillte një llogaritje jo të saktë të fondit limit të vitit përkatës.

Qëndrimi i grupit të auditimit

Nga grupet e përllogaritjes së vlerës së kontratës ka një keqinterpretim të dispozitave ligjore. Në opinionin e grupit të auditimit, përllogaritja e vlerës së kontratave të prokurimit publik, duhet vlerësuar si procedurë e rëndësishme, pasi nga zbatimi i procedurave të përzgjedhjes të prokurimit publik, varet saktësia e kësaj vlere, por dhe efektiviteti maksimal i shpenzimeve publike. Në mbështetja të këtij opinioni është dhe vendim nr. 285, datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”(ndryshuar me vendimin nr. 710, datë 24.11.2021), neni 13, ku në mënyrë ekslicite është shprehur “Studimi i tregut ka për qëllim përllogaritjen e një vlere reale të kontratës dhe të shmangë dështimin e procedurës për vlera që nuk përputhen me vlerat reale të tregut.

Për studimin e tregut, autoriteti/enti kontraktor, mund të konsultohet me ekspertë, autoritete të pavarura ose operatorët ekonomikë në treg me shkrim ose verbalisht. Në rastin e konsultimit

verbalisht, grupi i ngritur për këtë qëllim, harton një procesverbal me këto të dhëna. Këto këshilla mund të përdoren në planifikimin dhe kryerjen e procedurës së prokurimit, nëse nuk rezultojnë në shtembërimin e konkurrencës dhe cenojnë parimet e mosdiskriminimit dhe transparencës. Autoriteti/enti kontraktor, duhet të kujdeset që konsultimi të jetë sa më gjithpërfshirës dhe të shmangë dhënien e çdo informacioni preferencial, që mund të favorizojë operatorë të caktuar në përgatitjen e ofertës për procedurën e prokurimit”.

Përlogaritja është bërë në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 59, pika 2 ku është shprehur në mënyrë eksplicite se “Në përllogaritjen e vlerës limit të kontratës, autoriteti kontraktor duhet t’i referohet një ose më shumë alternativave të renditura si mëposhtë: Çmimet e botuara nga Instituti i Statistikave (INSTAT), ose/dhe çmime të tjera zyrtare, të njohura nga institucionet përkatëse (si për shembull, nga organet tatimore a doganore, dhomat e tregtisë, në manuale etj);ose/dhe

a) çmimet e tregut;ose/dhe

b) çmimet e kontratave të mëparshme, të realizuara nga vetë apo nga autoritete të tjera kontraktore;ose/dhe

ç) çmimet ndërkombëtare, të shpallura publikisht.

Autoriteti kontraktor, përpara nxjerrjes së urdhrin të prokurimit, duhet të argumentojë dhe të dokumentojë përllogaritjen e vlerës së kontratës, bazuar në specifikimet teknike të objektit që prokurohet.

Si konkluzion, përllogaritja e vlerës së kontratës është bërë duke u mbështetur në çmimet e tregut, por nuk është dhënë asnjë argumentim përse nuk është i është referuar edhe alternativave të tjera, si çmimet e kontratave të realizuara nga autoritete të tjera kontraktore, ose/dhe çmime të tjera zyrtare, të njohura nga institucionet përkatëse (si për shembull, nga organet tatimore a doganore, i UK te tjera) veprim në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 59, pika 2.

Prandaj ky koment nuk merret në konsideratë dhe do të trajtohet në materialin e auditimit.

Për sa trajtuar në këtë pjesë të Raportit Përfundimtar të Auditimit, nga I. S., J. D. dhe A. M. është paraqitur observacioni me shkresën nr. 2146 prot., nr. 2147 prot., datë 19.05.2022, protokolluar në KLSH me nr. 247/3 prot., datë 23.05.2022,, në lidhje me aktkonstatimin nr. 6 dhe 7 datë 11.05.2022, ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:

Pretendimi i subjektit

Për të provuar kapacitetet teknike dhe profesionale të shoqërisë është kërkuar personel i nevojshëm inxhinierik referuar zërave të preventivit të objektit për realizimin e kontratës ne mbështetje nenin 46, të Ligjit nr. 9643, datë 20.11.2009 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar,si dhe në mbështetje te nenin 44, të Ligjit nr. 9643, datë 20.11.2009 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, ku përcaktohet se “pika 1. Bazuar në parashikimet e mësipërme të legjislacionit për prokurimin publik, Autoriteti Kontraktor ka kërkuar që operatori ekonomik ofertues të ketë në stafin e tij inxhinier të cilët kanë një rol të rëndësishëm në mbarëvajtjen e punimeve pasi ata janë përgjegjës për zbatimin e objektit sipas projektit dhe në përputhje me kushtet teknike të zbatimit të tij.

Qëndrimi i grupit të auditimit

Pretendimi është në kundërshtim me nenin 46, të Ligjit nr. 9643, datë 20.11.2009 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, dhe VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 26, pika 5, si dhe Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 42, datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së

licensave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”, kreu III, pika 1/a , ku është shprehur në mënyrë eksplicite se:

"1. Kategorizimi dhe klasifikimi i licencës,

a) Licenca është dokument juridik e profesional, që i jep të drejtë deponuesit të saj të ushtrojë veprimtari të caktuar, sipas:

I. Kategorive të punimeve të zbatimit duke u mbështetur në:

- profilin e diplomës universitare të individëve që punësohen në rolin e drejtuesit teknik të shoqërisë”.

Prandaj ky koment nuk merret në konsideratë dhe do të trajtohet në materialin e auditimit.

Për sa trajtuar në këtë pjesë të Raportit Përfundimtar të Auditimit, nga I. S., L. D. dhe N. H. është paraqitur observacioni me shkresën nr. 2145 prot., datë 19.05.2022, protokolluar në KLSH me nr. 247/3 prot., datë 23.05.2022,, në lidhje me aktkonstatimin nr. 5 datë 11.05.2022, ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:

Pretendimi i subjektit

Njësia e prokurimit në pikën 2.2. të Kapaciteti ekonomik dhe financiar ka specifikuar vitet 2016-2017-2018 si rrjedhojë ka përmbushur detyrimin ligjor për paraqitje të dokumentacionit të tre viteve të fundit nga data e zhvillimit të tenderit, tender i zhvilluar në Mars 2020. Theksojmë faktin se në këtë periudhë nuk janë mbyllur pasqyrat financiare të vitit 2019 për subjektet tatimore për këtë arsye nuk është kërkuar dokumentacion për këtë periudhë. (Sqarim: periudhë përpara datës së zhvillimit të tenderit konsiderohet viti tatimor).

Qëndrimi i grupit të auditimit

Në pikën 2.2/1/2 të kriterëve të kualifikimit “Kapaciteti ekonomik dhe financiar” është përcaktuar se, operatorët duhet të paraqesin:

-Vërtetim nga Administrata Tatimore për xhiron mesatare te viteve 2016, 2017 dhe 2018, me një vlerë jo më të ulët se vlera e fondit limit.

-Pasqyrat financiare te 3 viteve te fundit (2016, 2017, 2018) të konfirmuara nga administrata tatimore.

Veprim në kundërshtim me shkresën Agjencisë së Prokurimit Publik (Drejtoria juridike dhe e Monitorimit), nr. 3341/1 prot., datë 20.03.2018, pasi nuk duhet përcaktuar që është realizuar gjatë tre viteve të fundit të veprimtarisë së operatorit, por të tre vitet e fundit nga data e zhvillimit të tenderit. Pra bëhet fjalë për Vërtetim nga Administrata Tatimore për xhiron mesatare dhe jo për pasqyrat financiare. Referuar dispozitave tatimore xhiroja raportohet çdo muaj.

Prandaj ky koment nuk merret në konsideratë dhe do të trajtohet në materialin e auditimit.

Për sa trajtuar në këtë pjesë të Raportit Përfundimtar të Auditimit, nga A. M., R. H. dhe G. P. është paraqitur observacioni me shkresën nr. 2143 prot., datë 18.05.2022, protokolluar në KLSH me nr. 247/3 prot., datë 23.05.2022,, në lidhje me aktkonstatimin nr. 5 datë 11.05.2022, ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:

Pretendimi i subjektit

Siç është konstatuar më sipër nga grupi i auditimit, sqarojmë se KVO bazuar ne dokumentacionin e paraqitur nga OE ne sistem, ka verifikuar se Certifikata ISO 9001: 2015 për subjektin C ka qene e përkthyer dhe noterizuar në gjuhën shqipe, Certifikuar më date 20.03.2019 dhe datë skadence 19.03.2022, duke përmbushur kriteret e vendosura nga AK. Nga KVO është verifikuar qe kompania Q ne Angli është e akredituar ndërkombëtarisht dhe njohur ne R.Sh, bazuar kjo ne rekomandimin e Agjencisë së Prokurimit Publik nr. 3330 prot., datë 20.03.2018, pika 4 : “Te gjitha certifikatat e cilësisë, te cilat vlerësohen te nevojshme te kërkojen nga AK

duhet te jene te lëshuara nga organizmat e vlerësimit te konformitetit, te cilët janë te akredituara nga DPA, ose organizma ndërkombëtare akreditues te njohur nga R.Sh.”

Për sa me sipër, KVO, duke mos pasur arsye për dyshime ne saktësinë e te dhënave, nuk e ka pare te nevojshme, verifikimet e mëtejshme.

Qëndrimi i grupit të auditimit

Operatori ka paraqitur çertifikatën ISO 9001:2015 të lëshuar nga kompania Q, për C shpk, e përkthyer dhe noterizuar në gjuhën shqipe. Certifikuar më date 20.03.2019 dhe datë skadence 19.03.2022.

Nga verifikimi referuar Rekomandimit të Agjencisë së Prokurimit Publik nr. 3330 prot., datë 20.03.2018 dhe Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit nr. 145 prot., datë 16.03.2018, u konstatua se kompania Q ne Angli është e akredituar ndërkombëtarisht, por kjo certifikatë me numër seri 45827561/18/Q Rev:001 nuk është publikuar në faqen e kësaj kompanie, për pasojë është dokument i pabesueshëm për tu marre në konsiderate referuar rekomandimit të sipërpërmendur.

Zbatimi i rekomandimeve te APP si dhe saktësia e dokumentacionit te paraqitur nga operatorët është e sanksionuar ne dispozitat nënligjore dhe rregullatore.

Prandaj ky koment nuk merret në konsideratë dhe do të trajtohet në materialin e auditimit.

Për sa trajtuar në këtë pjesë të Raportit Përfundimtar të Auditimit, nga A. M., N. H. dhe Ç. L. është paraqitur observacioni me shkresën nr. 2151 prot., datë 19.05.2022, protokolluar në KLSH me nr. 247/3 prot., datë 23.05.2022,, në lidhje me aktkonstatimin nr. 4 datë 11.05.2022, ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:

Pretendimi i subjektit

-KVO bazuar ne dokumentacionin e paraqitur nga OE ne sistem, ka verifikuar se Certifikata ISO 9001: 2015 për subjektin A ka qene e përkthyer dhe noterizuar në gjuhën shqipe, Certifikuar më date 20.03.2019 dhe datë skadence 19.03.2022, duke përmbushur kriteret e vendosura nga AK. Nga KVO është verifikuar qe kompania Q ne Angli është e akredituar ndërkombëtarisht dhe njohur ne R.Sh, bazuar kjo ne rekomandimin e Agjencisë së Prokurimit Publik nr. 3330 prot., datë 20.03.2018, pika 4 : “Te gjitha certifikatat e cilësisë, te cilat vlerësohen te nevojshme te kërkohen nga AK duhet te jene te lëshuara nga organizmat e vlerësimit te konformitetit, te cilët janë te akredituara nga DPA, ose organizma ndërkombëtare akreditues te njohur nga R.Sh.”

Për sa me sipër, KVO, duke mos pasur arsye për dyshime ne saktësinë e te dhënave, nuk e ka pare te nevojshme, verifikimet e mëtejshme.

Qëndrimi i grupit të auditimit

Në pikën 2.3.4 ÷Kapaciteti teknikë është përcaktuar: Operatori Ekonomik duhet të paraqesë certifikatën ISO 9001:2015 mbi “Sistemet e menaxhimit te cilësisë” për mallrat objekt prokurimi te lëshuar nga kompani të cilat njihen nga institucionet zyrtare Shqiptare dhe që janë të akredituara.

Për plotësimin e kësaj pike OE duhet te paraqesë Certifikatën e cila kërkohet te jete e vlefshme ne kohen e zhvillimit te tenderit dhe dokumentet akreditues qe njihen nga Shteti.

Në rastet e bashkimit të operatoreve ekonomik, secili operator ekonomik duhet të dorëzojë certifikatën ISO sipas zërave te mallrave qe do te marre përsipër sipas akt-marrëveshjes.)

Ky operator nuk provohet ta ketë përmbushur këtë kërkesë, pasi:

Operatori ka paraqitur çertifikatën ISO 9001:2015 të lëshuar nga kompania Q, për C shpk, e përkthyer dhe noterizuar në gjuhën shqipe. Certifikuar më date 20.03.2019 dhe datë skadence 19.03.2022.

Nga verifikimi referuar Rekomandimit të Agjencisë së Prokurimit Publik nr. 3330 prot., datë 20.03.2018 dhe Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit nr. 145 prot., datë 16.03.2018, u konstatua se kompania Q ne Angli është e akredituar ndërkombëtarisht, por kjo certifikatë me numër seri QEC 45827561/18/Q Rev:001 nuk është publikuar në faqen e kësaj kompanie, për pasojë është dokument i pabesueshëm për tu marrë në konsideratë referuar rekomandimit të sipërpërmendur.

Zbatimi i rekomandimeve të APP si dhe saktësia e dokumentacionit të paraqitur nga operatorët është e sanksionuar në dispozitat nënligjore dhe rregullatore.

Prandaj ky koment nuk merret në konsideratë dhe do të trajtohet në materialin e auditimit.

Për sa trajtuar në këtë pjesë të Raportit Përfundimtar të Auditimit, nga K. C., K. M. dhe Y. A. është paraqitur observacioni me shkresën nr. 2151 prot., datë 19.05.2022, protokolluar në KLSH me nr. 357/20 prot., datë 10.01.2022, në lidhje me aktkonstatimin nr. 3 datë 11.05.2022, ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:

Pretendimi i subjektit

Siç është konstatuar më sipër nga grupi i auditimit, sqarojmë se Grupi i marrjes në dorëzim ka bërë verifikimin fizik të mallrave të ardhura, duke verifikuar sasinë, llojin e materialit, dimensionet etj dhe nuk janë bërë shënime të detajuara pasi mallrat plotësonin këto kërkesa të përcaktuara në procedurën e prokurimit.

Qëndrimi i grupit të auditimit

Në aktkonstatim është shprehur në ligjëratë të drejt Procesverbalet e marrjes në dorëzim të firmosur nga K. C., K. M. dhe Y. A., ku është cilësuar “Malli i pranuar plotëson kërkesat e vendosura në procedurën e prokurimit”, duke mos cilësuar zbatimin ose jo të specifikimeve teknike (shtojca 10 e dokumenteve të tenderit) Shtojca 6 “Deklaratë mbi përmbushjen e specifikimeve teknike nga operatori ekonomik” dhe nenin 9/1 i kontratës “Mallrat e furnizuara sipas kontratës duhet të jenë konform kodeve dhe Standardeve Teknike të parashikuara në specifikimet teknike. Nëse gjatë ekzekutimit të kontratës, ka ndryshime në kodet përkatëse ose në Standardet Teknike, këto ndryshime do të zbatohen vetëm pas aprovimit nga Autoriteti Kontraktor”.

Materialet hidraulike nuk janë të shoqëruara me test raport fabrike, për pasojë grupi i auditimit nuk mund të shprehet për saktësinë dhe vërtetësinë e materialeve hidraulike. Pra nuk mund të bëhet verifikimi i specifikimeve teknike (që janë pjesë e kontratës) dhe të dhënat e test-raportit të fabrikës, që të konfirmohet që këto pajisje janë të njëjta me ato të prokuruar (specifikimeve teknike), dhe për të cilën Shoqëria “A” sh.p.k” Shpk ka fituar tenderin dhe është likuiduar, veprim ky në kundërshtim me Ligjin nr. 10,489 datë 15.12.2011 “Për trajtimin dhe mbikëqyrjen e tregut të produkteve jo ushqimore”, neni 3 pika 11, 12, 16, 17, 18, 21 neni 8, neni 9 dhe neni 10.

Referuar sa më sipër, materialet hidraulike të pa shoqëruar me test raport fabrike, nuk ka mundësi nga ana dokumentare të verifikohen specifikimet teknike.

Prandaj ky koment nuk merret në konsideratë dhe do të trajtohet në materialin e auditimit.

Për sa trajtuar në këtë pjesë të Raportit Përfundimtar të Auditimit, nga R. H., N. H. dhe J. D. është paraqitur observacioni me shkresën nr. 2152 prot., datë 19.05.2022, protokolluar në KLSH me nr. 247/3 prot., datë 23.05.2022, në lidhje me aktkonstatimin nr. 3 datë 11.05.2022, ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:

Pretendimi i subjektit

Siç është konstatuar më sipër nga grupi i auditimit, sqarojmë se KVO bazuar në dokumentacionin e paraqitur nga OE në sistem, ka verifikuar se Certifikata ISO 9001: 2015 për subjektin A ka qene e përkthyer dhe noterizuar në gjuhën shqipe, certifikuar më datë 01.07.2018

dhe datë skadence 30.06.2021, duke përmbushur kriteret e vendosura nga AK. Nga KVO është verifikuar që kompania QEC CERTIFICATION ne Angli është e akredituar ndërkombëtarisht dhe njohur ne R.Sh, bazuar kjo ne rekomandimin e Agjencisë së Prokurimit Publik nr. 3330 prot., datë 20.03.2018, pika 4 : “Te gjitha certifikatat e cilësisë, te cilat vlerësohen te nevojshme te kërkohen nga AK duhet te jene te lëshuara nga organizmat e vlerësimit te konformitetit, te cilat janë te akredituara nga DPA, ose organizma ndërkombëtare akreditues te njohur nga R.Sh.”

Për sa me sipër, KVO, duke mos pasur arsye për dyshime ne saktësinë e te dhënave, nuk e ka pare te nevojshme, verifikimet e mëtejshme.

Qëndrimi i grupit të auditimit

Në pikën 2.3.4 “Kapaciteti teknik” është përcaktuar: Prodhuesi i mallit duhet të jetë i çertifikuar për sistemin e menaxhimit të cilësisë me (Ose ekuivalent) për prodhimin e mallrave objekt prokurimi. Certifikata duhet të jetë e vlefshme:

Ky operator nuk provohet ta ketë përmbushur këtë kërkesë, pasi:

Operatori ka paraqitur certifikatën ISO 9001:2015 të lëshuar nga kompania Q, për A, e përkthyer dhe noterizuar në gjuhën shqipe. Nga Certifikuar më date 01.07.2018 dhe datë skadence 30.06.2021.

Nga verifikimi referuar Rekomandimit të Agjencisë së Prokurimit Publik nr. 3330 prot., datë 20.03.2018 dhe Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit nr. 145 prot., datë 16.03.2018, u konstatua se kompania Q ne Angli është e akredituar ndërkombëtarisht, por kjo certifikatë me numër seri QEC 30675457/72/Q Rev:001 nuk është publikuar në faqen e kësaj kompanie, për pasojë është dokument i pabesueshëm për tu marre në konsiderate referuar rekomandimit të sipërpërmendur.

Zbatimi i rekomandimeve te APP si dhe saktësia e dokumentacionit te paraqitur nga operatorët është e sanksionuar ne dispozitat nënligjore dhe rregullatore.

Prandaj ky koment nuk merret në konsideratë dhe do të trajtohet në materialin e auditimit.

Për sa trajtuar në këtë pjesë të Raportit Përfundimtar të Auditimit, nga M. H., J. D. A. M., është paraqitur observacioni me shkresën nr. 2152 prot., datë 19.05.2022, protokolluar në KLSH me nr. 357/20 prot., datë 10.01.2022, në lidhje me aktkonstatimin nr. 2 datë 11.05.2022, ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:

Pretendimi i subjektit

KVO argumenton se për të provuar Furnizimet e ngjashme përveç faturave te konstatuara nga ana e audituesve, O ka paraqitur edhe kontrate me autoritetin Kontraktor UK Tirane sha me objekt “Blerje makineri dhe pajisje (automjete)”, Kontrate e lidhur me date 08.06.2018 me nr. 9870/1 Prot, si dhe Vërtetim realizim kontrate date 03/07/2020, Nr 10904/1 Prot. Vlera e kontratës se realizuar është 49.250.000 leke me TVSH . Pra kjo kontrate përmbush kërkesat e AK për “...me vlerë sa 40% e vlerës së përlllogaritur të kontratës” për pjesën që i përket O sipas marrëveshjes se bashkëpunimit me OE “A”.

Qëndrimi i grupit të auditimit

Argumenti qëndron.

Prandaj ky koment do të merret në konsideratë dhe nuk do të trajtohet në materialin e auditimit.

Pretendimi i subjektit

Siç është konstatuar më sipër nga grupi i auditimit, sqarojmë se KVO bazuar ne dokumentacionin e paraqitur nga OE ne sistem, ka verifikuar se Certifikata EN-ISO 9001:2015 me numër seri AQS/Q/37962019 të lëshuar nga kompania A, për “Z” shpk, e përkthyer dhe noterizuar në gjuhën shqipe. me date lëshimi 25.02.2019, dhe datë kadencë 24.02.2022, duke përmbushur kriteret e vendosura nga AK. Nga KVO është verifikuar që kompania Q ne Angli

është e akredituar ndërkombëtarisht dhe njohur ne R.Sh, bazuar kjo ne rekomandimin e Agjencisë së Prokurimit Publik nr. 3330 prot., datë 20.03.2018, pika 4 : “Te gjitha certifikatat e cilësisë, te cilat vlerësohen te nevojshme te kërkoen nga AK duhet te jene te lëshuara nga organizmat e vlerësimit te konformitetit, te cilët janë te akredituara nga DPA, ose organizma ndërkombëtare akreditues te njohur nga R.Sh.”

Për sa me sipër, KVO, duke mos pasur arsye për dyshime ne saktësinë e te dhënave, nuk e ka pare te nevojshme, verifikimet e mëtejshme.

Qëndrimi i grupit të auditimit

Në pikën 2.3.2 “Kapaciteti teknik” është përcaktuar: Operatori Ekonomik duhet të disponoje certifikatën ISO 9001:2015 mbi “Sistemet e menaxhimit te cilësisë”, lëshuar nga institucionet zyrtare te akredituar për këtë qellim.

Certifikata kërkohet të jetë e vlefshme në kohën e zhvillimit të tenderit.

Në rastet e bashkimit të operatoreve ekonomik, secili operator ekonomik duhet të dorëzojë certifikatën ISO sipas zërave te mallrave që do të marrë përsipër sipas akt-marrëveshjes.)

Ky operator nuk provohet ta ketë përmbushur këtë kërkesë, pasi: Operatori ekonomik “Z” shpk referuar marrëveshjes së bashkëpunimit me operatorin L shpk date 26.04.2021 , nuk ka paraqitur përmbushjen e detyrimeve për furnizimin e pajisjeve sipas zërave të mëposhtëm :

Eskavator me goma	Cope	1	15,000,000.00	15,000,000.00
Mjet me karroceri tip Pick up	Cope	2	6,200,000.00	12,400,000.00
Kamioncine dopio kabine me karroceri fikse	Cope	2	7,300,000.00	14,600,000.00
Minifadrome	Cope	1	8,424,000.00	8,424,000.00
Rimorkiator	Cope	1	6,503,000.00	6,503,000.00
Kamioncine vetëshkarkuese tek kabine,dopio gome	Cope	2	8,536,500.00	17,073,000.00

Operatori ka paraqitur certifikatën EN-ISO 9001:2015 me numër seri AQS/Q/37962019 të lëshuar nga kompania A, për “Z” shpk, e përkthyer dhe noterizuar në gjuhën shqipe. me date lëshimi 25.02.2019, dhe datë skadence 24.02.2022,

Nga verifikimi referuar Rekomandimit të Agjencisë së Prokurimit Publik nr. 3330 prot., datë 20.03.2018 dhe Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit nr. 145 prot., datë 16.03.2018, u konstatua se kompania Q. ne Angli është e akredituar ndërkombëtarisht, por kjo certifikatë me numër serie AQS/Q/37962019 nuk është publikuar në faqen e kësaj kompanie “<https://aqscert.org>” , për pasojë është dokument i pabesueshëm për tu marre në konsiderate referuar rekomandimit të sipërpërmendur.

Veprim në kundërshtim me Rekomandimin e Agjencisë së Prokurimit Publik nr. 3330 prot, datë 20.03.2018 dhe Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit nr. 145 prot., datë 16.03.2018, pika 5.

Zbatimi i rekomandimeve te APP si dhe saktësia e dokumentacionit te paraqitur nga operatorët është e sanksionuar ne dispozitat nënligjore dhe rregullatore.

Prandaj ky koment nuk merret në konsideratë dhe do të trajtohet në materialin e auditimit.

Për sa trajtuar në këtë pjesë të Raportit Përfundimtar të Auditimit, nga N. H. dhe G. P., është paraqitur observacioni me shkresën nr. 2152 prot., datë 19.05.2022, protokolluar në KLSH me nr. 247/3 prot., datë 23.05.2022, në lidhje me aktkonstatimin nr. 1 datë 11.05.2022, ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:

Pretendimi i subjektit

Siç është konstatuar më sipër nga grupi i auditimit, sqarojmë se KVO bazuar ne dokumentacionin e paraqitur nga OE ne sistem, ka verifikuar se Certifikata ISO-9001 dhe

Certifikatën e Cilësisë OHSAS -18001 për shoqërinë "A" janë të vlefshme duke përmbushur kriteret e vendosura nga AK. Nga KVO është verifikuar që kompania Laboratori Q shpk është e akredituar nga Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit, bazuar kjo në rekomandimin e Agjencisë së Prokurimit Publik nr. 3330 prot., datë 20.03.2018, pika 4 : “Te gjitha certifikatat e cilësisë, të cilat vlerësohen të nevojshme të kërkojnë nga AK duhet të jenë të lëshuara nga organizmat e vlerësimit të konformitetit, të cilët janë të akredituara nga DPA, ose organizma ndërkombëtare akreditues të njohur nga R.Sh.”. Bashkangjitur do të gjeni Certifikatën me nr. CS 008 për ISO 9001:2015 lëshuar me 29.03.2018 e vlefshme deri me 28.03.2022.

Qëndrimi i grupit të auditimit

Argumenti qëndron dhe është i shoqëruar dhe me nr. CS 008 për ISO 9001:2015 lëshuar me 29.03.2018 e vlefshme deri me 28.03.2022.

Prandaj ky koment do të merret në konsideratë dhe nuk do të trajtohet në materialin e auditimit. Për sa trajtuar në këtë pjesë të Raportit Përfundimtar të Auditimit, nga I. S., P. A. dhe G. P., është paraqitur observacioni me shkresën nr. 2144 prot., datë 19.05.2022, protokolluar në KLSH me nr. 247/3 prot., datë 23.05.2022, në lidhje me aktkonstatimin nr. 4 datë 11.05.2022, ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:

Pretendimi i subjektit

Për të provuar përvojën e mëparshme, kërkojnë dëshmi për furnizimet e mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë **tri viteve të fundit**, duke mos e specifikuar periudhën **nga data e zhvillimit të tenderit** por duke ju referuar specifikimit dhe logjikës në pikën b të 2.2.Kapaciteti ekonomik dhe financiar. Lidhur me këtë fakt për këtë procedurë nuk ka patur ankesa apo kërkesa nga operatorë për sqarim dhe si operatorët ekonomik që kanë ofertuar dhe vetë komisioni i vlerësimit të ofertave kanë ndjekur të njëjtën logjikë,në kuptim të dispozitës së sipërcituar Autoriteti Kontraktorë do të pranojë furnizimet e mëparshme të ngjashme të kryera gjatë **3 viteve të fundit nga data e zhvillimit të tenderit**.

Qëndrimi i grupit të auditimit

Në pikën 3,të kriterëve të kualifikimit “Kapaciteti teknik ” është përcaktuar se, Për të provuar përvojën e mëparshme, kërkojnë dëshmi për furnizimet e mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tri viteve të fundit. Vlera e kërkuar duhet të jete jo më e vogël se 40 % e vlerës se përlllogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tri viteve të fundit. Autoriteti kontraktor si dëshmi për përvojën e mëparshme kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik ose fatura tatimore të shitjes, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara .

Veprim në kundërshtim me shkresën Agjencisë së Prokurimit Publik (Drejtoria juridike dhe e Monitorimit), nr. 3341/1 prot., datë 20.03.2018, pasi nuk duhet përcaktuar që është realizuar gjatë tre viteve të fundit të veprimtarisë së operatorit, por të tre vitet e fundit nga data e zhvillimit të tenderit.

Prandaj ky koment nuk do të merret në konsideratë dhe do të trajtohet në materialin e auditimit. Për sa trajtuar në këtë pjesë të Raportit Përfundimtar të Auditimit, nga A. M., G. P. dhe Ç. L., është paraqitur observacioni me shkresën nr. 2150 prot., datë 19.05.2022, protokolluar në KLSH me nr. 247/3 prot., datë 23.05.2022, në lidhje me aktkonstatimin nr. 4 datë 11.05.2022, ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:

Pretendimi i subjektit

Në lidhje me kërkesën që duhej shtuar në kriteret e kualifikimit, OE duhet të jetë i certifikuar nga CE për prodhim dhe/ose certifikimin e materialeve hidraulike sipas preventivit bazuar në

direktivën 89/106/CEE ndryshuar në direktivën 93/68/CEE theksojmë se nuk ekziston asnjë certifikatë që lëshohet nga BE për këtë direktivë. Be nuk certifikon asnjë shoqëri apo produkt.

Qëndrimi i grupit të auditimit

Direktiva 89/106/CEE ndryshuar në direktivën 93/68/CEE, paragrafi i 11, në mënyre specifike shprehet që: “Duke pasur parasysh se një produkt supozohet i përshtatshëm për përdorim nëse është në përputhje me një standard të harmonizuar, një miratim teknik evropian ose një specifikim teknik të paharmonizuar të njohur në nivel komunitar”.

Prandaj ky koment nuk do të merret në konsideratë dhe do të trajtohet në materialin e auditimit

IV. GJETJET DHE REKOMANDIMET

A. MASA ORGANIZATIVE

1. Gjetje nga auditimi: Në 7 raste për vlerën 9,307 mijë lekë me TVSH janë kryer shpenzime për blerje Hipoklorit Natriumi pa dokumentacion të plotë vërtetues. Konkretisht certifikatat e origjinës janë me logo nga Shoqëria ò2ò òCò shpk të firmosura nga Administratori i Shoqërisë N. Sh.. Specifikat (raport analize dhe skedë sigurie) për furnizimin, janë me logo ò2ò òCò shpk Korçë të firmosura nga Administratori N. Sh., të pa firmosura në 2 raste nga kimisti/kimistja që ka bërë analizën. Faturat nuk shoqërohen me certifikatën e analizës nga Instituti i Shëndetit Publik, ose dëshmi të lëshuara nga autoritete/institucione/ente të autorizuar për lëshimin e tyre, për analizë toksikologjike për NaOCl (hipoklorit natriumi) të marrë brenda tre muajve të fundit nga data e zhvillimit të tenderit, referuar kërkesave për kualifikim pikës 2.3.3 të kapacitetit teknik (shtojcë datë 06.02.2020), për pasojë nuk mund të verifikohet zbatimi/ose jo i specifikimeve (shtojca 10 e dokumenteve të tenderit) Shtojca 6 òDeklaratë mbi përmbushjen e specifikimeve teknike nga operatori ekonomik dhe neni 9/1 i kontratës òMallrat e furnizuara sipas kontratës duhet të jenë konform kodeve dhe Standardeve Teknike të parashikuara në specifikimet teknike. Për pasojë raporti i analizës specifikat (raport analize dhe skedë sigurie) nga laborator i ò2ò òCò shpk Korçë, është dokument i pavlefshëm, pasi ky laborator nuk është i akredituar nga Drejtoria e Përgjithshme Kalibrimeve.

Për posë sa mësipër, nuk ka gjurmë (dokumentacion) të kthimit nga litra në kg, referuar nivelit të depozitës së klorinit para furnizimit, mbas furnizimit dhe koficentët e përdorur për kthimin nga litra në kg.

Veprim në kundërshtim me Ligjin nr. 116/2014 òPër akredimitin e organeve të vlerësimit të konformitetit në Republikën e Shqipërisë, i ndryshuar, neni 5, pika 1 dhe 4, Rekomandimin e Agjencisë së Prokurimit Publik nr. 3330 prot, datë 20.03.2018 dhe Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit nr. 145 prot, datë 16.03.2018, Ligjin nr. 7850, datë 29.07.1994 òKodi Civil i Republikës së Shqipërisë, neni 419, 420, neni 659, 698 dhe neni 690, Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 òPër menaxhimin financiar dhe kontrollin, me ndryshimet vijuese të tij, neni 2 dhe neni 4, Ligjin nr. 25/2018, òPër kontabilitetin dhe pasqyrat financiare, me ndryshimet vijuese të tij, neni 7, Udhëzimin e Ministrisë Financave nr. 30 datë 27.12.2011, òPër menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik, i ndryshuar me nr. 20, datë 17.11.2014 pika 35 (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.5, faqe 43-65 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

1.1. Rekomandimi: Administratori i Shoqërisë të sigurojë marrjen e veprimeve korigjuese në mënyrë që të gjitha shpenzimet për blerjen e Hipoklorit të Natriumi të bëhen në përputhje me Standardet Teknike të parashikuara në specifikimet teknike.

Menjëherë dhe në vijimësi

2. Gjetje nga auditimi: Në 8 raste për vlerën 5187 mijë lekë me TVSH janë kryer shpenzime për blerje karburant (dizel dhe benzinë) pa dokumentacion të plotë vërtetues.

Faturat nuk shoqërohen me raport analizë para zhdoganimit, të lëshuar nga Laboratori i Kontrollit të Naftës dhe Gazit, (Drejtoria e Laboratorit Qendror të Kontrollit, Inspektorati Shtetëror Teknik dhe Industrial), për pasojë nuk mund të verifikohet zbatimi/ose jo i specifikimeve teknike (shtojca 9 e dokumenteve të tenderit) Shtojca 6 ÷ Deklaratë mbi përmbushjen e specifikimeve teknike nga operatori ekonomik dhe neni 9/1 i kontratës ÷ Mallrat e furnizuara sipas kontratës duhet të jenë konform kodeve dhe Standardeve Teknike të parashikuara në specifikimet teknike. Nëse gjatë ekzekutimit të kontratës, ka ndryshime në kodet përkatëse ose në Standardet Teknike, këto ndryshime do të zbatohen vetëm pas aprovimit nga Autoriteti Kontraktorë. Veprim në kundërshtim me Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 ÷ Për prokurimin publikë, i ndryshuar, neni 60, pika 1, Ligjin nr. 7850, datë 29.07.1994 ÷ Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë, neni 419, 420, neni 659, 698 dhe neni 690, Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 ÷ Për menaxhimin financiar dhe kontrollin, me ndryshimet vijuese të tij, neni 2 dhe neni 4, Ligjin nr. 25/2018, ÷ Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare, me ndryshimet vijuese të tij, neni 7, Udhëzimin e Ministrisë Financave nr. 30 datë 27.12.2011, ÷ Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publikë, i ndryshuar me nr. 20, datë 17.11.2014 pika 35 (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.5, faqe 43-65 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

2.1. Rekomandimi: Administratori i Shoqërisë të sigurojë marrjen e veprimeve korrigjuese në mënyrë që të gjitha shpenzimet për blerjen e karburant (dizel dhe benzinë) të bëhen në përputhje me Standardet Teknike të parashikuara në specifikimet teknike.

Menjëherë dhe në vijimësi

3. Gjetje nga auditimi: Në 13 raste për vlerën 69,210 mijë lekë me TVSH janë kryer shpenzime për blerje materiale hidraulike. Proces verbalet e marrjes në dorëzim janë të firmosura nga grupet e marrjes në dorëzim, duke mos cilësuar zbatimin ose jo të specifikimeve teknike (shtojca 9 e dokumenteve të tenderit) Shtojca 6 ÷ Deklaratë mbi përmbushjen e specifikimeve teknike nga operatori ekonomik dhe neni 9/1 i kontratës ÷ Mallrat e furnizuara sipas kontratës duhet të jenë konform kodeve dhe Standardeve Teknike të parashikuara në specifikimet teknike. Nëse gjatë ekzekutimit të kontratës, ka ndryshime në kodet përkatëse ose në Standardet Teknike, këto ndryshime do të zbatohen vetëm pas aprovimit nga Autoriteti. Veprim në kundërshtim me Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 ÷ Për prokurimin publikë, i ndryshuar, neni 60, pika 1, Ligjin nr. 7850, datë 29.07.1994 ÷ Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë, neni 419, 420, neni 659, 698 dhe neni 690, Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 ÷ Për menaxhimin financiar dhe kontrollin, me ndryshimet vijuese të tij, neni 2 dhe neni 4, Ligjin nr. 25/2018, ÷ Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare, me ndryshimet vijuese të tij, neni 7, Udhëzimin e Ministrisë Financave nr. 30 datë 27.12.2011, ÷ Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publikë, i ndryshuar me nr. 20, datë 17.11.2014 pika 35 (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.5, faqe 43-65 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

3.1. Rekomandimi: Titullari i Autoritetit Kontraktor duhet të nxjerri urdhër/urdhëra me qëllim ndjekjen me përpikmëri të zbatimit të kontratave, duke përfshirë dhe marrjen në dorëzim të aktiveve të furnizuara, për sasinë, cilësinë, llojin si dhe dokumentacionin shoqëruar të tyre.

Menjëherë

4. Gjetje nga auditimi: Në 8 raste për vlerën 6,000 mijë lekë me TVSH janë kryer shpenzime, me dokumenti justifikues (faturë) të firmosur dhe vulosur vetëm nga furnitorët. Faturat nuk janë firmosur nga blerësi dhe transportuesit. Veprim në kundërshtim me Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 ÷ Për menaxhimin financiar dhe kontrollin, me ndryshimet vijuese të tij, neni 2 dhe neni 4, Ligjin nr. 25/2018, ÷ Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare, me ndryshimet vijuese të tij, neni 7, Ligjin nr. 83/2019 ÷ Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008 ÷ Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë neni 2, 6, dhe 7, Udhëzimin e Ministrisë së

Financave nr. 30, datë 27.12.2011 òPër menaxhimin e aktiviteteve në njësitë e sektorit publikò, me ndryshimet vijuese të tij, pika 35 (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.5, faqe 43-65 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

4.1. Rekomandimi: Titullari i Autoritetit Kontraktor duhet të nxjerri urdhër/urdhra me qëllim ndjekjen me përpikmëri të kryerjes së shpenzimeve me dokumentacion të plot dhe të saktë vërtetues.

Menjëherë

5. Gjetje nga auditimi: Me urdhër transfertë datë 27.07.2020 nëpërmjet BKT Bankë është likuiduar personi fizik Kristaq Skënderi për vlerën 703,096 lekë. Dokumenti justifikues faturë tatimore shitje me numër 143, datë 29.04.2020, e cila cilëson dizifektive Covi-19. Nuk ka asnjë dokument tjetër, nuk cilëson dezinfektim i brendshëm ose i jashtëm. Nuk ka të përcaktuar produktet biocide që do përdoren për dizifektim, të cilat duhet të jenë në listën e miratuar nga Ministri i Shëndetësisë, të kenë veprim baktericid, fungicid dhe virusicid, nuk duhet të shkaktojnë efekte anësore që rrezikojnë jetën dhe shëndetin e njerëzve, kafshëve dhe bimëve, si dhe nuk duhet të kenë ndikim negativ në mjedisë. Nuk është përcaktuar sasia dhe grafiku, mënyra e dezinfektimit me spërkatje mjegullës në të ftohtë, mjetet e përdorura (pompa /cantë shpine me presion etj. Veprim në kundërshtim me Udhëzimin e përbashkët të Agjencisë së Prokurimit Publik me nr. 2857 prot, datë 06.05.2020 dhe Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale nr. 2163 prot, datë 06.05.2020 òPër përcaktimin e listës së mallrave dhe shërbime për përbalimin e situatës së krijuar nga epidemia Covid-19 (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.5, faqe 43-65 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

5.1. Rekomandimi: Nga Administratori i Shoqërisë të merren masa për të korrigjuar praktikën e dezinfektit të brendshëm ose të jashtëm ambienteve të punës, me qëllim jo vetëm kryerja e tyre të bëhet me produktet biocide të cilat nuk duhet të shkaktojnë efekte anësore që rrezikojnë jetën dhe shëndetin e njerëzve, kafshëve dhe bimëve, si dhe nuk duhet të kenë ndikim negativ në mjedis.

Menjëherë dhe në vijimësi

6. Gjetje nga auditimi: Në 7 raste në vlerën 348,655 mijë lekë kriteret e veçanta për kualifikimit nuk janë vendosur plotësisht konformë akteve ligjore dhe rregullatore për prokurimet publike. Veprim në kundërshtim me Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2009, òPër Prokurimin Publikò, i ndryshuar, neni 46, VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publikò, i ndryshuar, neni 26, pika 5, Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 42, datë 16.01.2008, òPër miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimiò, kreu III, pika 1/a, Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 108, datë 09.02.2011, òPër aftësitë që duhet të plotësojnë punëmarrësit, personat dhe shërbimet e specializuara, që merren me çështjet e sigurisë dhe të shëndetit në punëò, i ndryshuar, shkresën e Agjencisë së Prokurimit Publik (Drejtoria juridike dhe e Monitorimit), nr. 3341/1 prot., datë 20.03.2018 (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.7, faqe 72-111 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

6.1. Rekomandimi: Autoriteti Kontraktor, në vijimësi duhet të hartojë kërkesat e veçanta për kualifikim/specifikimet teknike, që të sigurojë transparencë, trajtim të barabartë të gjithë operatorëve ekonomikë të interesuar në kontratat publike, mos diskriminim dhe konkurrencë.

Menjëherë dhe në vijimësi

7. Gjetje nga auditimi: Në procedurën e prokurimit me objekt òHipoklorit natriumi, viti 2020-2021, në vlerën 14,248 mijë lekë, òBlerje materiale hidraulike, viti 2021 në vlerën 35,000 mijë lekë, òBlerje matësa uji individuale ½, ¾ dhe 1, viti 2019ò, në vlerën 10,668 mijë lekë, përlllogaritja e vlerës së kontratës është bërë duke u mbështetur në çmimet e tregut, por nuk është

dhënë asnjë argumentim përse nuk është i është referuar edhe alternativave të tjera, si çmimet e kontratave të mëparshme të realizuara nga autoritete të tjera kontraktore, ose/dhe çmime të tjera zyrtare, të njohura nga institucionet përkatëse (si për shembull, nga organet tatimore a doganore, dhomat e tregtisë, etj). Veprim në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 òPër miratimin e rregullave të prokurimit publikò, i ndryshuar, neni 59, pika 2 (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.7, faqe 72-111 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

7.1. Rekomandimi: Nga Autoriteti Kontraktor të merren masa që përlllogaritja e vlerës së kontratave të prokurimit publik, të vlerësohet si procedurë e rëndësishme, pasi nga zbatimi i procedurave të përzgjedhjes të prokurimit publik, varet saktësia e kësaj vlere, por dhe efektiviteti maksimal i shpenzimeve publike.

Menjëherë dhe në vijimësi

8. Gjetje nga auditimi: Në 5 procedura prokurimi për vlerën 244,882 mijë lekë, kualifikimi, shpallja fitues e operatorëve ekonomik nga KVO, si dhe lidhja e kontratave, është kryer në mënyrë të padrejtë. Veprim në kundërshtim me Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 òPër prokurimin publikò, i ndryshuar, neni 46, neni 53 pika 3, VKM nr. 914, datë 29.12.2014 òRregullat e Prokurimitò, i ndryshuar, neni 66 pika 3, Ligjin nr. 44/2015 òKodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisëò nenet 108-118 (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.7, faqe 62-96 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

8.1. Rekomandimi: Nga Shoqëria t'i kushtohet vëmendje e duhur institucionale procesit të shqyrtimit dhe vlerësimit nga komisionet e vlerësimit të ofertave, i dokumentacionit ligjor dhe administrativ të operatorëve ekonomik dhe ofertave të ofertuesve, pasi procesi i shqyrtimit, kualifikimit dhe shpallja fitues të operatorëve është me rëndësi kapitale.

Menjëherë dhe në vijimësi

9. Gjetje nga auditimi: Në procedurën e prokurimit me objekt òInstalimi i teknologjive të reja në stacionet e pompimit në sistemin Mengël-Samurr-Godolesh,(për zëvendësimin e pompave dhe pajisjeve viti 2019, në vlerën 56,418 mijë lekë dhe procedurën e prokurimit "Rikonstruksion i rrjetit të brendshëm ekzistues të linjave në Rrugët ò11 Nëntoriò, Rruga òAli Çausiò, Rruga òFaik Neziriò, Rruga òVeli Stafaò, një pjesë të Lagjes òÇlirimiò dhe ò11 Nëntoriò të Bashkisë Elbasan, viti 2019 në vlerën 23,002 mijë lekë, nuk është siguruar kontrata për humbje ose dëmtim të punimeve, pajisjeve, materialeve, humbje ose dëmtim të kantierit ose pronave të tjera në kantier dhe dëmtimet personale ose vdekjet e palëve të treta, si dhe deri në datën e hartimit të këtij konstatimi Autoriteti Kontraktor, nuk ka zgjatur periudhën e paraqitjes të policës së sigurimit ose nuk ka bërë vet siguracionin dhe të zbrasi koston e tij nga pagesa që i jep kontraktorit. Veprim në kundërshtim me neni 25 të kontratës së lidhur, pika 1 dhe 2 (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.7, faqe 72-11 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

9.1. Rekomandimi: Nga Administratori i Shoqërisë të merren masa për të korigjuar këtë praktikë në sigurimin e kontratave, me qëllim jo vetëm lidhja tyre të shoqërohet me polica e sigurimi, por edhe për të parandaluar për të ardhmen përsëritjen e rasteve të tilla.

Menjëherë dhe në vijimësi

10. Gjetje nga auditimi: Anëtarët e Këshillit të Administrimit të Shoqërisë, nuk kanë lidhur kontratë me shoqërinë, kontratë e cila duhej të lidhej që në momentin e emërimit të tyre, ku të jetë parashikuar, ndër të tjera, kritere të qarta performance që pritej t'ò arrinin në terma vjetorë. Objektivat për performancën (indiktorët) e vendosur në kontratë, duhet të miratohen edhe nga ministria e linjës dhe duhet të jenë të matshme në përputhje me biznes planet e shoqërisë. Veprim në kundërshtim me nenin 12 pika 3 e Statutit të Ujësjellës Kanalizime Elbasan SHA, të miratuar me Vendim të Asamblesë së Përgjithshme nr. 516, datë 31.03.2016, VKM nr. 63 i datës 20.01.2016 òPër riorganizimin e operatorëve që ofrojnë shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm,

grumbullimin, largimin dhe trajtimin e ujërave të ndoturaö (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 14-23 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

10.1. Rekomandimi: Nga kryetari i Bashkisë Elbasan në cilësinë e përfaqësuesit të Asamblesë së Përgjithshme të lidhen kontratat me anëtarët e Këshillit të Administrimit, në të cilat të parashikohen kritere të qarta performance/objektiva që priten të arrihen në terma vjetorë. Objektivat për performancën (indiktorët) e vendosur në kontratë duhet të miratohen edhe nga ministria e linjës dhe duhet jenë të matshme në përputhje me biznes planet e Shoqërisë.

Menjëherë

11. Gjetje nga auditimi: Për periudhën objekt auditimi, me Administratorin e Shoqërisë nuk është lidhur kontratë, pavarësisht se emërohet për një periudhë kohe prej tre vitesh, dhe qëndrimi i tij në detyrë gjatë periudhës tre vjeçare bëhet në bazë kontratash të rinovueshme vjetore ndërmjet tij dhe Asamblesë së Përgjithshme, bazuar në vlerësimet pozitive të performacës së punës së tij. Veprim në kundërshtim me nenin 18, pika 5 e VKM nr. 63, datë 27.01.2016 òPër riorganizimin e operatorëve që ofrojnë shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm, grumbullimin, largimin dhe trajtimin e ujërave të ndoturaö, si dhe pika 5 e nenit 18 të Statutit të UK Elbasan SHA (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 14-23 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*)

11.1. Rekomandimi: Në zbatim të Vendimit të Asamblesë së Përgjithshme nr. 11, datë 02.02.2021 të lidhet kontratë me Administratorin, në të cilën të parashikohen kritere të qarta performance/objektiva që priten të arrihen në terma vjetorë, si dhe të bëhen vlerësime vjetore të performancës së punës, bazuar në objektivat/kriteret e performancës të parashikuar në kontratë.

Menjëherë

12. Gjetje nga auditimi: Nuk është publikuar në faqen e internetit të Shoqërisë, dokumentacioni i detyrueshëm për t'u publikuar, lidhur me procesverbalet e mbledhjeve të Asamblesë së Përgjithshme të cilat duhet të jenë të publikuara në faqen zyrtare të internetit jo më vonë se 15 ditë nga data e mbledhjes për të cilën janë mbajtur. Veprim në kundërshtim me Ligjin nr. 119/2014 òPër të drejtën e informimitò, Ligjin nr. 9901, datë 14.04.2008 òPër tregtarët dhe shoqëritë tregtareò, i ndryshuar, neni 90, pika 5 (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 14-23 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

12.1 Rekomandimi: Nga Asambleja së Përgjithshme dhe Administratori i Shoqërisë të merren masa për publikimin në faqen zyrtare të internetit të shoqërisë të dhënat/dokumentet e detyrueshme për tu publikuar.

Menjëherë dhe në vijimësi

13. Gjetje nga auditimi: Këshilli i Administrimit nuk është mbledhur përherë çdo muaj të vitit kalendarik. Konkretisht për vitin 2019 nuk është mbledhur në muajt Janar, Prill, Maj, Qershor, Korrik, Nëntor, Dhjetor. Për vitin 2020 nuk është mbledhur në muajt Janar, Gusht, Nëntor dhe për vitin 2021 nuk është mbledhur në muajin Janar. Veprim në kundërshtim me nenin 14 pika 1 e Statutit, të miratuar me vendim të Asamblesë së Përgjithshme nr. 516, datë 31.03.2016, si dhe VKM nr. 63 i datës 20.01.2016 òPër riorganizimin e operatorëve që ofrojnë shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm, grumbullimin, largimin dhe trajtimin e ujërave të ndoturaö (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 14-23 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

13.1 Rekomandimi: Nga organet drejtuese, të merren masa për thirrjen e mbledhjeve të Këshillit të Administrimit jo më pak se një herë në muaj, me qëllim analizimin e vijueshëm të performancës së shoqërisë dhe marrjen e vendimeve koherente në bazë të problematikave që rezultojnë nga aktiviteti i përditshëm i shoqërisë.

Vazhdimisht

14. Gjetje nga auditimi: Në 5 raste Këshilli i Administrimit është mbledhur më vonë nga afati i përcaktuar në njoftim, përkatësisht në rastet si më poshtë:

Njoftimi nr. 176 prot., datë 07.02.2020 ó vendimi nr. 1 prot., datë 13.02.2020.

Njoftimi nr. 2531 prot., datë 01.12.2020 ó vendimi nr. 2531/1 prot., datë 09.12.2020.

Njoftimi nr. 671 prot., datë 05.04.2021 ó vendimi nr. 687 prot., datë 12.04.2021.

Njoftimi nr. 1326 prot., datë 01.06.2021 - vendimi nr. 1362 prot., datë 07.06.2021.

Njoftimi nr. 2801 prot., datë 17.09.2021 - vendimi nr. 2913 prot., datë 24.09.2021.

Veprim në kundërshtim me nenin 14 pika 4 e Statutit, VKM nr. 63 i datës 20.01.2016 óPër riorganizimin e operatorëve që ofrojnë shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm, grumbullimin, largimin dhe trajtimin e ujërave të ndoturaó (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 14-23 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

14.1 Rekomandimi: Këshilli i Administrimit të sigurojë marrjen e veprimeve korrigjuese në mënyrë që mbledhjet e tij të bëhen duke respektuar njoftimet e bëra.

Menjëherë dhe në vijimësi

15. Gjetje nga auditimi: Programet ekonomiko-financiar (buxhetet vjetor) janë hartuar dhe realizuar në pamjaftueshmëri financiare, pasi aktiviteti i shoqërisë nuk është i mbuluar plotësisht me buxhet. Konkretisht është programuar dhe realizuar me humbje për vitin 2020 dhe 2021. Në mënyrë të detajuar për vitin 2020, humbja është planifikuar në vlerën -42,749,527 lekë. Të ardhurat janë realizuar në vlerën 340,145,524 lekë, ndërsa shpenzimet janë realizuar në vlerën 385,924,232 lekë, me një humbje në vlerën 45,778,708 lekë.

Për vitin 2021 humbja është planifikuar në vlerën -8,500,000 lekë. Të ardhurat janë realizuar në vlerën 384,633,550 lekë, ndërsa shpenzimet janë realizuar në vlerën 469,435,236 lekë, me një humbje në vlerën 84,801,686 lekë.

Veprim në kundërshtim me Ligjin nr. 9901 datë 14.04.2008, óPër Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtareó, me ndryshimet vijuese të tij neni 37 dhe 82 dhe Udhëzimin e Ministrisë së Ekonomisë nr. 15, datë 02.05.2018 óMbi programet e zhvillimit ekonomik të shoqërive tregtare me kapital shtetëroró (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3, faqe 23-38 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

15.1. Rekomandimi: Organet drejtuese të shoqërisë duhet analizojnë dhe të vlerësojnë arsyet e produktivitetit të ulët të veprimtarisë ekonomiko-financiare, efektin e çdo risku të identifikuar, përfshirë një analizë të detajuar të detyrimeve ndaj të tretëve dhe në veçanti kreditë afatshkurtra e afatgjata, si dhe të merren masat e nevojshme për daljen nga kjo situatë që të çon drejt falimentimit.

Brenda datës 30.09.2022

16. Gjetje nga auditimi: Për vitin 2019, 2020 dhe 2021 nuk janë respektuar afatet kohore për dërgimin e projekt programit ekonomik në Këshillin e Administrimit dhe në Asamblenë e Përgjithshme. Konkretisht për vitin 2019 programi ekonomik është miratuar me Vendim të Këshillit të Administrimit nr. 22, datë 31.12.2018, ndërsa miratimi përfundimtar i programit ekonomik është realizuar me Vendim të Asamblesë së Përgjithshme nr. 8, datë 07.01.2019 të dhe protokolluar në UKE me nr. 123 prot., datë 10.01.2019. Për vitin 2020 programi ekonomik është miratuar me Vendim të Këshillit të Administrimit nr.177, datë 30.12.2019,. ndërsa miratimi përfundimtar i programit ekonomik është realizuar me Vendim të Asamblesë së Përgjithshme të Shoqërisë nr. 178, datë 30.12.2019. Për vitin 2021 programi ekonomik është miratuar me Vendim të Këshillit të Administrimit nr.182, datë 28.12.2020, ndërsa miratimi përfundimtar i programit ekonomik është realizuar me Vendim të Asamblesë së Përgjithshme të Shoqërisë nr. 183, datë 30.12.2020. Veprim në kundërshtim me Udhëzimin e Ministrisë së Ekonomisë nr. 15, datë 02.05.2018 óMbi programet e zhvillimit ekonomik të shoqërive tregtare me kapital shtetëroró III, pika 2 (programi ekonomik duhet miratuar brenda datës 01 dhjetor) (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3, faqe 23-38 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

16.1. Rekomandimi: Organet Drejtuese Shoqërisë të miratojnë kohë programin ekonomiko-financiar (buxhetin vjetor) dhe ndryshimet e tij gjatë vitit, si dhe të marrin masa për zbatimin rigoroz të zërave të buxhetit, si për të ardhurat dhe shpenzimet, duke bërë analiza periodike dhe nxjerrë përgjegjësitë përkatëse për devijimet nga programi i miratuar.

Në vijimësi

17. Gjetje nga auditimi: Shoqëria ÷Ujësjetllës Kanalizimeö Elbasan SHA, nuk ka hartuar programe afatmesme dhe afatgjata, veprim në kundërshtim me Statutin, neni 7 ÷Kompetencatö e Asamblesë së Përgjithshmeö, Udhëzimin e Ministrisë së Ekonomisë nr. 15, datë 02.05.2018 ÷Mbi programet e zhvillimit ekonomik të shoqërive tregtare me kapital shtetërorö, pika I/2 (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3, faqe 23-38 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

17.1. Rekomandimi: Organet Drejtuese të Shoqërisë të marrin masa për hartimin dhe miratimin e programe afatmesme dhe afatgjata për përmirësimin e performancës, në kuadër të Reformës Kombëtare të Sektorit Ujësjetllës-Kanalizime.

Brenda 31.12.2022

18. Gjetje nga auditimi: Për periudhën e auditimit, përqindjet e arkëtimit vjetor total krahasuar me faturimin vjetor, janë në rritje nga viti në vit. Megjithatë arkëtimi korent është ai që tregon arkëtimin e faturimit të viteve përkatëse, dhe në fakt pavarësisht rritjes progresive është nën normat e konsideruara të pranueshme nga ERRU etj. Përsa i përket arkëtimit të debive të vjetra shoqëria ka akoma një vlerë të konsiderueshme të debisë për të mbledhur, pavarësisht përpjekjeve të saj për lidhjen e aktmarrëveshjeve me debitorët apo dërgim në përmbarim. Konkretisht në vitin 2019, arkëtimet totale janë në vlerën 323,162,000 lekë, ku arkëtimet korente janë në vlerën 211,683,000 lekë ose 65.5 % dhe arkëtimet e prapambetura janë në vlerën 111,509,000 lekë ose 34.51 %. Në vitin 2020, arkëtimet totale janë në vlerën 322,594,000 lekë, ku arkëtime korente janë në vlerën 138,070,230 lekë ose 57.2 %, ndërsa arkëtimet e prapambetura në vlerën 138,070,230 lekë ose 42.8 % Në vitin 2021, arkëtimet totale janë në vlerën 368,813,000 lekë, ku arkëtime korente janë në vlerën 252,715,000 lekë ose 68.52 %, ndërsa arkëtimet e prapambetura janë në vlerën 116,098,000 lekë ose 31.48 %.

Veprim në kundërshtim me VKM nr. 1304, datë 11.12.2009 ÷Për miratimin e rregullores për furnizimin me ujë të pijshëm dhe për kanalizimet në zonën e shërbimit të UKö, pjesa II pika 4, VKM nr. 236, datë 10.5.1993 ÷Për administrimin dhe furnizimin me ujë tek përdoruesit familjar dhe jo familjarö, i ndryshuar, neni 1; Udhëzimin nr. 3, datë 28.7.2004 ÷Për administrimin e ujit të pijshëmö, i ndryshuar, pika 6 dhe kontratën e shërbimit të miratuar me vendim të ERRU nr. 8, datë 4.02.2011 ÷Për miratimin e modelit të kontratës tipö, neni 9, pika 1 (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3, faqe 23-38 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

18.1. Rekomandimi: Organet Drejtuese të Shoqërisë të marrin masa për rritjen e arkëtimeve duke reduktuar humbjet menaxheriale të shoqërisë.

Menjëherë dhe në vijimësi

19. Gjetje nga auditimi: Për periudhën objekt auditimi u konstatua se mungojnë parashikimet specifike në drejtim të zhvillimit dhe administrimit të procesit të rekrutimeve të reja, si dhe të rregullave të parashikuara në Statut ose Rregullore të procedurave/kritereve/garancive lidhur me transferimet dhe ngritjet në detyrë. Në të gjithë deklaratimet për vende të lira pune për periudhën objekt auditimi nuk deklarohet afati brenda të cilit individët mund të paraqesin aplikimet e tyre. Për më tepër, në shumë raste evidentohet kohë shumë e shkurtër nga momenti i deklaratimit të pozicionit të lirë të punës deri në momentin e emërimit në punë të fituesit. Në disa raste mungesa e deklaratimeve për vende të lira pune në Zyrën e Punësimit Elbasan, kriteret e nevojshme për

përzgjedhjen/rekrutimin në pozicionet e lira, si dhe për të njëjtin pozicion pune nuk janë të njëjësuar kriteret e nevojshme për punësim.

Veprim në kundërshtim me nenin 18 pika 7/1 e VKM nr.63 datë 27.1.2016, "Për riorganizimin e operatoreve që ofrojnë shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm, grumbullimin, largimin dhe trajtimin e ujërave të ndotura" (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4, faqe 38-43 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

19.1. Rekomandimi: Nga organet drejtuese të bëhen parashikime të detajuara statutores dhe rregullatore lidhur me zhvillimin dhe administrimin e procesit të rekrutimeve të reja, si dhe të procedurave/kritereve/garancive lidhur me transferimet dhe ngritjet në detyrë.

Brenda datës 31.12.2022

19.2. Rekomandimi: Nga organet drejtuese të bëhet adresim korrekt në rregullore i përgjegjësive të punonjësve bazuar në lidhjen shkakësore të veprimeve të tyre me pasojat e kundërta ligjshme që mund të shkaktohen.

Brenda datës 31.12.2022

19.3. Rekomandimi: Nga Administratori i Shoqërisë të përcaktohet në deklaratimet për pozicione të lira pune, edhe afati brenda të cilit të interesuarit për pozicionin e punës duhet të shprehin interesin dhe paraqesin dokumentacionin e nevojshëm provues.

Menjëherë dhe në vijimësi

20. Gjetje nga auditimi: Për periudhën objekt auditimi nuk është kryer inventari fizik i aktiveve, por vetëm inventari i imët, pajisje zyre dhe ai ekonomik, si dhe nuk është mbajtur regjistri i aktiveve

-Gjatë investimeve të ndryshme në linja e kanalizime të reja, dhe impiante, nga shoqëria nuk janë evidentuar aktivet e vjetra të cilat kanë dalë jashtë përdorimit për të kontabilizuar si shpenzimin për vlerën kontabël të mbetur.

Veprim në kundërshtim me Ligjin nr. 25, datë 10.05.2018 òPër kontabilitetin dhe pasqyrat financiare, neni 15, pika 1 dhe 2 dhe Udhëzimin e MF nr. 30, datë 27.12.2011 òPër menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik, i ndryshuar, KREU III, pika 30 dhe 85/c (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6, faqe 65-72 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

20.1. Rekomandimi: Nga Administratori i Shoqërisë dhe Drejtoria Tregtare të merren masa për të kryer inventarin fizik të aktiveve të shoqërisë, të evidentohen aktivet e vjetra të cilat kanë dalë jashtë përdorimit, si dhe të mbahet regjistri i aktiveve.

Brenda datës 31.12.2022

21. Gjetje nga auditimi: Në faqen zyrtare të Ujësjetllës Kanalizime Elbasan SHA nuk është bërë publikimi i pasqyrave financiare vjetore, raporti i ecurisë së veprimtarisë, raporti i auditimit, në rastet kur përgatitja e këtyre dokumenteve është e detyrueshme. Kjo situatë ka ardhur dhe si pasojë e një rregulloreje jo shumë të plotë për funksionimin e shoqërisë. Veprim në kundërshtim me Ligjin nr. 25, datë 10.05.2018 òPër kontabilitetin dhe pasqyrat financiare, neni 22 pika 2 (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6, faqe 65-72 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

21.1. Rekomandimi: Nga organet drejtuese të shoqërisë të merren masa për të publikuar në faqen zyrtare të Shoqërisë të pasqyrave financiare vjetore, raporti i ecurisë së veprimtarisë, si dhe raporti i auditimit.

Në vijimësi

22. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se nga Shoqëria òUjësjetllës Kanalizime Elbasan SHA, asetet nuk janë regjistruar në Drejtorinë Vendore të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Elbasan, veprim në kundërshtim Ligjin nr. 111/2018 òPër Kadastrën, i ndryshuar neni 3, pika 5 (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6, faqe 65-72 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

22.1. Rekomandimi: Nga Shoqëria òUjësjiellës Kanalizime Elbasanò SHA të zbatohen procedurat ligjore, për të regjistruar në Drejtorinë Vendore të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Elbasan, të gjitha objektet që janë regjistruar në òZërin trojeò në kontabilitet.

Brenda datës 31.12.2022

23. Gjetje nga auditimi: Në pasqyrat financiare të vitit 2020 në llogarinë 21271 òRrjeti i shpërndarjes së ujit ndërtimë paraqitet në vlerën 50,492,139 lekë, dhe llogaria 2181 òMobilje dhe pajisje zyreò, paraqitet në vlerën 16,122,898 lekë, që kanë të bëjnë me kontratën òFinancim, instalim dhe realizim punimesh civile, sistemi, matje Wirelessò. Llogaria 2317 òAQT në proces Rrjeti i shpërndarjesò është në vlerën 68,770,000 lekë pa TVSH. Kontabilizimet e mësipërme janë kryer në vlerë totale dhe nuk janë zë për zë referuar situacioneve respektive. Veprim në kundërshtim me Ligjin nr. 25, datë 10.05.2018 òPër kontabilitetin dhe pasqyrat financiareò, neni 3, pika 14, neni 7 pika 2, neni 25, pika 1 dhe 2 (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6, faqe 65-72 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

23.1. Rekomandimi: Nga Administratori i shoqërisë të merren masa për të kryer inventarizimin fizik, rivlerësimin, klasifikimin (inventar ekonomik apo aktive) dhe kontabilizimin zë për zë.

Menjëherë

24. Gjetje nga auditimi: Në certifikimin e pasqyrave financiare të vitit 2019 dhe 2020, nga ekspertët kontabël të kontraktuar:

a. Nuk ka zbatim të SNK 250, i rishikuar òMbajtja parasyshe e ligjeve dhe rregullave në një auditim të pasqyrave financiareò për auditim ligjshmërie dhe përputhshmërie nga ekspertët kontabël.

b. Nuk ka dokumentacion përkatës që vërteton punën e kryer të ekspertëve, psh krahasimi i programit me faktin e realizuar dhe kush e ka konfirmuar situacionin e punës së kryer prej tyre (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6, faqe 65-72 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

24.1. Rekomandimi: Nga Organet e Shoqërisë t'i kushtohet vëmendje e duhur institucionale procesit të emërimit dhe kontraktimit të ekspertëve kontabël.

Në vijimësi

B. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI EKONOMIK

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të kontratës nga Shoqëria òAò shpk, me objekt òMaterialet hidraulike, në vlerën 40,771,612 lekë, viti 2021, u konstatua se dokumentacioni teknik dhe ligjor i blerjes së materialeve, nuk është i plotë dhe i saktë. Konkretisht pajisjet nuk janë të shoqëruara me test raport fabrike, si dhe Operatori ka paraqitur çertifikatën ISO 9001:2015 të lëshuar nga kompania Q, për Shoqërinë òAò shpk, e përkthyer dhe noterizuar në gjuhën shqipe, çertifikuar më datë 01.07.2018 dhe datë skadence 30.06.2021.

Nga verifikimi, referuar Rekomandimit të Agjencisë së Prokurimit Publik nr. 3330 prot., datë 20.03.2018 dhe Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit nr. 145 prot., datë 16.03.2018, u konstatua se kompania Q në Angli është e akredituar ndërkombëtarisht, por kjo çertifikatë me numër seri QEC 30675457/72/Q Rev:001, nuk është publikuar në faqen e kësaj kompanie, për pasojë është dokument i pabesueshëm për tu marrë në konsideratë referuar rekomandimit të sipërpërmendur.

Për pasojë grupi i auditimit nuk mund të shprehet për saktësinë dhe vërtetësinë e materialet hidraulike. Pra nuk mund të bëhet verifikimi i specifikimeve teknike (që janë pjesë e kontratës) dhe të dhënat e test raportit të fabrikës, që të konfirmohet që këto pajisje janë të njëjta me ato të prokuruar (specifikimeve teknike), dhe për të cilën Shoqëria òAò shpk ka fituar tenderin dhe është likuiduar. Në këto kushte grupi i auditimit nuk mund të japë opinionin e tij, për zbatimin e kontratës në cilësi dhe brenda standardeve të kërkuara dhe të konfirmojë që këto pajisje janë

njëta me ato të prokuruar. Veprim në kundërshtim me Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 ÷Për prokurimin publik, i ndryshuar, neni 60, pika 1, Ligjin nr. 7850, datë 29.07.1994 ÷Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë, neni 419, 420, neni 659, 698 dhe neni 690, Ligjin nr. 10,489 datë 15.12.2011 ÷Për trajtimin dhe mbikëqyrjen e tregut të produkteve jo ushqimore, neni 3 pika 11, 12, 16, 17, 18, 21 neni 8 , neni 9 dhe neni 10, Udhëzimin e Ministrisë Financave nr. 30 datë 27.12.2011, ÷Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik, i ndryshuar me nr. 20, datë 17.11.2014 pika 35 (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.7, faqe 62-96 të Projekt Raportit të Auditimit).

1.1. Rekomandimi:

Nga Administratori i Shoqërisë të merren masa të menjëhershme për ngritjen e një grupi teknik me specialistë të fushës (përfshijë ata që kanë qenë pjesë e procesit të kolaudimit dhe të marrjes në dorëzim), i cili të kryejë ekzaminimet teknike dhe të përcaktojë autenticitetin e materialeve hidraulike.

Në rast se nga procesi i verifikimit rezulton se pajisjet e furnizuara nga Shoqëria ÷Aö Sh.p.k, nuk garantojnë zbatimin e kontratës në cilësi dhe brenda standardeve të kërkuara dhe të konfirmohet që këto pajisje janë të njëta me ato të prokuruar, konsiderohet dëm ekonomik dhe të kërkohet në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative, si dhe të gjitha shkallët e gjykimit arkëtimi i vlerës 40,771,612 lekë nga Shoqëria ÷Aö Sh.p.k.

Brenda datës 31.12.2022

C. MASA DISIPLINORE:

Mbështetur në nenet 37, 141 e 153 pikat 1 dhe 2 të Ligjit nr. 7961, datë 12.7.1995 ÷Kodi i Punës, i ndryshuar, kontratave individuale të punës neni 16, i kërkojmë Administratorit të Shoqërisë, marrjen/ose jo të masave disiplinore ndaj personelit që është angazhuar në procedurat e prokurimit në cilësinë anëtarëve të komisionit të vlerësimit të ofertave, njësisë së prokurimit, përcaktimit të specifikimeve teknike, kërkesave për kualifikim dhe përlogaritjen e vlerave të kontratave, si dhe marrjes në dorëzim të pajisjeve (mallrave), duke marrë në konsideratë shkeljet ligjore dhe përgjegjësiive respektive të cituar në Raportin Përfundimtar të Auditimit, si dhe të performancës së punës së tyre.

KONTROLLI I LARTË I SHTETIT